

E shmangur prej vitesh nga jeta publike në Shqipëri, Elvira Dones vjen me këtë bisedë për letërsinë dhe jetën e saj mes televizionit dhe librit, mërgimit dhe atdheut, dhimbjes dhe dashurisë...

ELVIRA DONES

Në agorà-në shqiptare bërtitet shumë, por flitet pak...

Bisedoi *Andreas Dushi*

(fq. 2)

In memoriam ADAM ZAGAJEWSKI

Poeti polak Adam Zagajewski, i ardhur në gjuhën shqipe me vëllimin "Qyteti ku dua të jetoj" përkthyer nga Bardhyl Londo (Botimet *Aleph*), ditën e diel me datë 21 mars ndërroi jetë në moshën 75 vjeçare në Krakov.

(fq. 22)

Romani "800 hapa larg Venerës" i Graçit

**Jeta dhe pavdekësia, kjo
vdekje e pafundme!**

Nga *Ballzor Hoxha*

(fq. 13)

Romani "Bolero në vilën e pleqve"

**Tiparet postmoderniste në
veprën e Kongolit**

Nga *Emine Boriçi*

(fq. 12)

**Trajtat e "Tjetrit" në poezinë
e sotme arbëreshe**

Nga *Hysni Ndreu*

(fq. 6)


Letërsia e arbëreshëve të Italisë, pavarësisht rrethanave historike e kulturore, në të cilat është krijuar e zhvilluar, ka mundur të krijojë një profil të sajën, i cili identifikohet me Lekë Matrëngën, Jul Varibovën, De Radën, Seremben, Skiroin, Dushko Vëtmën, Vorea Ujkon, Luka Perronen e të tjerë. Në gjuhën që përdoret, në temat e motivet që rimer...

POEZIA E AGIM MATOS NË MES TË ERËRAVE TË POSEIDONIT

Nga *Natasha Lako*

(fq. 10)

Duke lindur në një vend, ku letërsia jeton në vartësi të çka është thënë më parë dhe nga gjurmë të shkruara nëpër tekste shkollore, poezia e Agim Matos nuk eksploron si mjaft poetë të tjerë të brezit të tij, as thërret ose polemizon për identitet...



700 VJETORI I VDEKJES SË POETIT TË MADH DANTJA DHE "KOMEDIA HYJNORE"

Nga *Natalino Sapegno*

(fq. 18)

**Përkthimi i "Komedisë Hyjnore" midis
Luigi Lorecchios dhe Meritan Spahisë**

Nga *Stefan Çapaliku*

(fq. 21)

Shtëpia botuese Onufri riboton të plotë
"Komedinë hyjnore", përkthyer nga
Pashko Gjeçi në vitin 1960

INES MURZAKU:

**Nuk ka njeri, këtu në
Amerikë, të mos ketë dëgjuar
për nënë Terezën tonë**

*Intervistë dhënë gazetares
MIMOZA HASANI PLLANA*

(fq. 8)

"REALITETI A" DHE "REALITETI B"

Haruki Murakami



(fq. 23)

BIBLIOTEKË

Resul Shabani

Akuariumi i profesorit

(fq. 16)

Bruce Chatwin

Vullnetarët

(fq. 17)

Elona Culliq

Poezi

(fq. 15)

NJË LIBËR I RI NGA BOTIMET "POLIS"

Richard Osman

Ende në lojë

(fq. 11)

Ese mbi dy shpirtra të letërsisë dhe kulturës

**Një letër e panjohur e
shkrimtares Musine Kokalari**

Nga *Uran Butka*

(fq. 8)

Në Arkivin e Shtetit zbulova këto ditë një letër të panjohur të Musine Kokalarit drejtuar mikut dhe dijetarit Sotir Kolea. Në arkiv ruhen gjithashtu disa letra të shkrimtares Musine Kokalari me personalitetet kulturore të botës shqiptare e të huaj...

ELVIRA DONES: Në agorà-në shqiptare bërtitet shumë, por flitet pak...

Bisedoi Andreas Dushi



A.D: Në bibliografitë e hartuara nga *Biblioteka Kombëtare* ka mjaft artikuj të shkruar për dy romanet tuaj të parë, “Dashuri e huaj” dhe “Kardigan”, botuar nga Çabej. Ndërkohë, ju vinit në letërsi nga bota e kinematografisë dhe televizionit. E prisnit një të tillë “mirëpritje”?

E.D: Kanë kaluar më shumë se dy dekada nga ato botime të para, e kujtesa ka tendencën të mbajë e të përmbajë më shumë ndodhitë e hollësitë e viteve më të afërta. Me sa mbaj mend, romani i parë pati jehonë mjaft pozitive, ndoshta edhe për faktin që rrëfente ngjarje të *sapondodhura* në kohë, rrëfente vitet e fundit para rënies së diktaturës, e si i tillë mendoj se shërbeu si një farë pasqyre ku mjaft lexues - sidomos në Tiranë - gjetën veten. Ishte një pasqyrë e pjesshme, natyrisht, pasi një libër nuk mund të jetë kurrësi gjithëpërfshirës: rrëfen një ngjarje nga një këndvështrim, në një hapësirë kohore a mjedisore të caktuar.

Mirëpritja e një libri, natyrisht, i jep kënaqësi autorit. Kushdo që thotë të kundërtën a e minimizon rëndësinë e mirëpritisjes së një libri nga ana e lexuesit, është thjesht hipokrit. Natyrisht, nuk është suksesi a jehona pozitive shtysa, për të shkruar. Çdo njeri që krijon e bën këtë sepse aty ndihet gjallë, aty shikon një aspekt thelbësor të ekzistencës së vet, aty ndihet në *tokë të vet*.

A.D: Një pjesë e mirë e librave tuaj lidhen me emigracionin; mes tyre dalloj “Kardigan”, edhe për faktin se është libri juaj i dytë. Historia e tij ndodh sa në Shqipërinë e së shkuarës komuniste, aq edhe në Zvicrën e së tashmes ku ju jetonit. A ishte emigrimi kapërcyelli që duhej kaluar për të zbuluar letërsinë?

E.D: Do të thosha që përvoja vetjake e ajo profesionale u shëndosh e u poq nëpër vite, pasi isha larguar. Lashë Shqipërinë në moshë të re. Eksperienca e profesionit/profesioneve që pata mundësinë e mirë të lëvroj, pasuria e pasurimi prej tyre më solli veti, në mënyrë *organike*, tek

ajo që kisha bërë që në vitet e fëmijërisë. Pata shkruar që herët, në atë intimitetin tim e në pritje të diçkaje që të ma forconte apo të ma shpërbëntë pasionin e hershëm. M’u dha mundësia për të parë “botën e madhe”, për t’u përballur, për të udhëtuar e për të lexuar shumëçka që brezit tonë i kishte qenë e ndaluar. Ky ishte një bekim i madh, plotësimi i asaj etjeje prej të zhurituri që më në fund mund ta kënaqja. Ndaj të shkruarit u kthye në më shumë se një sprovë rinie; u bë boshti rreth të cilit do të vërtitem gjithë jetën.

Më shumë se me emigracionin *per sé* librat e mi kanë të bëjnë me udhëkryqet, me rrugëtimin e njeriut, kësaj qenieje të paqetë, me dialogun a shurdhërinë mes botëve, e jo doemos vetëm mes botës shqiptare e *gjetkut*.

Romani “Ditë e bardhë e fyer” - një histori miqësie e thellë e komplekse mes dy personazheve meshkuj, njëri shqiptar e tjetri zviceran - ndërthur jetën e historinë e një gruaje të re ardhur në Zvicër nga Kolumbia. Gjithashtu, romani “Më pas heshtja” rrëfen një histori dashurie e dhimbjeje mes dy personazhesh: njëri zviceran e tjetra argjentinasë; vendngjarja është në pjesën dërrmuese Irlanda... E kështu me radhë, pa u ndalur këtu në çdo libër...

Në dekadat e fundit sëra e shkrimtarëve që jetojnë e shkruajnë jashtë vendit të origjinës është rritur aq sa të flitet sot - me të drejtë - për një letërsi transnacionale. Studiuesit, kritikët e historianët e *të sotmes* i kanë kushtuar e po i kushtojnë vëmendje e hulumtime, dizertacione e krahasime në lëmin letrar e gjuhësor. Në këtë *klub* bëj pjesë, ashtu si disa shkrimtarë të tjerë shqiptarë të diasporës.

A.D: Kur Olga Tukarczuk mori çmimin *Nobel*, kujtoj një koment të cilin po e perifratoj, *Librat e Tokarczuk janë si areoplan*. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për librat tuaj, madje mund të shkohet më tej, edhe si një *makinë e kohës*: me to lëviz në hapësirë gjeografike, por edhe kohore. Është kjo një zgjedhje e vetëdijshme nga ana juaj apo diçka që ndodh natyrshëm, për hir të vetë letërsisë?

E.D: Imja është një *jetë në lëvizje, fluide*, ku i vetmi element i patundur e i patundshëm është familja. Kam jetuar në Shqipëri, në Zvicër e në Shtetet e Bashkuara, e vazhdoj të jetoj kështu, mes vendesh, kontinentesh e diferencash gjuhësore e si rrjedhim kulturore. Udhëtimet nuk janë përjashtimi, por norma.

Pra hapësirat gjeografike e kohore janë elementët që më përcaktojnë, për shkak edhe të profesionit tjetër: realizimit të dokumentarëve. Udhëtimet për mua nuk janë ato të turistes, por të rrëfjësës e investigueses. Kjo më ka çuar shpesh në qoshe të botës që me shumë gjasa nuk do t’i kisha vizituar dot. Syri mbledh fakte, vëzhgon, kamera vështrohet e filtron ndryshe, mikrofon mbledh dëshmitë, e në fund të gjithë elementët bashkë krijojnë një vizion e analizë që si udhëtare e thjeshtë nuk do ta bëja dot, a ndoshta do ta bëja në mënyrë të përciptë.

Përdorët fjalën aeroplan në shembullin që sollët. Aeroportet kanë për mua gjasat e një farë shtëpije, a ishulli; ende s’më kanë lodhur, edhe kur janë udhë që i bien botës rrotull. E kam zët kur më duhet të kaloj në tranzit me ngut për të kapur avionin tjetër, ndaj sa herë mundem i prenotoj biletat me dritare pritjeje në mes, për të patur kohë të kundroj gjindjen e jetët që tërheqin zvarrë bashkë me valixhet me rrota; për të kapuar fjalë e thekse; ngjyra veshjesh e tike nervozizmi e kështu me radhë.

Kjo mani s’më braktis, s’e shkund dot nga vetja. Ndoshta vjen nga vitet e rinisë së parë; nga mirazhi që na fanepsej për pakë ditë në shëmbëlltyrën e atyre pak të huajve që vinin në Tiranë. Vinin duke sjellë me vete *botën tjetër*, parfumet mbi veshjet, librat nëpër çanta, shkuajdesjen në sjellje e në tonalitetet e zërave. Pastaj iknin siç kishin ardhur e ne mbeteshim aty në Rinas, me hundën lart, duke ndjekur zhdukjen e *Ufo-s* që na kish tronditur për ca ditë, për ca javë.


A.D: Dhimbja zë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë tuaj. Madje, me tre prej romaneve keni krijuar edhe “Trilogjinë e dhimbjes”. Ngjan sikur ju e mbartni dhimbjen ngado shkoni dhe me anë të letërsisë, e transmetoni aty, në vepër. Ç’është dhimbja për ju si shkrimtare, por edhe përtej shkrimtarsisë?

E.D: Dhimbja ka lindur bashkë me tokën që na lindi. Breza të tërë lindën e vdiqën me dhimbjen si motër a vëlla binjak. Ku shkonte shqiptari dhimbja ishte me të, mbështjellë kutullaq në stomak, bërë qyrk mbi shpatulla. Kështu ka qenë në shekuj për arsye gjeografike e mësyrye gjeopolitike e si pasojë kulturore, për shkak të vogëlsisë territoriale, e kështu me radhë.

Shqipëria ka vuajtur e vazhdon të vuajë; aktualisht për shkaqe të tjera, por këtu do hynim në një bisedë tjetër e do dilnim nga tema. Ballkani ka qenë gjithmonë i mburjtur nga konfliktet, ka qenë gjithmonë një cep i botës i shqyer nga kontrastet, pa gjetur dot, jo ende, barazpeshimin, bashkëjetesën paqësore. Ndoshta - ose më saktë, ngaqë - i ka munguar e i mungon dhuntia e kompromisit, *udhës së mesme*.

Duke u kthyer tek pyetja juaj: si shumë nga ne, jam pjellë e Shqipërisë dhe e historisë e memories së saj. Ndaj për rrjedhojë, kam një farë shqisë të gjashtë për ta pikasur dhimbjen. E depërtoj, e *bëj timen*. Më qëllon ndonjëherë të njoh dikë që qesh a gëzohet me tepri e deklaron lumturi të përjetshme. E vëzhgoj (ky zakoni i “poshtër” për të zhbriuar), e them me vete: tregomë çfarë të dhemb, ku e ke thembrën e Akilit, rrëfemë për atë që të tremb, për atë që të ka gjunjëzuar në jetë.

Më tërheqin dritëhijet, ekzistencat e vështira në kufi të së pamundurës, forca që i lypset individit për ta thyer rrethin infernal në të cilin ka lindur. Shpesh kam gjetur bukuri të mahnitshme pikërisht në fate të tilla, në jetë të tilla.



A.D: Gjatë komunizmit, kur jetuat dhe punuat në Shqipëri, cili ishte raporti juaj me letërsinë? E mendonit se në një tjetër realitet ku liria ishte si koncept i jetueshëm do të ishit shkrimtare?

E.D: Pjesërisht këtë e preka ca rreshta më sipër. Pata mësuar të lexoj në moshë fare të vogël. Lexoja me uri atavike çdo libër që më hapte një dritare imagjinare përtej mureve të burgut tonë: libra të autorëve shqiptarë kjo po e po, e gjithashtu libra autorësh të huaj, çfarëdo libri që arrija/ arrinim të gjenim.

Kalimi i një libri të ndaluar dorë më dorë për brezin tonë ishte një akrobaci më vete, një eksitim e një rrezik njëherësh. Kishim ato grupet tona të vogla e të mirëbesuara: cilido vinte dorë në një libër të ndaluar, e konsideronte detyrë ta bashkëndante me shokët e grupit të ngushtë. Kam kujtime të gjalla, *carne viva*, edhe sot e kësaj dite të ca maratonave absurde të leximit të një libri brenda njëzetekatër orëve, për t'ia kaluar pastaj shoqes a shokut të radhës...

Një kyç drejt letërsive e botëve të tjera ishte mësimi i gjuhëve të huaja, ndaj shumë herët fillova ta përdor këtë kyç...

Më gëzon fakti që ju të rinjtë e etur për dituri sot keni të gjitha mundësitë të lexoni çfarë t'ju ëndet, sepse jeni të lirë. Ju autorët e rinj sot dritaret e jetës e të botës i keni të shpalosura.

Brezi im ëndërronte, por “përgjysmë”. Ëndërronim të ishim të lirë, por se çdo bënim me atë liri kur të na jepej rasti, si do ta përdornim atë, kjo kërkonte një kthjelltësi që lypte këllqe ngaqë ai moment ishte aq larg, një pikë e padukshme në horizont.

Kështu që jo, nuk e dija se një ditë do të mund të isha njeri i lirë dhe e lirë të isha shkrimtare. Dija se dashuroja letërsinë mbi gjithçka tjetër.

A.D: Sa ndjeni ta këtë ndikuar kinematografia dhe televizioni letërsinë tuaj?

E.D: Duke lëvruar dy fusha, të dyja impenjative (u bënë tashmë njëzet vite që realizoj dokumentarë televizivë, qofshin këta të investigimit gazetaresk të mirëfilltë, apo dokumentarë kulturorë) është e natyrshme që letërsia të ndikojë në dokumentarët dhe anasjelltas. Ka raste kur këto dy profesione *përplacen*, apo “përjashtojnë” njëra-tjetrën. Qëllon që të realizoj një punë televizive, por në fund të shoh se ai rrëfim, ai metarial narrativ ende nuk është shteruar. Një dokumentar apo skenar filmi artistik ka një kufi kohor, një ritëm që të imponon sintezën apo analizën e një lloji. Ndërsa romani do ta çonte atë histori në hapësira më të mëdha, në shtresa e nënshtresa psikologjike më *minuziose*, në një retrospektivë e perspektivë të cilat në dokumentarin në fjalë nuk kanë patur gjithë hapësirën e duhur. Ndaj, përpara çdo projekti, përpara çdo libri a filmi që rrëmben interesin tim peshoj nga çdo anë, e me shumë kujdes, se cila formë shprehëse i përshatet atij subjekti, asaj teme.

Ndodh edhe e kundërta: një vështrim i një personazhi, një heshtje e tejzgjatur, lëvizja e një dore, hezitimi, vuajtja për të gjetur fjalën e duhur e të intervistuarit vlejnë ar përpara kamerës, e shpesh janë të papërshkrueshme nga rreshti në një libër. Kamera në këso rastesh është mjeti i duhur: dokumentuesi i atij çasti sublim, spektatori bujar që di të presë e ta kthejë në forcë atë hollësi narrative të imazhit.

Në vitet e para në Zvicër, para se të homologohesha si regjisore-gazetare, pata mundësinë të ushtrroja për disa vite profesionin e montazhieres, duke filluar nga reportazhet sportive, ato të kronikës, filmat me metrazh të shkurtër e të mesëm e kështu me radhë. Jo rrallë ndjeja frustrim, pasi më dukej një punë teknike, më shumë se një profesion konceptesh, një punë teknike, ku të duhet t'i bindeshe vizionit të autorit.

Më vonë kuptova se kisha qenë me fat, pasi teknika e precizioni i montazhit është një instrument i domosdoshëm në ndërtimin e strukturave narrative të çdo lloji. Kur je në fazë xhirimesh, e “këqyr” strukturën të marrë formë ditë pas dite; ke qetësinë e krijesisë me valixhen e instrumenteve të pajisur me gjithçka duhet. Marrja e kamerës në shpatull, më vonë, ishte një tjetër element qetësues drejt sigurisë e zotërimit të një profesioni tejet kompleks.

Shpesh kur shkruaj, para se fjala të vijë në letër, e *vështroj* atë, e *vështroj* fjalën, fjalinë. Ka një ngjyrë të vetën, një ritëm përtej meje. Në këtë kuptim stili im i të shkruarit është jo rrallë *viziv*, kinematografik.

A.D: Ardian Kyçyku, në shënimin e tij për librin “Lule të gabuara”, mes të tjerash shkruan: *Me Elvira Donesin mbyllet ajo lëngatë e gjatë stilistike e prozës femërore shqipe...* Ju personalisht si e shihni *prozën femërore shqipe*, prurjet, mungesat...?

E.D: Nuk jam e vetmja shkrimtare grua, fatmirësisht,



në letrat shqipe. Sikur të ishte kështu, kjo po që do të ishte një varfëri e madhe, një zbrazëti shqetësuese. Por - përsëri fatmirësisht - ndërkohë pena të shëndosha në prozë e në poezi e në forma të tjera të artit, kanë pasuruar jetën letrare e kulturore në Shqipëri, fakt që më gëzon, thellësisht më gëzon. Për prurjet a mungesat u takon më mirë studiuësve e gazetarëve kulturorë të analizojnë, të merren seriozisht më atë punë.

Nuk kam se si të lexoj gjithçka botohet në letrat shqipe. Jo vetëm mungesa e kohës, por dhe largësia fizike ma bën të pamundur të kem një vështrim të plotë e shterues mbi vlerat a dobinë krijuese të bashkëshkrimtareve. Di që sa herë kam rastin e kohën të marr në duar një libër të ri të një kolegeje grua e bëj me kënaqësi të madhe e me shumë kërshtëri. Ka disa poete shqiptare që do t'i quaja sublime. Ka prozatore të rafinuara e të fuqishme, të cilat rreshtohen me po aq dinjitet e forcë letrare, po me aq cilësi sa kolegët burra. Nëse nuk përmend emra këtu, e bëj për faktin se jam vetëm njëra mes tyre e asgjë më shumë, e nuk më pëlqen të vë “nota” e të bëj lista. Nuk do t'u bëja atyre grave poete, shkrimtare e edhe përkthyes, një “nder”. Gjithashtu më irriton tendenca jonë e “më të mirit”, më “të madhit”, “numrit një”. Letërsinë e artin e një vendi nuk e lartëson një emër apo dy. Është pjelloria e larmia e profileve të ndryshme krijuese që krijojnë pasurinë artistike e kulturore në gjirin e një shoqërie e të një vendi.

A.D: Përgjatë viteve, është folur për të ashtuquajturin kanon femëror në letërsi. Besoni në ekzistencën e tij? Si dhe, a e shihni nevojën për rivlerësimin e tij, qoftë si koncept, ashtu edhe si realitet?

E.D: Ju falënderoj për pyetjen. Ç'do të thotë, saktësisht kanon femëror në letërsi?


Në shekuj nuk është folur për shkrimtarët burra duke i futur në një kanon “mashkullor”. *Monstrave të shenjtë* të letërsisë botërore nuk u është vënë në dyshim gjinia, si shenjë, si kut matës i aftësisë apo i paaftësisë së tyre poetike apo narrative. Nuk ua kanë vënë në dyshim, kurrë - as dje e as sot - aftësinë, mjeshtërinë e lirinë për të përshkruar e rrëfyer jetën, botën në mënyrë gjithëpërfshirëse. Një shkrimtari s'i ka shkruar ndonjëherë në mend se meqë është burrë, nuk ka aftësinë të përshkruajë gjysmën tjetër të qiellit: gruan. Ai, shkrimtari, ka rrëfyer njerëzimin, e si i tillë, me të drejtë është konsideruar shkrimtar “pa gjini”, ose më gjerë *pangjinor*, po të përdorim njërën nga risitë leksikore e definicionet e kohëve moderne.

Ç'synon pra, ky dialog në ato trevat tona, në shekullin e 21-të? Përse sot, në Shqipëri (e kjo çështje ka vite që vlon), flasim për “kanon femëror”, sikur aftësia narrative apo poetike e gruas t'i përkasë një kutie më vete, një kutie të

vogël, “femërore”? Nënkuptimi cili është? Që gratë, meqë të tilla, nuk janë në lartësinë e penave e mendjeve mashkullore për të rrëfyer nënshtresat psikologjike, kompleksitetin e njeriut, individit etj., etj.?

Ka patur ndër shekuj shkrimtarë të mrekullueshëm që i kanë dhënë letërsisë perla të rralla personazhesh të gjinisë tjetër. Siç ka patur dhe ka pena “femërore” që u janë futur personazheve të gjinisë mashkullore nën lëkurë në mënyrë mjeshtërore. Në të dyja rastet kemi të bëjmë me anët e së njëjtës medalje: përpara çështjeve të mëdha të ekzistencës, përpara jetës e vdekjes, përpara dëshirës për të mbijetuar, përpara nevojës për të kuptuar e menaxhuar këtë mister që quhet Jetë, jemi të gjithë njësoj, burra e gra.

Pra, nëse flasim për një shkrimtare nuk duhet të nënkuptojmë një letërsi “femërore”. Ashtu si një shkrimtar e ka më të lehtë të përshkruajë *la forma mentis* të personazheve mashkullorë, sepse i njeh së brendshmi, po ashtu një shkrimtare e ka të lehtë të posedojë një sensibilitet hollësisht





të botës së saj e të simotrave, ngaqë e njeh së brendshmi, e si pasojë ka njohuri të “gozhdojë” në letër hollësira, profile, ngjyra, larmia e të cilave e bën aksh personazh të gjallë. As më shumë, as më pak. Kjo është E Vetmja *diferencë*.

Mund ta tirrja gjatë këtë temë, por kjo është intervistë e jo esë, ndaj për ta mbyllur:

Letrat shqipe kanë patur e kanë më shumë pena shkrimtarësh, pra burrash, por kjo s’ka si të çudisë. Historikisht të shkruarit ka qenë një sundim mashkullor përtej Shqipërisë e Ballkanit; ka qenë një liri e një privilegj mashkullor, ashtu si shumë profesione të tjera. Një vajzë a grua që shkruante, në familje konsiderohej një anomalë për t’u ndryrë, mbajtur fshehur e për t’u çuar - fshehtëzi - tek psikiatri i epokës, si e çmendur etj., etj.. Në epokën moderne e me një sens të ri të të drejtave të gruas (fituar, ende vetëm pjesërisht, me shumë mund e pas shumë betejash) barrierat pak e nga pak vazhdojnë të bien; udha është ende e gjatë në shumë zona të botës siç e njohim sot.

Ndaj nuk më çudit aspak që në Shqipëri kemi ende një mishmash opinionesh lidhur me letërsinë. Ajo e shkrimtarëve burra konsiderohet Letërsi, pa bisht prapa. Ndërsa krijimtaria e shkrimtareve merr një epitë, një definicion, një bisht pas: *letërsi femërore*. Nuk jam aspak dakord, ashtu si me siguri nuk janë dakord edhe koleget. Ne sot dimë kush jemi, kemi qetësinë e vetëbesimin se bëjmë letërsi, pa bisht pas. Nga stërgjyshet, gjyshet e nënat tona të vuajtura dimë se çdo centimetër kalldrëmi duhet fituar, pa prituri të na e “dhurojnë”.

Letrat e kultura shqipe kanë nevojë për bujari, për kolegialitet, për ndihmë reciproke, jo për ndarje në istikame. Jemi një vend i vogël, me një gjuhë të pasur, por “të vogël” në krahasim me gjuhët e kulturat dominuese. Suksesi i çdonjërit nga ne - burrë a grua, penë e “re” apo e “vjetër” - duhet të na gëzojë...

A.D: Përveçse në shqip, ju keni shkruar edhe në tjetër gjuhë e pastaj, teksti është përkthyer, por jo nga ju. I tillë është rasti i romanit “Hana”, botuar në të njëjtën kohë nga Feltrinelli në Itali, *Anne Carriere* në Francë dhe *Sejko* në Shqipëri. Kjo zgjedhje për të shkruar në gjuhë të huaj, e njohur edhe mes shkrimtarëve më të mëdhenj evropianë, nga se buron?

E.D: Kam shkruar shtatë libra në gjuhën shqipe. Tre të fundit në gjuhën italiane. “Vergine giurata” në gjuhën shqipe u përkthye me titullin “Hana”, titull që mbajti edhe versioni gjermanisht, por jo versioni në gjuhën angleze e polake, të cilët mbajtën titullin origjinal. “Piccola guerra perfetta” (mbi luftën në Kosovë), mbajti të njëjtin titull në shqip, frëngjisht e gjermanisht. Po kështu romani “Ditë e bardhë e fyer” në

versionin italian mbajti titullin origjinal, pra “Bianco giorno offeso”.

Më shumë se një zgjedhje/përzgjedhje të shkruarit në gjuhën italiane ka qenë një “imponim”: imponim i mendjes, fjalive të para, skenave fillestare, një proces i ngadaltë që erdhi vetiu, pa e kërkuar unë.

Për 16 vite jetova me italishten; tekstet e dokumentarëve (duke e realizuar për televizionin publik zviceran, për të cilin ende punoj) i shkrova e i shkruaj në gjuhën italiane. Italishtja, pra, ishte/është gjuha e gjallë. Gjuhët janë si njerëzit, si lulet e bimët, po s’u hodhe ujë vyshken... Pra duke përjetuar gjuhën - kur ndjeja “urgjencën” e librit të shtatë, ndërtuar në kokë - sa herë që shkruaja në mendje fillimin, atmosferat, fjalitë e paragrafet imponoheshin në italisht. Dhe “e bukura” ishte se ndërkohë jetoja e punoja në Washington D.C., Shtetet e Bashkuara. Pra përditshmëria ishte anglishtja. E tekta xhiroja dokumentarë e duke shkruar tekstet në italisht e anglisht, libri tjetër, mbi luftën e Kosovës, edhe ai u imponua në gjuhën italiane.... Labirintet e mendjes... Bujrum kush i kupton deri në fund. Pas 12 vitesh në SHBA, 7 vite në Bregun Lindor e 5 të tjerët në Kaliforninë e Veriut, kthyer në shtëpi, në Zvicër, mendja “luan” me gjuhët gjithë kohës.

A.D: Ambiente të zhurmshme, me mizëri njerëzish, aeroporte, stacione trenash ku duket sikur mbizotëron kaosi dhe njeriu fillon ta humbasë arsyen duke kërkuar fillin për të dalë në krye. Në fund të fundit, a është kjo brendia e njeriut dhe bjerrja e arsyes, fati i tij i pashmangshëm?

E.D: Fati i pashmangshëm është jeta vetë. Varet pastaj si mund ta jetosh, çfarë mund të bësh me të. E sidomos varet se çfarë shansesh a mungesash *shorti* i jetës të ka dhënë, kushtëzuar nga vendlindja, familja e kushtet ekonomike, arsimore e kulture që ajo ka, pra në “ç’rreth” ke lindur: poshtë apo sipër, në shkallën selektive e të pamëshirshme të njerëzimit. Fati shpesh *të bën*. Ose *e bën* ti, në varësi të forcave, inteligjencës, ambicieve e këmbënguljes që ke për t’iu kundërvënë asaj që ke trashëguar me lindjen.

Dikush para shtatë vitesh, një jete e re, moshatar me tim bir asokohe, në një takim të fundit më bëri një kërkesë, sytë ulur për të mos tradhëtuar terrorin para vdekjes: “Do më kujtosh ndonjëherë?”, -tha. “Vetëm ndonjëherë, nëpër vite, do më kujtosh? Nëse po, dije që sikur të më jepej një tjetër mundësi, këtë jetë të poshtë do ta luaja ndryshe. Por tani është vonë. Tepër vonë. Veç kujtomë, ndonjëherë, *will you?*”

Ishte një nga të fundmit e kësaj toke. Jeta e kish tradhëtuar në çdo aspekt të mundshëm. E megjithatë kishte kthjelltësi në atë dëshpërim e pendesë të tijën, kishte dinjitet. Kishte

një bukuri të cilën rëndom nuk arrijmë ta kuptojmë pasi përdorim vetëm dy tonalitete gjykimi: të bardhën e të zezën. Na mungon empatia, vështrojmë nga lart, poshtë. Është kaq e lehtë të gjykosh, e kaq e vështirë të kuptosh.

A.D: *Yjet nuk vishen kështu* end me ngadalësi tablonë e një realiteti të pranuar në heshtje, nga kushdo, por të pareklamuar e shpesh, të konsideruar si “i panjohur” dhe “jo i vërtetë”. Por kjo vepër u prit shumë mirë dhe vijon të lexohet e kërkohet, madje edhe është ribotuar. Karakteri i saj sociologjik i shprehur artistikisht me kujdes të veçantë të befason sepse krijon një lidhje të papritur mes lexuesit dhe tekstit. Personalisht, a e konsideroni këtë libër si *kryeveprën* tuaj?


E.D: E konsideroj një libër të nevojshëm. Ishte një faqe e errët e historisë sonë të afërme, e së keqes që shpërtheu nga gjiri i shoqërisë shqiptare në ato vite të egra në mungesë të një shteti të denjë për t’u quajtur i tillë. Ishin vite të një tuneli të errët pis, të një ideje shumë të vagët se ç’duhej të ishte Shqipëria e së ardhmes - dhe me këtë dilemë Shqipëria ende po përpëlitet sot. Ai libër mori formë pas shumë pikëpyetjesh e vraje të mendjes brenda meje. Do të kisha dashur të mos e kisha shkruar, sepse asnjë zemër gruaj e burri me një fije ndjeshmërie nuk do ish ndjerë mirë të përshkruante atë faqe të errët. Por ja që e bëra.

Para dy muajsh libri doli në gjuhën gjermane, përkthyer nga shqipja me aq dedikim e mjeshtëri nga Florian Kienzle. Për shkak të fushatës së promovimit të librit m’u desh ta rimerrja në duar, të freskoja në kujtesë personazhet, strukturën narrative. Në një farë mënyre, m’u desh ta përjetoja librin nga e para, e të vuaja, si dikur, përgjatë atyre dy viteve të investigimit, para se të ulesha e ta hidhja në letër..

A.D: Sipas jush, për një vepër të arrirë, kanë më shumë rëndësi tematikat e mëdha apo veçanësitë e stilit dhe teknikat e përdorura?

E.D: Do të ishte një përgjigje komplekse, por duke u rrekur ta sintetizoj: Një libër i arrirë është një arritje harmonioze e të gjithë elementëve. Duke nisur nga *tematika*. Por çdo të ishte kjo nëse përcillet me një stil të varfër a të pasigurt nga ana e shkrimtarit? Nga ana tjetër, një stil i përkorë, një teknikë e patëmetë por pa një histori, ngjarje, pa emocion, çdo të ishte? Një ushtrim stili, por jo më shumë se aq. Ka ndodhur të lexoj shkrimtarë të cilët i pata admiruar vite më parë. Sot i shoh të shteruar, të ngatërruar në zorrët e tyre letrare, ndaj nuk më interesojnë më.

Në leximet përshfij çdo zhanër, duke gërshetuar shpesh “high literature” and “low literature”, pa paragjykitje të sojit, pasi më intereson të kuptoj prodhimin artistik të kohëve që po kalojmë. Hulumtim që bëj edhe në kinemanë: ha “bukë e letërsi e kinematografi”, kryqëzoj e krahasoj, e gjej vlëra (apo jovlera, kur ky është rasti). Por duke u kthyer tek letërsia, në



poezi e prozë. Çdo zhanër ka vlerat e veta e i shërben atij lexuesi, asaj *niche* të interesuar për të, pasi shijet janë aq të larmishme sa ç'është njerëzimi. Por personalisht kam nevojë të provoj admirim për ndërthurjen e personazheve, konstruktin solid për shtresat e mbishtresat në një libër. Kam nevojë të gjej jetë që pulson përtej stilit. Kam nevojë të mbetem në fund me atë shijen e parrëfyeshme të kënaqësisë së thellë e cila të lë pa gjumë. Kam nevojë të ndjej dëshirën t'i rikthehem përsëri atij libri.

A.D: Edhe pse ju jetoni jashtë, Shqipëria është gjithnjë e pranishme në veprën tuaj. Çfarë ju lidh kaq fort me të?

E.D: Sepse-të e mia dalin pjesërisht në rreshtat e përsiatjet e mësipërme. Kudo që të jem, çfarëdo të mohoj a pohoj, me çfarëdo që të merrem, në letërsi, dokumentaristikë apo kinematografi, prejardhja, rrënjët, *djepi* mbetet ai i gjuhës nënë, i njëfarë vizioni “dramatik” të gjallesës e rrugëtimit, privat apo letrar.

A.D: Proza juaj ndërthuret mes asaj së gjatës (roman) dhe së shkurtër (tregim). Sipas jush, me çfarë lidhet ndryshimi i kësaj lakoreje?

E.D: Toka ime më pjellore është narracioni i formës së gjatë: romani. Por dashuroj me po të njëjtën forcë tregimin: e konsideroj më pranë poezisë. Nëse romani të lejon aty-këtu ndonjë fjali apo paragraf “dembel” (dhe të më ndjeni huazimin nga anglishtja këtu: *lazy sentences...*) **të cilat në ekonominë e përgjithshme të strukturës janë në mos ideale, të pranueshme, tregimi nuk fal asgjë. Ai imponon një ritëm e një nikqorllëk në çdo fjali, në çdo faqe. Ka pra një "ashpërsi" teknike, tregimi i shkurtër është rigoroz, si një prind i rreptë, deri në fjalën e fundit. Së paku, unë kështu e konceptoj.**

A.D: Në letërsi, prej kohësh vërehet mungesa juaj. Nuk po ju pyes pse, por deri kur?

Vërehet mungesa? Vërtet? Unë kam përshtypjen se lexuesit e rinj, mes 20 e 30 vjeçarëve, as më kanë lexuar, ndoshta për shkak breznor, për arsyen se nuk jetoj në Shqipëri, pra jo e pranishme në *agora-në* mediatike vendase. Por besoj se nuk mungoj edhe pasi ndërkohë ka një sërë poetësh, shkrimtarësh/shkrimtarësh që plotësojnë etjen e dëshirën e lexuesit të etur në Shqipëri.

Arsyeja e parë përse nuk i jam ofruar lexuesit në shqip në vitet e fundit është mungesa e lahtarshme e kohës, për shkak të aktivitetit profesional këtu ku jetoj e punoj.

Arsyeja e dytë dhe më e rëndësishmja, është një respekt (i kthyer gati në obsesion) ndaj gjuhës mëmë. Sikur më ka “rrëshqitur” ndër vite, (a ndoshta unë e shoh kështu) pasi siç thashë dhe më sipër, gjuhët janë si bimët: duhen ujitur e fertilizuar, ndryshe thahen. E kësaj i druham, tharjes. Duke mos jetuar në Shqipëri prej shumë kohësh, duke mos jetuar gjuhën e gjallë, druham t'i bëj një shërbim jo të mirë. Ndoshta janë “mburoja” të kota që i vë vetes, a ndoshta janë me vend. Por kur lexoj faqe të bukura shkruar në shqip, mbaj shënime. Ja këtë fjalë e kisha harruar. Këtë shprehje nuk e njihja fare...

Fakti është që në shqip shkruaj. Veç nuk kam ngut të botoj. Kam thujse të mbaruar një vëllim tregimesh prej kohësh, por nuk kam ndërë shtysën ta limoj e ta bëj gati për shtyp. Do vijë momenti.

Me moshën ardhka një lloj qetësie (të paktën për mua). Nuk ngutem. Nuk kam ç'të demonstroj. Nuk më intereson vëmendja a suksesi, më intereson cilësia e jetës, e asaj pak që kam bërë. Kjo është. Me moshën ardhkan ndryshimet, përparësitë që zhvendosen, një mungesë “alarmi” se këtë apo atë s'e bëra dot gati për botim. E kjo nuk më ndodh vetëm me krijimtarinë në shqip.

Romanin e fundit, shkruar në gjuhën italiane, “In coda all'ultimo buio”, sapo e kam përfunduar. Për shkak të kompleksitetit të strukturës narrative e të një procesi të gjatë hulumtimi - ku çdo gozhdë duhej të *binte* në vendin e vet - libri u kthye në njëfarë pëlhere të Penelopës. Sikur nuk dëshiroja ta përfundoja...

Ndryshe ndodh me dokumentarët. Janë punë të gjata, dy vjeçare zakonisht, marrin mund e nuk lënë absolutisht kohë për të shkruar letërsi. Janë edhe punë kolektive, të një skuadre e të produksionit, ke të bësh me një buxhet. Ndaj imponojnë *konfeksionimin* e dorëzimin, me një datë të caktuar transmetimi.

Libri është krejt personal. Je ti me veten, me ritmet që ndjen së brendshmi, e si rrjedhojë je edhe “padron” i tij, e komandon vetë kur dëshiron t'ia lejojsh të të *braktisë*.

Ja kështu, më qëllon që “punët” letrare nuk dëshiroj t'i lëshoj nga duart...



A.D: Ka shumë shkrimtarë që, duke parë rënien e interesit për librin, krijimtarinë e tyre e publikojnë edhe, apo vetëm në *facebook*. Me sa kam parë, ju nuk e bëni diçka të tillë. Si mendoni, në ç'mënyrë kanë ndikuar rrjetet sociale në dinamikën e përgjithshme të botës së letrave shqipe?

E.D: Në mënyrë krejt egoiste, kur lexoj poezi, jo rrallë të mrekullueshme në facebook, nga poete e poetë shqiptare, u jam mirënjohëse, ndryshe nuk do kisha mundësinë t'i lexoja

ato krijime. Dhe po me egoizëm hyj rrallë në facebook, për vetëmbrojtje nga zhurma. Në agorà-në shqiptare bërtitet shumë, por flitet pak. Nuk është një dukuri a *fenomen* vetëm shqiptar... Temë e gjatë për t'u tjerër, e kjo biseda jona druaj se doli shumë e gjatë për durimin e lexuesit.


Duke u kthyer tek pyetja juaj: ofrimi i krijimtarisë në mediet sociale është një përzgjedhje personale. Mjaft shkrimtarë/prozatorë shqiptarë - të diasporës apo që jetojnë në Shqipëri - postojnë veç titullin e librit, ndonjë artikull lidhur me librin, shënojnë botimin e veprës në një gjuhë të huaj. Ndryshe me poetët, ku shpesh lexon postime vargësh. Ndoshta ngaqë poezia është më imediate, më e shkurtër, me një impakt më të drejtpërdrejtë, poetet/poetët përzgjedhin t'i postojnë krijimet e tyre.

Nuk ka një formulë “fituese” në këso rastesh. Secili përzgjedh mjetin e tij/saj. Disa vargje sublimë në një ditë “gri” të ekzistencës janë një rreze dielli e mrekullueshme. Shoh që populli i mediave sociale ndjek e shijon shpeshherë. Ka komente me vlerë. Ka shpesh edhe komente që duan të jenë lavdëruese *per sé*, por nuk dinë se si, ndaj për krijuesin - imagjinoj - janë frustruese, pasi janë tejet naive ose me fjalë të zbrazëta.

Nga ana tjetër poetët shqiptarë, më shumë se prozatorët, kanë nevojë për një lexues, pasi poezia është shpesh “fëmija illegjitim” për shtëpitë botuese, brenda e jashtë vendit. Me justifikimin se poezia nuk lexohet, pra “nuk shet”. Ndaj ç'duhet të bëjnë poetët, të mbyllën në kuvlinë e atyre të paktëve që blejnë vëllimin kur botohet, nëse botohet, në më të lumturin e rasteve?

A.D: Dhe në fund, vihet re një rënie e ndjeshme e ndikimit që gazetatat kanë në shoqëri; shumica syresh e kanë hequr edhe suplementin letrar dhe kulturor. Si e shihni këtë fakt?

E.D: E shoh si një funeral të dijes, kulturës. E shoh si një mëkat të madh, në dëm të krijimit të një shoqërie të ditur, të emancipuar. E shoh si një atentat kundër krijimit të një brezi të ri të shëndetshëm, i cili duhet pajisur me instrumentet e duhura për të ndërtuar një shoqëri e një Shqipëri të përparuar e të pasur shpirtërisht. Po u heqim të rinjve mundësinë e një busulle orientimi të vlerave; po u lëmë të kuptojnë si ai që ka miliona është modeli, por kush jep e krijon dije e kulturë, është një farë Donkishoti i panevojshëm.



Gjuha vijon të mbetet njëri ndër elementet thelbësore, me të cilën arbëreshët identifikojnë veten, por edhe dallohen prej *tjetrit*. Bjerrja e saj është shndërruar në një shqetësim thelbësor të poetëve të atjeshëm, gjë që pasqyrohet edhe në një pjesë të krijimtarisë së tyre, siç ishte rasti i Giuseppe Schiro di Maggio-s. Ky fakt përlligj edhe një prirje të përgjithshme të shkrimtarëve arbëreshë për të shkruar në shqipen standarde, si një mënyrë kjo edhe për t'u afruar më tej me *tjetrin e brendshëm*.

TRAJTAT E TJETRIT NË POEZINË E SOTME ARBËRESHE

Nga Hysni Ndreu

1. Hyrje

Letërsia e arbëreshëve të Italisë, pavarësisht rrethanave historike e kulturore, në të cilat është krijuar e zhvilluar, ka mundur të krijojë një profil të saj, i cili identifikohet me Lekë Matrëngën, Jul Varibovën, De Radën, Seremben, Skiroin, Dushko Vetmon, Vorea Ujkon, Luka Perronen e të tjerë. Në gjuhën që përdoret, në temat e motivet që rimerr, në imazhet që ngërthen e na përcjell, kjo letërsi mund të vlerësohet edhe si një tregues i përpjekjeve disashekullore të shkrimtarëve të atjeshëm për të pohuar, identifikuar e vijimësuar ekzistencën e botës dhe të shpirtit arbëresh.

Që në shekujt XV-XVI, kur u shpërngulën nga vendi i tyre për t'u vendosur në jug të Italisë, arbëreshët u gjendën nën dominimin e një kulture dhe shoqërie tjetër më të madhe. Përkundër një asimilimi tërësor, siç mund të ishte krejt e natyrshme të ndodhte, ata krijuan një *ishull*, brenda të cilit u ruajtën gjuha, atdheu arketipik, traditat, mitet dhe legjendat. Pra, u ruajt ajo pjesë e atdheut të humbur, të cilën mundën ta merrnin me vete. Të gjitha këto elemente, të transmetuara edhe në rrjedhë të kohëve, e bënë këtë ishull të dallueshëm prej *tjetrit*, një dallim ky që reflektohet edhe në marrëdhënien me letërsinë.

2. Tjetri si “i huaj”

Në poezinë arbëreshe, *tjetri* nuk shfaqet thjesht si i ndryshmi. Ai është edhe *i huaji*, që do të thotë se nuk ka të njëjtin identitet, origjinë apo gjuhë që ka *vetja*. Vetja gjendet në minorancë si bashkësi, kulturë, gjuhë dhe letërsi, përkundër një epërsie të shoqërisë, kulturës, gjuhës dhe letërsisë së *tjetrit*, që në këtë rast është shoqëria, gjuha, kultura dhe letërsia italiane.

Megjithatë, *tjetri* nuk është domosdoshmërisht edhe kundërshtar i *vetes*. Dallimi ndërmjet tyre është krijuar / krijohe me shumë prej nevojës që ka *vetja* për t'u identifikuar dhe pohuar si ekzistencë. Ajo (vetja) nuk shfaqet si refuzuese e kulturës së *tjetrit*, por as si përthithëse tërësore e saj: ruan gjuhën e vet (variantin e arbërishtes a shqipen standarde), por nuk refuzon as gjuhën e *tjetrit* (italishten); ligjërimi poetik i *vetes* është i dallueshëm, por edhe në marrëdhënie me ligjërimin poetik të *tjetrit*. Ky ndërkomunikim midis *vetes* dhe *tjetrit* krijon një formë të re ekzistence, ku bashkëjetojnë e bashkëshkrihen dy kultura, dy gjuhë dhe dy sisteme ligjërimore poetike.


Çështjet dhe problematikat që karakterizojnë e nxjerrin në pah ankthin e shkrimtarëve arbëreshë në përballjen me *tjetrin* janë të shumta. Ndër shqetësimet më thelbësore të tyre mbetet ruajtja e gjuhës, si mjeti kryesor, me të cilin mund të vijojnë të pohojnë ekzistencën. Në dhjetëvjeçarët e fundit, të vetëdijshëm se arbërishtja po shkon drejt shuarjes së plotë, ata i kanë kthyer sytë për nga shqipja standarde, një mundësi kjo edhe për të krijuar lidhje më të konsoliduara me kulturën dhe gjuhën e dheut mëmë.

Aktualisht, pjesa më e madhe e këtyre shkrimtarëve shkruajnë në shqipen standarde, duke ruajtur edhe ndonjë element arbëresh, gjë që në bashkëkohësi u bë edhe më e domosdoshme për shkak të globalizmit dhe një vargu procesesh që e pasuan atë, të cilat nisën ta kanosnin seriozisht ekzistencën e variantit të arbërishtes. Vetëdija e këtij rreziku shprehet edhe në një artikull që hapte numrin e parë të revistës letrare “Vija”, me titull *Pse po dalim*. Aty theksohej: “... duam ta lidhim kulturën tonë me atë të atdheut, se ndryshe, ne jemi të bindur, ajo do të shuhet dhe të zhduket përgjithmonë, dhe ne do të humbasim. Andaj edhe gjuha që do të përdoret në fletushkën tonë duhet të jetë vetëm gjuha letrare e sotme. Ne mendojmë që nuk ka rrugë tjetër për ta pasuruar dhe ta përmirësuar gjuhën dhe kulturën arbëreshe veçse me lidhje sa më të plotë me gjuhën dhe kulturën e mëmëdheut. Copëtimi i gjuhës është copëtimi i kombit dhe copëtimi i kombit shpie domosdo në zhdukje.” (Revista “Vija”, nr. 1, 1967)

2.1. Gjuha ime përballë tjetrit

Çështja e përballjes me tjetrin ndeshet në krijimtarinë e thuajse të gjithë poetëve bashkëkohorë arbëreshë. Giuseppe Schirò di Maggio, ndër më cilësorët e ditëve të sotme, e konfiguronte atë nëpërmjet formash nga më të larmishmet. Te vëllimi me poezi “Kopica e ndryshku” (një bisedë shqipe-arbëreshe në trajtë poezie), *tjetri* zbulohet përmes shëmbëll-tyrës së të gjitha elementeve të jashtme, të cilat kërcënojnë zhbërjen e arbërishtes, gjuhës së parë të subjektivit lirik.

Kopica e ndryshku janë të pranishme në secilën poezi



të këtij vëllimi, herë duke u përmendur në mënyrë të drejtpërdrejtë, herë të tjera duke u nënkuptuar. Ato shndërrohen kështu në simbol të të gjitha dukurive, që i kanë ekspozuar rrënjët e identitetit dhe të gjuhës arbëreshe ndaj pushtetit të *tjetrit*, ndër të cilat shoqëria e konsumit, martesat jashtë trungut, televizioni, rrethanat ekonomike, mungesa e shkollave shqipe etj..

Titulli i këtij vëllimi poetik, “Kopica e ndryshku”, ka referencë biblike: “Mos grumbulloni për vete thesare mbi tokë, ku i brejnë **tenja** (lexo: kopica - shënim i imi, H. N.) **e ndryshku**, ku vjedhësit birojnë muret e vjedhin.” (Mateu 6,19) (Bibla: 2011). Në këtë citim të Biblës, *tenja* dhe *ndryshku* paraqiten si kërcënime. Objekt i këtyre kërcënimeve është thesari. Nga kjo bartje ndërtekstore, ku diskursit letrar i shtohet edhe ai biblik, poeti ruan të njëjtën semantikë të *kopicës* dhe të *ndryshkut*, por i rikontekstualizon si fjalë për të shenjuar një problematikë të re, atë të rrezikut që po kërcënon arbërishten. “Situatat e vështira ekzistenciale ndërlidhen me ngjarje biblike, për të nxjerrë mesazhe filozofike që transmetojnë dhe shprehin një revoltë karshi realitetit.” (Ndue, U., material online) Edhe poezia e parë e këtij vëllimi hapet me një referencë biblike: *Tek është thesari yt / atje edhe do të jetë / zemra jote. (Mt. 6,21)* Fjala thesar, e pranishme në të dy citimet e Biblës, e ruan thelbin e vet kuptimor edhe kur përmendet në poezi, duke u mishëruar me të gjitha ato elemente që përbëjnë identitetin e bashkësisë arbëreshe, ndër të cilat, dhe më kryesorja, gjuha.

Referenca të tilla biblike, të cilat i mbishtresohen ligjërimin letrar, krijojnë një analogji të pjesshme ndërmjet dy dukurive të kohëve të ndryshme, që në thelb lidhen me filozofinë ekzistenciale dhe të mbijetesës. Përsiatje të kësaj natyre janë shenja të një prirjeje për të universalizuar dhe rritur ndjeshmërinë ndaj tematikës në fjalë, por edhe për t'i dhënë asaj ngjyresa të shpirtërores.

I gjithi ky tekst u nënshtrohet raporteve shkak/pasojë. *Kopica* dhe *ndryshku*, dy terma kyç të tij, krijojnë metaforën e madhe të shkaqeve. Kjo metaforë zbërthehet e kuptimësohet më tej nëpërmjet trajtash më të vogla, që vijnë përmes elementesh me veprim konkret: *pushteti i kulturës dhe i fjalës së huaj, mungesa e shkollave në gjuhën shqipe, konsumi, nevoja për tregti* etj.. Në anën tjetër kemi pasojën, e shenjuar nga grupe fjalësh, që bartin ngjyresa negative: *ndikime të pandreqshme, humbja e fjalëve tona, dëm i pallogaritshëm, uri e furishme*. Raportet shkak/pasojë përvijohen edhe në marrëdhënien midis vargjeve të veçanta:

*kopica e ndryshku
të hanë thesarin
kopica e ndryshku
të grijnë të folmen
kopica e ndryshku
të shtrembërojnë identitetin,*
(Di Maggio, G., tekst në dorëshkrim)

ku shkak theksohet nëpërmjet të njëjtit varg, *kopica dhe ndryshku*, duke u përsëritur tri herë, në formë këmbënguljeje. Vargjet e tjera shenjojnë pasojën dhe jepen përmes grupeve të fjalëve: *të hanë thesarin, të grijnë të folmen, të shtrembërojnë identitetin*. Në përbërje të këtyre grupeve hasen tri folje, që të gjitha me ngarkesë negative: *të hanë, të grijnë, të shtrembërojnë*, përkundër tre emrave, që të gjithë me ngarkesë pozitive: *thesar, e folme, identitet*. Jo pa qëllim, të tria foljet janë të formës veprorë, sepse i referohen një veprimi, një procesi që po ndodh dhe jo rastësisht janë vendosur në kohën e tashme, sepse i referohen aktualitetit, asaj që tashmë po ndodh.

2.2. Metafora e zhbërjes

Çështja e bjerres së gjuhës bëhet objekt trajtimi poetik edhe në disa poezi të librit tjetër të këtij autori, atij me titull *Metaforë*, një tekst dygjuhësh, shqip dhe italisht. Poeti krijon këtu referenca konkrete identitare, që shenjojnë vetëdijen historike e kulturore të bashkësisë arbëreshe: Skënderbeu, Moreja, De Rada, Serembe, Varibova, të cilët rreket t'i shndërrojë në kode ndërgjegjësimi e kujtese. Nëpërmjet përmendjes së tyre krijohet një raport i së shkuarës (prejardhjes, rrënjës), me të tashmen konkrete (rrezikut për asimilim), më shumë si kundërvënie, sesa si përafrim. Këto dy përmasa kohore, në poezinë e Di Maggio-s plotësohen edhe me një përmasë të tretë, që është e ardhmja. Ato janë në një takim të vazhdueshëm: e para si thirrje, kujtesë dhe vetëdije; e dyta si shqetësim e ankth konkret, si shkak; e treta si shenjëzim i bjerres tërësore dhe humbje e vetëdijes, si pasojë.

Ja se si shkrihen e ndërthuren këto tri përmasa në poezinë “Çervikati” (Cervicati), ku e shkuara vjen metaforikisht nëpërmjet gjuhës së parë (arbërishtes), e tashmja nëpërmjet gjuhës së dytë dhe belbëzimeve të pleqve në gjuhën e parë (bjerria, asimilimi), ndërsa e ardhmja nëpërmjet para-lajmërimit “*as edhe pleqtë do të qëndrojnë më*”:

Një ditë të erdhi turp

për veten tënde e për fjalët e tua

dhe lipe shkurorëzim nga gjuha jote e parë!

Një perëndi fitimtare veproi mbi ty shndërrimin

e sot ke vetëm gjuhën tënde të dytë.

Mund të mburresh me kaq për ndonjë

pikë qëndrese:

ca pleq belbëzojnë edhe sot

ndonjë shprehje të gjuhës së parë!

Por rri në pritë – ka qenë përherë në pritë –

furtuna e tmerrshme e asaj perëndie fitimtare

një vrundull më të vendosur

e as dhe pleqtë do të të qëndrojnë më.

Por ti mos rri e mërijtur!

(Di Maggio, G., tekst në dorëshkrim)

Vëllimi në fjalë përbëhet nga 54 poezi. Secila prej tyre mban për titull emrin e një katundi arbëresh. Katundi shndërrohet kështu në kryesimbol, prej të cilit, poezi pas poezie burojnë edhe një sërë simbolesh të tjera: guri, vatra, zjarri, pleqtë, kambana bizantine. Kjo e fundit, si shenjëzim fetar i bashkësisë së atjeshme, bartur e ruajtur që prej shpërnguljes së madhe, është njëri ndër elementet identifikuese ende i pazhbërë nga vetëdija e arbëreshëve. Për Di Maggion ajo është mjeti që i lajmëron botës “*titujt e mi të ekzistencës*.”

3. Tjetri i brendshëm

Në poezinë bashkëkohore të arbëreshëve të Italisë, trajtat e *tjetrit* nuk shfaqen vetëm sa i përket përballjes me *tjetrin* si i huaj. Që prej shpërnguljes së tyre në Itali e deri në shekullin e kaluar (pra, për rreth pesë shekuj), ata e patën të pamundur të komunikonin edhe me trugun amë, Shqipërinë. Si rezulltat, kjo bashkësi mbeti e papërfshirë në proceset historike, kulturore, gjuhësore e letrare që ndodhnin në atdheun e tyre të origjinës. Mirëpo, siç shprehet Rexhep Ismajli: “... pamundësia e komunikimit më esencial dhe më të dendur me trugun për më se pesë shekuj ka lënë gjurmë edhe në dallimet midis këtyre maseve.” (Ismajli, R., 1978)

Këto dallime e distanca të krijuara ndërmjet bashkësisë së atjeshme dhe trugut amë, përvijuan atë që Tzvetan Todorov e emërtonte si “Tjetri i brendshëm”. (Todorov, T., 2015) Në këtë rast, njohja e *vetes* është e cunguar, e papërm-bushur, gjë që shpjegon edhe një lloj joshjeje për ta zbuluar e prekur më konkretisht atë. Kjo lloj joshjeje është një thirrje e brendshme që i bëhet *vetes* e drejt së cilës shkohet.

Kështu, poetin arbëresh e grish një hapësirë tjetër gjeografike: Moreja, Shqipëria, Kosova. Është për këtë që, disa nga poezitë e tyre u kushtohen qyteteve shqiptare, personazheve shqiptare, ngjarjeve me rëndësi historike për Shqipërinë. Kjo joshje për t'u zhvendosur “tjetërkund”, krijon një marrëdhënie të “së këtushmes” (vendit ku jetojnë e krijojnë arbëreshët), me “të atjeshmen” (vendin që e shohin si atdhe, si pjesë e të cilit janë e ndihen), një raport, ku e *këtushmja* është *atje* dhe e *atjeshmja* është edhe *këtu*. Përveçse në bashkëkohësi, kjo vetëdije ndaj “tjetrit të brendshëm” ka ekzistuar e është shprehur edhe nga poetët e traditës (kujtojmë vargun e Serembes: “*Arbëria që është prapa detit/ na kujton se të huaj jemi te ky dhe*”).

4. Përfundime

Në krijimtarinë e shkrimtarëve arbëreshë, imazhi i *tjetrit* zë një vend qendror. Trajtat e tij janë dyformëshe: *tjetri si i huaj* dhe *tjetri i brendshëm*. I pari nuk ka të njëjtin identitet, origjinë apo gjuhë që ka *vetja*, ndërsa i dyti lidhet me pjesën e panjohur të *vetes* dhe një lloj prirjeje për të shkuar drejt saj, për ta njohur atë.

Disa nga tematikat, që pothuajse të gjithë poetët e traditës dhe ata të bashkëkohësisë i shndërruan në objekt trajtimi poetik, dhe që shërbyen sa për t'u dalluar prej *tjetrit/të huajit*, po aq edhe për të pohuar *veten* e për t'u afruar me *tjetrin e brendshëm*, janë: evokimi i atdheut, kërkimi dhe ruajtja e rrënjëve, evokimi i historisë dhe i figurave të saj, rifunksionalizimi i miteve e simboleve, rimarrja e figurave të legjendës etj..

Gjuha vijon të mbetet njëri ndër elementet thelbësore,

me të cilën arbëreshët identifikojnë veten, por edhe dallohen prej *tjetrit*. Bjerrja e saj është shndërruar në një shqetësim thelbësor të poetëve të atjeshëm, gjë që pasqyrohet edhe në një pjesë të krijimtarisë së tyre, siç ishte rasti i Giuseppe Schiro di Maggio-s. Ky fakt përligj edhe një prirje të përgjithshme të shkrimtarëve arbëreshë për të shkruar në shqipen standarde, si një mënyrë kjo edhe për t'u afruar më tej me *tjetrin e brendshëm*.

Referenca




- [1]. Berisha, Anton, Nikë. *Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*, [Interpretations of Italian Arbëresh literature] Luigi Pellegrini Editore – Cosenza – Italy, 2008.
- [2]. Bibla (SHKRIMI SHENJIT, BESËLIDHJA E VJETËR DHE BESËLIDHJA E RE), përktheu e shtjelloi Dom Simon Filipaj, botim i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë, Tiranë 2011.
- [3]. Çabej, Eqrem. *Në botën e arbëreshëve të Italisë (Përmbledhje studimesh)*, [In the world of the Arbëresh of Italy (Summary of studies)] shtëpia botuese “8 NËNTORI”, Tiranë 1987.
- [4]. Di Maggio, G., *Kopica e ndryshku – një bisedë shqipe-arbëreshe në trajtë poezie*, [Moth and roset – an albanian-arbëresh conversation in form of poetry]. Pa vit botimi. Në këtë punim i jemi referuar tekstit në dorëshkrim.
- [5]. Di Maggio, G., *Metaforë – vjersha*, [Metaphor – poems] botim dygjuhësh, shqip dhe italisht. Pa vit botimi. Në këtë punim i jemi referuar tekstit në dorëshkrim.
- [6]. Giordano, Emanuele. *Fjalor i arbëreshëve të Italisë (Dizionario degli Albanesi d'Italia)* [Dictionary of the arbëresh of Italy] Edizioni Paoline – Bari, 1963.
- [7]. Ismajli, Rexhep. *Rrënjë e fortë (Poezia arbëreshe e ditëve tona)*, [Strong root (Arbëresh poetry of our days)] RILINDJA, Prishtinë 1978.
- [8]. Kamsi, Kolë. *Fjalor arbërisht-shqip*, [Arberian-albanian dictionary] Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër 2000.
- [9]. Levinas, Emmanuel. *Time and the Other [and additional essays]*, Duquesne University Press, Pittsburgh 1987.
- [10]. Levinas, Emmanuel. *Totality and Infinity – An Essay on Exteriority*, Martinus Nijhof Publishers, Boston 1979.
- [11]. Todorov, Tzvetan. *Konkista e Amerikës – Çështja e “tjetrit”*, [The Conquest of America: The Question of the Other], përktheu nga origjinali Primo Shllaku, Pika pa sipërfaqe, Tiranë 2015.

Periodikë

“Vija”, [The line] numër 1, Frascineto 1976, revistë e përkohshme letrare, organ i Rrethit të Shkrimtarëve dhe Artistëve Arbëreshë. Motoja e saj: “Një gjak një gjuhë”. U themelua nga Dushko Vetto (pseudonim i Francesco Solano-s).

Burime elektronike

Ukaj, Ndue. *Diskursi bibliotekë në letërsinë shqipe* /on-line/. Shkëputur më 05.08.2020 nga: <https://shkodraloce.wordpress.com/2013/07/03/diskursi-bibliotek-ne-lettersine-shqipe/>.



Me profesreshën dhe Presidenten në ardhje të
Shoqatës për Studime Shqiptare në SHBA

Ines Murzaku: Nuk ka njeri, këtu në Amerikë, të mos ketë dëgjuar për nënë Terezën tonë

Intervistë dhënë gazetares Mimoza Hasani Pllana



marrin pjesë në Konkursin për Kumtesën më të mirë shkencore për nder të Arshi Pipa, edhe kjo e sponsorizuar nga Shoqata për Studime Shqiptare.

M.: Sa keni arritur të promovoni personalitete dhe figura të çmuara të kulturës, gjuhës dhe letërsisë shqiptare në SHBA?

I.M.: Kolegë si Dr. Elez Biberaj, Prof. Nicholas Pano, Dr. Elton Skendaj, Dr. Elidor Mehilli, Dr. Anna di Lellio, Dr. Jeta Rudi Polloshka, Dr. Besnik Pula dhe Dr. Alexis Zoto, janë kolegë që marrin pjesë në konferencë çdo vit. Ata janë mjaft të dedikuar në studimet shqiptare. Nëpërmjet punës dhe kërkimeve të tyre ndërdisiplinare, mendoj se kemi arritur ta ngremë vëmendjen mbi Shqipërinë e shqipëtarët kudo që janë. Jemi një vend i vogël dhe një fushë mjaft e ngushtë. Duke qenë pjesë e kësaj organizate të madhe ne po lëmë mbresën tonë tek studiuesit amerikanë, ose tek studiuesit nga vende të tjera të botës.

M.: Në universitete të ndryshme në SHBA, është e mundur të realizohen studime për gjuhët e ndryshme evropiane dhe ballkanike, a është e mundur të studiohet për albanologjinë në nivel universitar?

I.M.: Për këtë nuk kam njohuri, nëse gjuha shqipe studiohet këtu ashtu si në departamente të tjera në Evropë. Por, për shembull në kurset e mia në histori e teologji, unë gjithnjë i prezantoj studentët me historinë shqiptare, fenë, kontributin e një populli të vogël, por që gjithnjë ka dhënë më tepër se ka marrë. Unë mendoj se si komb dhe histori ne kemi shumë për të kontribuar.

M.: Letërsia shqiptare tashmë ka një trashëgimi të çmuar letrare e kulturore si rezultat i punës shumëvjeçare të personaliteteve të çmuara që jetuan dhe vepruan në SHBA. Veçojmë dy nga figurat me të mëdha letrare, Faik Konicën dhe Fan Nolin, të cilët përveç se lanë trashëgimi të shkruar, drejtuan edhe shoqata dhe revista në gjuhën shqipe. A do të thotë se shoqata që drejtoni synon vazhdimësinë e shenjave të hershme kulturore shqiptare në SHBA?

I.M.: Po patjetër. Tradita duhet kultivuar, ndërsa ecim përpara. Shoqata ka vizituar Bostonin dhe kishën historike të shqiptarëve. Në vitin 2018, njeri nga panelet e konferencës u zhvillua atje dhe komuniteti shqiptar i ri dhe i vjetër ishin të ftuar.

M.: Bazuar në hulumtimet tuaja, cilët janë autorët shqiptarë, vepra e të cilëve është e lexueshme

Mimoza Hasani Pllana: *Profesreshë Ines, aktualisht përveç punës në Universitet, jeni zgjedhur presidente në ardhje e Shoqatës për Studime Shqiptare, me bazë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo shoqatë është e përkushtuar për promovimin e studimit profesional të kulturës, gjuhës dhe çështjeve të shoqërisë shqiptare, në të gjitha qendrat, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Verit, Mali i Zi, dhe diasporë. A mund të flasim më gjerësisht për misionin dhe rezultatet që keni arritur në këtë qendër prej themelimit?*

Ines Murzaku: Unë jam zgjedhur Presidente në ardhje nga 2020-2022 dhe në 2022 do të jem Presidente e Shoqatës për Studime Shqiptare (SAS). Kjo është shoqata më e madhe shkencore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për studimet mbi Shqipërinë e Shqiptarët. Kjo shoqatë është nën ombrellën e shoqatës Amerikane për Studime mbi Sllavistikën, Evropën Lindore dhe Euroazinë me akronimin ASEES. Misioni i shoqatës është si vijon: "Shoqata për Studime Shqiptare është

një organizatë akademike, interdisiplinare, ndërkombëtare me bazë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e përkushtuar për promovimin e studimit profesional, kritikës dhe hulumtimit të të gjitha aspekteve të kulturës, shoqërisë dhe politikës shqiptare, veçanërisht në lidhje me vendet e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, si dhe diasporës shqiptare në të gjithë botën."

Çdo vit, Shoqata sponsorizon dy ose tre panele që kanë të bëjnë me studime mbi Shqipërinë, Kosovën e vise të tjera shqiptare. Panelet përqendrohen në historinë, politikën, antropologjinë dhe kulturën shqiptare. Rezultati është që një grup i shkencëtarëve dhe profesorëve këtu në Amerikë janë të dedikuar të prezantojnë me nivel të larta shkencore kërkimet e tyre mbi Shqipërinë. Pra është një traditë e krijuar dhe që ne po e vazhdojmë e thellojmë çdo vit.

Shoqata jep çdo vit çmimin "Stavro Skendi" për librin më të mirë në Studimet Shqiptare. Gjithashtu, studentët e diplomuar janë të ftuar të



për lexuesit amerikan, përmes përkthimit?

I.M.: Mendoj Ismail Kadare.

M.: Si është bashkëpunimi juaj me studiuesit amerikanë që shprehin interesim për gjuhën shqipe? Kë veçoni?

I.M.: Bashkëpunimi është shumë i ngushtë. Shoqata është gjithnjë e gatshme të akomodojë çdokënd që është i interesuar në kulturën tonë. Kemi edhe një numër studentesh amerikanë, apo evropianë të interesuar në studimet mbi Shqipërinë, numri i të cilëve po rritet nga viti në vit.

M.: Jeni profesoreshë religjioni në Seton Hall University, dhe nga kjo perspektivë keni shkruar një libër për Nën Terezën, nobelisten e parë shqiptare,

gruan që nxiti shumë njerëz të kërkojnë dhe të njohin popullin shqiptar dhe madje ta duan popullin e saj, bazuar në sjelljet dhe veprimtarinë e Nënë Terezës. Si vlerësoni ju, sa ndikoi vepra e Nënë Terezës, për promovimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare?

I.M.: Mendoj se shumë, Nënë Tereza është nderi i kombit tonë. Ajo mishëron kombin tonë, vlerat tona më të mira që janë bërë shembull për botën. Ajo tregon se një popull i vogël, si populli shqiptar ka shumë për të kontribuar. Nënë Tereza është ambasadorja par excellence e popullit shqiptar, të pandarë për solidaritetin e duke ecur përpara. Nuk ka njeri, këtu në Amerikë, që të mos ketë dëgjuar për nënën tonë. Nuk flas vetëm për katolikët, Nëna është nënë e të gjithë njerëzimit, e të gjithë të vuajturve. Mund të hapësh një kurs të tërë në vlerat shqiptare duke e përqendruar

tek Nënë Tereza. Dhe këtu flas nga praktika. Edhe pse pa doktoratë në teologji, Nënë Tereza është teologe, zgjuarsi shqiptare. Po.

M.: A mund të flasim për projektet tuaja aktuale lidhur me promovimin dhe zhvillimin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare në SHBA?

I.M.: Jam duke punuar mbi një libër mbi historinë kishtarë të arbëreshëve. Gjithnjë duke pasur parasysh potencialin e një populli të vogël për të arritur gjëra të mëdha në rastin e arbëreshëve, kontributin e tyre për ekumenizmin. Historia e kishës arbëreshe dhe sidomos mbijetesa e tyre është diçka për t'u hulumtuar.

INES ANGELI MURZAKU është Professore në Universitetin Seton Hall në New Jersey, Drejtore e Programit të Studimeve Katolike dhe Kryetare Themeluese e Departamentit të Studimeve Katolike në Universitetin Seton Hall. Ajo fitoi një doktoraturë kërkimi nga Instituti Oriental Papnor në Romë, pjesë e Konsorciumit Universitar Papnor Gregorian (Pontifical Gregorian University) dhe ka mbajtur pozita akademike në Universitetet e Bolonjës dhe Kalabrisë në Itali dhe Universitetin e Munsterit në Gjermani. Ajo ka fituar bursa studimi duke përfshirë bursën prestigjioze Alexander von Humboldt Fellowship Research për Studiues me Përvojë; Grant i Këshillit të Kërkimeve të Shkencave Sociale dhe Humane të Kanadasë (SSHRC); dhe tre herë fituese e Fulbright - burse prestigjioze nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për profesore e studiues Amerikanë. Kërkimi i saj është botuar në shumë artikuj dhe tetë libra. Publikimet e Prof. Murzaku përfshijnë: Nënë Tereza: Shenjta e Periferive (Paulist Press, 2021); Jeta e Shën Neilos të Rossano (1004) (Harvard University Press 2019); Monastizmi Italo-Grek (Ashagte-Routledge 2018); Monastizmi në Evropën Lindore dhe Ish Republikat Sovjetike (Routledge 2016); Tradita Monastike në Krishtërimin Lindor dhe Botën e Jashtme një Thirrje për Dialog (Peeters University of Leuven 2013); Kthimi në Romë? Murgjit e Grottaferrata në Shqipëri (Analekta Kryptopherres 2009); Quo Vadis Evropa Lindore? Feja, Shteti dhe Shoqëria pas Komunizmit (Longo, Università di Bologna 2009); dhe Katolicizmi, Kultura dhe Konvertimi: Historia e Jezuitëve në Shqipëri (1841-1946) (Orientalia Christiana Analekta, Instituti Oriental Papnor 2006).

Ines Murzaku është zgjedhur Presidente në ardhje nga 2020-2022 dhe në 2022 Presidente e Shoqatës për Studime Shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SAS). Kjo është shoqata më e madhe shkencore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për studimet mbi Shqipërinë e shqiptarët. Prof. Murzaku ka shërbyer si nënkryetare e Shoqatës për Studimin e Kombësive (ASN) dhe një përfaqësuese e akredituar e Kombeve të Bashkuara për organizatën Christian Associated for Marrëdhëniet me Evropën Lindore. Ajo është një komentuese e rregullt e mediave për çështje fetare. Ajo ka punuar ose ka bashkëpunuar me Associated Press, CNN, Zëri i Amerikës, Relevant Radio, The Catholic Thing, Crux - Taking the Catholic Pulse, Salt and Light Catholic Foundation Foundation (Kanada), Catholic World Report, National Catholic Register, The Record, The Stream, Radio Tirana (Shqipëri), Radio Vatikan (Qyteti i Vatikanit) dhe Rrjetin Televiziv të Fjalës së Përgjithshme (EWTN-Romë).



MOTHER TERESA

SAINT OF THE PERIPHERIES

INES ANGELI MURZAKU

Poezia e Agim Matos në mes erërave të Poseidonit

Nga Natasha Lako



“Afër mëngjesit, mjergullat, zbresin në Gramata dhe lëshojnë vezët në fund të Jonit”.

Është poeti Agim Mato që në këto vargje befasuese na ndjell në këtë botë nga qielli në fund të detit, nëpërmjet poezisë “Llogara”.

Dhe prapë se prapë në këtë botë poetike të Agim Matos duket sikur përfundojnë të gjithë profecitë.

Dhe ky është poeti që ka ndërre edhe izolimin, poeti që në një fashikull të vëllimit të tij “Lundrimet”, të vitit 2014, flet për njeriun që lundron me shpirtin dhe që nga lashtësitë na kujton edhe botën aristoteliane.

Lexuesi që ka ndjekur poezinë e këtij poeti jonian e ka ndjekur edhe dallgën poetike të ngritur lart, që përgatiti edhe zhytjen në thellësi të vëllimit “Lundrimet” i nisur nga motivet e ashpra të vëllimit “Fundo”, ku me një konkretësi gërryese shfaqen plot miq e shokë dhe jeta e përditshme pothuaj e prekshme e një autori sarandiot, atje, ku Andrea Zarballa, për Kvafisin dhe kronikën e tij të përgjithshme të jetës dhe historisë së trupit, do të merrte si këmbim prej Matos një kronikë më konkrete dhe të rrallë të vuajtjeve, urrejtjeve dhe përgjërimeve, pa të cilët nuk mund të hapen as dyert e përjetësisë joniane.

Dhe “Fundo” një prej poezive paraprirëse të “Lundrimeve” parapergatit, në zhargonin “fundo” të Sarandës, hedhjen që nga lart në sipërfaqe jete të trazuar në thellësi;

“kur në adoleshencë merrnim fundo dhe rëshqisnim mbi barin e fund detit,

Si tufat e peshqve që nxitonin të trëmbura.”

si thotë poeti. Thua që vjen dita edhe në një krijimtari poetike, që përsëri atje, në fund të detit edhe mjergullat, edhe njeriu edhe peshqit edhe fatet të bëhen një. Dhe kjo mund të ndodhë vetëm në kthjelltësitë më të mëdha joniane!

Atëhere të duket sikur ka ndryshuar gjithë destinacioni i poezisë shqipe, që jo rastësisht bëhet në botimet e poetit vetë nën okelion e shtëpisë botuese «Milosao».

Kritika letrare do t'i kthehet vazhdimisht Agim Matos, këtij biri të degëve të gjelbra, të rërës dhe të yjeve të një drite mesdhetare, që zbërthejnë shpirtin të parat.

Dhe nëpërmjet këtij udhëtimi të shpirtit, si mëton vetë poeti, gjejmë rrugët e udhëtimeve poetike ku erërat aristoteliane janë më të afërta se kudo tjetër në këtë botë aristoteliane, por që pranë peshkatarëve të Sarandës së poetit, përziehen me hijen heminguejane, si shpall ai vetë.

Dhe ne e mendojme vargun brenda kësaj guace të perlave sarandiot, aq pranë botës dhe lashtësive, atje, ku gjatë një pjekurije poetike, mezi dëgjoheshin radiot e huaja për thyerjen e çdo kufiri.

Është kjo një adresë pothuajse mijëravjeçare, por që për Agim Maton fillon që në vitin 1969 me librin “Jug”.

Duke lindur në një vend, ku letërsia jeton në vartësi të çka është thënë më parë dhe nga gjurmë të shkruara nëpër tekste shkollore, poezia e Agim Matos nuk eksploron si mjaft poetë të tjerë të brezit të tij, as thërret ose polemizon për identitet, si të disa të tjerë, as vërteton veten e tij, por vetëm shfaq atë që ka brënda vetes.

Do ta quaja lirizëm të thellë koral, sado që është vetëm i një njeriu.

Dhe kështu, poezitë e Agim Matos zenë vend midis rrathëve të erërave të Poseidonit.

Duke ndërre se vargjet e këtij udhëtimi krijojnë një botë poetike të përbashkët të një rrjedhe gati të brëndshme prej jambesh dhe vargu të bardhë, çdo poezi e Agim Matos i ngjan atij lëngut të verës dhe të lirisë së paformë, që derdhet në çdo poezi si brenda një strukture poetike të kristaltë, që gati të lëndon me universalitetin e vet.

Dhe ky universalitet kthehet në unison me shumë zëra, për të cilët prapë se prapë poeti është i vetëdijshëm kur

thotë, po në një fashikull tjetër të vëllimit “Lundrimet”: “Zgjatet isoja dhe mbajnë frymën shënjtore.”

Dhe ata që e dinë se çfarë vlere merr në fjalën frymë edhe ajo “n” e vogël, që tregon se poeti jo vetëm e njeh mirë dhe e afroh te vetja, por krijon po atë përfshirjen poetike, (inkorporimin) që Aristoteli e përshkruan në traktatin e tij “Shpirti” së bashku me dashurinë si proporcion. Dhe kjo është mjeshtëri e egzistencës vetë. Që të arrijë deri në këto masa të përjetësisë, një poeti si Agim Mato i duhet të kthehet “Cuf Cuf” me poezinë e tij në shtëpinë edhe në qytetin e tij, ku njësoj si në Aleksandrinë e dikurshme, ka arritur të digjet jo në lashtësi po në vitet 90 edhe biblioteka, por ku një e kaluar e tërë ftohet dhe ngrin, deri sa të shfaqen lundrime të tjera...

Dhe është bukuria e thellë e këtij lundrimi, që Agim Maton e bën poetin shqiptar, që sjell këtë korale zërash që qëndrojnë përballë këtij universi prej rëre, yjesh dhe degësh të blerta.

Por zemra ka rrahjet e një njeriu të vetëm.

E di që kjo shumësi e shprehur me kaq kontraste vetmie, të kujton çdo notë mitologjike, si valëzime të detit Jon, më unikalit edhe në vargjet e poetit.

Po të jetosh për kaq e kaq vjet pranë Orhejmit të tij dhe Butrintit të të gjithëve, do të ngjizesh brenda ujrave të lashtësisë dhe të përjetësisë, ku njeriu bëhet pjesëmarrës.

Dhe kjo lashtësi dhe përjetësi, për poetin triumfin e ka të pazëshëm dhe të përgjakur, njësoj si në atë thertoren pothuaj brenda një qyteti, atje ku edhe fëmijët “capiteshin nëpërmjet këtyre tragjedive, në luftën e Trojës.”

Të kesh përballë Korfuzin dhe në zemër të jetës së një njeriu Butrintin, gjithnjë do të kesh pranë Platonin, Aristotelin, Euklidin dhe të gjithë botën e paskajshme.

“Cili Euklid u jep mësim,

Këtyre zogjve të posalindur”, thotë poeti. Gjithçka është e mundshme në vargun e Agim Matos. Edhe kur ai thotë te poezia “Njeriu”:

“Këtu jam duke u çapitur,
Në këtë zbrazëti galaktikash,
I dënuar që nga zanafilla,
Me një unazë në syrin e këmbës,
Duke hequr zvarrë
zinxhirin,
Me sferën e rëndë të diellit.”

Dhe nuk ka se si zinxhiri të mos jetonte i vetëm në një varg, ku loja e fjalëve hap hapësirat shpesh herë onomatopeike.

Edhe kur mbetet fare vetëm, siç ndodh në poezinë “Teuta”, në skajin tjetër të Majës së Hekurave, si brenda mitit, larg janë ardianët që ndiqnin “gjarpërimet e ndritshme të vetëtimave”:

Që vizatonin në qiell përkrenaren e mbretëreshës Teutë,

....
Po kukurja e saj,
Një ditë do t'i soste
Gjënimet dhe vetëtimat.”

Sepse edhe një mbretëreshë si vetë poeti është thjesht një njeri..

Në poezinë “Varrezat e anijeve të mbytyra”, poeti thotë:

“Guiskardi, Bohemundi, bredhin me flotat e tyre në këto gjire. Dikush i humb të gjitha anijet nga shtrëngatat. Një tjetër i fundos vetë ushtarët të mos mendojnë për kthimin”



Po në çfarë kohe gjendemi, pyes, mes përmes kësaj turbullire poetike.

Dhe kjo përplasje periudhash, që sjellin njëra tjetrën duket sikur tretet lehtë brenda natyrës pa skaje, që pjell përmbajtjen shoqërore të saj.

Rrallë ka në poezinë shqipe një pasuri të tillë që vjen që prej larg, ku historia dhe përvoja njerëzore përziehen me ujërat e detit dhe erërat, ku çelin lule, një poezi që ndjek ato ushtrime të automatizuara të frymëmarrjes që krijon jetën. Dhe që herë të afion me Seremben si me një mik të madh të poetit dhe herë me një mik tjetër të madh si Fatos Arapi..

Dhe poezia e Agim Matos tregon hyrjen e njeriut si shpirt i vetmuar në një galaktikë të përbashkët, me përgjegjësinë e tij për të krijuar botën një.

“Dhe të gjithë lundrimet e mëdha vazhdojnë të fillojnë nga shpirti.”, thotë përsëri poeti.

Por në poezinë e Agim Matos asnjëherë jeta nuk shfaqet në gjysmë ëndërr.

Udhëtimi është real, po aq real sa te “Fundo” në ditën kur priteshin në qytetin e tij palmat, që të kujtojnë të gjithë llojet e kercënimeve të vazhdueshme që ka jeta.. Qoftë te ‘Lundrimet’ me një Katamara, herë në një pijetore zhurmëmëdhenjsh dhe pijetarësh të mejhanes “Poseidon”, “ku një dorë tund letrën e një Bashkie që sjell lajmin se lokali do të shëmbet.”

Jo rrallë shfaqet Poseidoni në poezinë e Agim Matos. Por në poezinë me emri “Poseidon” poeti thotë se të duket sikur “lundron në barkun e një përbinëshi, me një gotë raki, një sparo dhe një sardele.”

Dhe poezia thyhet më dysh. Fillon me rrjedhën e përhershme të qashtë që ka forcë të krijojë një lumë ndjesish për krijimin e koshienës për ekzistencë, por që si rrallë pas vargjeve të lira kapërcen në vargjet e matura, ku qielli dhe dielli, Afërdita dhe drita, fillojnë të matin njeri tjetrin, pasi hapur dhe mprehtë, në mes të rruzullit, duket se për herë të parë është futur “diftongu” “Konflikt social”.

Thjeshtësi dhe mundim, peshq të sapokapur përjetimesh të një njeriu ku është shfaqur e ka mbetur prapa gjithë socialrealizmi.

Dhe gjithë kjo hapësirë lidhet me qytetin që përjeton godinat e mëdha që fillojnë të zenë qiellin e asaj përjetësie vetjake.

Por në poezinë e poetit të gjithë këto adresime bëhen të ngjashme me algat e detit të botës ku jeton, sikur të jenë vënë në fundin e një anijeje të fundosur nga kohërat që do të vijnë.

Sepse bota përsëri fillon të shfaqet në formën e ripërtëritjes të vargut dhe të fjalës dhe të thjeshtësisë natyrale.

Dhe në poezinë ‘Zhytem’, Agim Mato thotë:

“Jam brenda pajimeve
Që më japin lirinë e një peshku”

Dhe ky përjetim i drejtpërdrejtë bën reale edhe metaforën më të madhe. Sepse peshku dhe njeriu bëhen një.

Duke lexuar këto vargje, me Poseidonin e ujrave të tij, nuk ka si të mos të të vijnë ndërmend, kush është numri Një ose e Tëra si Gjithësi, në traktatin e Aristototelit, e numuri Dy, si njohuri, që mund ta quajmë edhe zbulimi. Dhe numuri Tre, që përfaqëson inkorporimin, ose përfshirjen. Dhe Katra që përmban opinion dhe solidaritet.

Mund të flitet shumë, për sensacionin dhe imagjinatën, madje intelektin dhe tema të tjera si këto si përmbajtje të njeriut, të përziera me arsyt, që në fillimet e ndërgjegjësimit të kulturës njerëzore, të gjitha këto të përzjera si me zhurmat dhe lëvizjet e detit dhe të fjalës poetike në tash e mijra vjet.

Agim Mato vjen të shprehë një jetë.

Shfaqet në vargjet e tij dashuria për femrën e zemrës shpesh herë e fshehur pas gardhit të trëndafilëve të bardhë, ku duhet të vijë në ndihmë një lulekëmborë.

Dhe vetë motivi i dashurisë “inkorporohet” në këtë korale të madhe të lidhjes së natyrës edhe një lidhje te vetmuar trupore.

Po, bëhet dashuri në vargjet e Agim Matos, poetit, që si thotë vetë, nuk i trembet erërave të Poseidonit, si bënin anijet që fshiheshin dikur në Akrokeraume. Por ka edhe emra të tjerë të radhitur të botës, që gjithsesi japin një emër të kësaj përvoja të madhe. Edhe fort Shqiptar.

NJË LIBËR I RI NGA BOTIMET "POLIS"

Richard Osman

Ende në lojë

Në një zonë të thellë që shtrihet në kodrinat e harlisura të Kentit në Angli, ndodhet fshati i pensionistëve, Kjudpërs Çejsi. Një herë në javë, katër miq në këtë fshat, Elizabeta, Xhojsi, Ibrahim i dhe Roni - Klubi i të Enjteve për Vrasjet - takohen për të hetuar vrasje të vjetra, ende të pazbardhura. Secili prej tyre jep ndihmesë me diçka, por që të gjithë i bashkon vendosmëria për t'i shkuar deri në fund një krimi të dhunshëm, që dikur e ka kapur në befasi policinë dhe i ka dhënë mundësinë dikujt t'ia hidhte pa u lagur.

Kur Toni Karëni, një ndërtues vendas, me një të shkuar të dyshimtë, gjendet i goditur për vdekje me një çomange, detektivët e moshuar e shohin veten të mbërthyer në çështjen e tyre të parë, me “një kufomë të vërtetë dhe një vrasës të vërtetë diku aty jashtë”. Hetimet e tyre nxjerrin në pah një numër të dyshuarish, që përfshijnë një ndërtues polak rival, një prift të dështuar, djalin e Ronit, boksier, si dhe ish partnerin e biznesit të Karënit, zhvilluesin e dyshimtë dhe dredharak të pronave, Jan Ventamin. Por më pas edhe Ventami shembet i vdekur përpara një turme të madhe banorësh të Kjudpërs Çejsit.

Pasi e konfirmon se bëhet fjalë për një akt kriminal, “banda e vogël” e gjen veten duke gjurmuar dy vrasës, por edhe duke vrarë mendjen nëse dikush mund të fshihet brenda komunitetit të tyre.

Ky është njëri nga romanet më të lexuar të vitit të kaluar në Britaninë e Madhe, por dhe i përkthyer brenda një kohe të shkurtër në disa gjuhë të botës.

Sepse librat e shkruar bukur, me zgjuarsia e finesë, që të mbërthejnë menjëherë me artin dhe mjeshtërinë e tyre, e gjejnë shumë shpejt rrugën për te lexuesit.

Një libër i shkruar në mënyrë inteligjente, ku shumëkuptimësia dhe humori i hollë rrjedhin si një nënshtresë magjepsëse. Stili është skalitur aq bukur, sa të duket sikur dëgjon një tingëllimë tipike vetironie të mjediseve londineze.

Dialogë dhe përsiatje që thuren në mënyrë mjeshtërore: një lloj shkolle për mënyrën sesi mund të shkruhet një libër inteligjent, me ngarkesë kuptimore, me mendime të thukëta e mjeshtri shprehjeje.

Meritë të veçantë ka edhe përkthyesja Margarita Skënderaj, e cila e ka shqipëruar mjeshtërisht këtë libër, duke sjellë natyrshmërinë, po edhe thellësinë e humorit tipik anglez.

Richard Osman
Ende në lojë
Roman
Përktheu: Margarita Skënderaj
ISBN 978-9928-4629-9-2
Çmimi: 1200 lekë
Faqe: 450


RICHARD THOMAS OSMAN-i ka lindur në vitin 1970. Ai është shkrimtar, producent, komedian dhe prezantues spektakli në televizionin britanik. Po ashtu, është adhurues i romanit policor fiction. Romani i tij ndërthur disa nga mjetet unike që i bëjnë ngjarjet të mbulohen nga një vel inteligjence djallëzore dhe të jenë njëkohësisht tejet gazmore.



Romani “Bolero në vilën e pleqve”, Botimet Toena

Tiparet postmoderniste në veprën e Kongolit

Nga Emine Boriçi



“Bolero në vilën e pleqve” është ndër romanet, i cili e drejtoi letërsinë shqipe drejt rrymës së postmodernizmit. Fillimisht mund të themi që postmodernizmi i vë theksin individit ku gjendja vetjake e tyre dhe zgjedhjet janë kuitesenca e njohjes njerëzore. Çdo individ është një realitet më vete e njerëzimi përbëhet nga larushësi realitetesh, sepse kjo panoramë gjendet brenda individit ku çdo gjë është subjektive dhe çdo njeri është “një e vërtetë, një realitet”. Në roman shohim pikërisht këtë ku secili jeton në botën e vet mendore-shpirtërore. Shpesh rrëfimi krijon brenda rrëfimit dyjëzimin e karakterit të personazhit, ku e vërteta është “niveli mendor zero” i personazhit protagonist dhe realiteti i “gënjeshtërt” është rroga mujore e mirë. Sikurse edhe në këtë rast kemi kapërcim pikëpamjesh të cilat i zënë vendin njëra-tjetrës, me qëllimin e fshehtë të së vërtetës, ku Parashqevia mundohet të mbulojë çdo aspekt nga jeta e saj personale. Një nga tiparet më të qenësishme të posmodernizmit që ndihmojnë në vizualitet është rrëfimi në vetën e parë. Rrëfimtari është një femër, Parashqevia, që gjithçka e tregon nga fushëpamja e subjektivizuar përballë një të vërtete reale ajo e tregon ashtu siç e sheh në raport me shtëpinë, vilën në të cilën shërbente.

Elementi më i spikatur është erotizmi. Shumë fleta të këtij romani mbushen me fjalën ertizëm dhe me përshkrime të hollësishme të veprimeve erotike deri në “banalitet”. Parashqevia shpesh përballet me veten, me mendimet dhe me gjendjen e saj të brendshme, dominancë e së cilës është fjala lakuriqësi që i mvishet veprimeve të pakontrolluara, e shtyrë nga një asosacion subkoshientar. Sikurse postmodernistët fjalët, batutat dhe shprehje të ndryshme zënë një vend shumë të madh në vepër, bëjnë që të devijojnë nga tradita e nga rrymat letrare të mëparshme, duke sfiduar tabutë e duke i bërë më të prekshme gjëndrat e eroticitetit ku mund të përmendim diskutimin e plakut me doktorin.

Një tjetër element është koha dhe hapësira të cilat nuk janë të mirëpërcaktuara në thelb. Në përgjithësi, ngjarjet

zhvillohen në kohën e shkuar: në të kryerën e thjeshtë, të pakryerën dhe të ardhmen e së shkuarës, disa herë në të tashmen, por brenda kohës së shkuar që zhvillohet ngjarja. Ky përcaktim nuk është i plotë nëse nuk i shtojmë edhe kohën abstrakte, ose e quajtur ndryshe eterne. Nuk kemi thjesht përzierjeje, por koha i kalon limitet e natyrshmërisë së zhvillimit kronologjik të matshëm në: kohë mendore apo kohë e brendshme të cilën sinonimisht paralelizohen me kohën e shkuar. Brenda Parashqevisë, në mendjen e saj është një personazh i dytë, ku koha dhe hapësira nuk kanë përcaktim, edhe veprimi është mendor, citoj: “thënie e mia deri tani kanë lënë të kuptohen dhe të nënkuptohen disa gjëra, por jo kryesoren: ishte fshehur gjithë jetën. Kjo ekzistencë e fshehur më ishte nevrikosur nuk duroja më”. I gjithë ky artikulum ndjenjash në këndvështrimin tonë çastor paraqitet lehtësisht i përballueshëm, por nëse vrotujmë imtësisht veprimet e mendimet e personazhit kuptojmë në mënyrë direkte mungesat e mëdha e dëshira të paplotësuar që vijnë në formën e një skene befasuese për lexuesin tradicional e krejt papritur rrjedha e ngjarjes ndryshon nga ndërputja e një tjetër historie duke bërë të pranishëm një tipar tjetër të postmodernizmit, digresionin. E thënë ndryshe retrospektiva është elementi i cili thyen rregullat tradicionale të rrjedhës logjike të romanit. Aty ku Parashqevia tregon për eksperiencën e saj në makinë me Dirinën, tregon për familjen e sidomos për motrën e saj. Një sekuençë tjetër kohore e kemi kur Dirina i kërkon masazh e ajo i bindet, kujton paralelisht masazhin që i bënte plakut. Pra, kemi një ngjarje që ndodh dhe një frekuencë retrospektive për të njëjtën situatë, masazhin që për Parashqevinë nuk është thjesht punë, por është ndjenja e ndrydhur dashurore që nuk e ka patur kurrë, përdhunime po, por i ka munguar një jetë familjare.

Pjesa e dytë e romanit tregon për jetën e dhembshur që ka pasur Parashqevia duke përdorur një nga format e rrëfimit: digresionin i cili tregon mbi përdhunimet që ka

përjetuar e kalon pastaj prapë në të tashmen e së shkuarës: jetën e saj në vilë. Pas drekimit të z. Ifran me z. Firdeus shkon pas e vazhdon historinë e dhimbshme pas përdhunimit si ajo ishte katandisur dhe si vajti në vazhdimësi jeta e saj vite më parë. E gjithë kjo lojë kohore stilon shkathësinë e penës artistike e digresionuese kohore tipike si tipar postmodern.

Figura kryesore është satira deri në sarkazëm ndaj idealiteti i traditës dhe ndërgjegjshmëria merr trajtën e një personazhi: Parashqevia e brendshme. Kjo jepet përmes përballjes së gjyqtarës Afërdita me mospëlqimin që ajo ushqen ndaj Parashqevisë. Ajo nuk është thjesht një personazh kryesor i romanit, ajo është edhe personazh i së vërtetës së errët ndërgjegjësor të individit. Antipatia e kësaj gjyqtare ndaj saj në një farë mënyrë konvencionalisht një lloj frike ndaj përballjes së errët të individit.

Shpesh rrëfimi e humb rrjedhën logjike siç e kemi thënë edhe më sipër përmes digresionit e përmes këtij përfitohet edhe metateksti, duke rrëfyer jetën e saj në vilë ajo ndërfit tregimin mbi jetën e saj të mëparshme. Emrat e personazheve janë të plota në përgjithësi. Por, në veçanti z. Ifran shpesh epitetohe si plaku ose në një rast tjetër si adoleshent i përjetshëm. Në këtë mënyrë rrëfimtari thekson pikërisht ironinë dhe papërshtatshmërinë e moshës së tij (plak) dhe veprimeve të tij (adoleshent i përjetshëm).

Një nga pikat më nevrallgjike të romanit është komunikimi, ku bashkëjeton fantazia dhe realja (fiksioni) subkoshienca dhe koshienca, mëkati me ndërgjegjen, të cilat marrin fytyra nga veshja tipësore e personazheve. Nga shkrirja e reales me fantazinë përfitohet edhe loja e ligjëratave, sidomos aty ku aktivizohet imagjinata. Konkretisht, situata kur Parashqevia sillet si postiere, e cila transmeton shkëmbim komunikimi mes plakut dhe z. Firdeus.

Parantezisht mund të themi se komunikimi mes personazheve nuk zhvillohet përmes imagjinatës, ose thjesht përmes veprimeve, por rrëfimtari shfrytëzon larmicitet llojesh të komunikimit: me letra këtu përmendim bisedat e z. Ifran me znj. Frideus, me piktura, me piano kur luante plaku pasi zihej me zonjën Frideus. Një nga llojet më të veçanta është komunikimi me lexuesin. Ai në këtë rast bëhet personazh bashkëbisedues me rrëfimtarin dhe personazhin. Kjo mënyrë e fton lexuesin ta njohë më nga afër protagonistin dhe të jetë më pranë gjendjes psikologjike. Ajo që piketohet më shumë në këtë roman është pasqyra e marrëdhënia që ka Parashqevia me të.

Janë tre pasqyra ku shihet Parashqevia dhe debaton me vetveten:

E para është në banjë

Tjetra në dhomën e gjumit

Dhe pasqyra më e madhe shpesh Parashqevia debaton me vetveten është ajo e salloni.

Të tria pasqyrat simbolizojnë tri shtresa të nënndërgjegjes së Parashqevisë. Ajo që vizualisht është në banjë e që Parashqevia nuk dialogon fare me vetveten, e dhomës së gjumit që simbolizon një shtresë të nënndërgjegjes midis errësirës së thellë dhe shtresës së ripërtërirë dhe ajo e korridorit pasqyra më e madhe e cila e paraqet personazhin si një sekret të kyçur ndaj të vërtetave që ajo mbart. Prandaj, romani postmodern është një risi ku nëpërmjet veprimeve e mendimeve të personazheve sjell një tjetër botëkuptim, ndryshe nga ai klasik që jemi mësuar duke kaluar çdo pengesë lehtësisht e duke konkorduar çdo mentalitet prapanik e gjykues mbi ngjarje të rëndomta, kjo rrymë mbetet e zhveshur nga çdo “normë” letrare duke i ftuar lexuesit të informohen për natyrën e brishtë të femrës e cila nga mospërkrahja arrin deri në degradim moral.



Romani “800 hapa larg Venerës” të Virion Graçit

Jeta dhe pavdekësia, kjo vdekje e pafundme!

Nga Ballsor Hoxha



I Hyrje

Romani “800 hapa larg Venerës” fillon me një vdekje. Vdes personazhi kryesor. Pikërisht 800 hapa larg shtëpisë së tij. Ai vdes, dhe lë përgjithmonë këtë jetë. Por autori Graçi “nuk është aq mizor” ndaj personazhit të tij kryesor, ai ia “dhuron” atij edhe një mundësi, mundësinë e jetës pas. Jetës prapa vdekjes, jetës si shpirt. Por a është kjo “dhuratë” apo vetëm edhe një ndëshkim i tij, vazhdim i të qenit i përjashtuar?

Kristofori personazhi kryesor, të cilit ia ka lënë emrin babai i tij, sipas Kristofor Kolombos, në të vërtetë kurrë nuk ka udhëtuar askund përpos nëpër përjashtimet, refuzimet dhe shkeljet e nënçmimet që i janë bërë gjatë jetës. Ai ka pasur një jetë zyrtari administratash, dhe kaq.

Ajo që pason është një fragmentarizim i copërave të të kaluarës së tij, asaj aktuale dhe të harruar nga vështirësitë e jetës, përbrenda linjës së rrëfimit të jetës së tij si shpirt. Varur në një shtyllë telefoni, dhe fshehur prapa një kaçube, diku në periferinë në askund, të qytetit ku ka jetuar.

Kristofori është një personazh monumental, që përkujton personazhin Herzog të Saul Bellow në tërë nënshtrimin e tij krizës së mes-moshës i cili i ikë çdo detyrimi të tij. Dhe derisa Herzogu kalon jetën duke shkruar letra, personazhi i Graçit – Kristofori, kalon jetën e tij duke kujtuar të kaluarën e tij, por, me një ndryshim, ky i fundit ka tërë përjetësinë përpara dhe tërë shpërkujtimin nga bota. Gjë që krijon simbolikën ideale të ikjes nga përgjegjësia si njeri i cili ka kaluar në botën tjetër.

Të kaluarit në shpirt, në jetën e të përhershmes do të mund të ishte mrekulli, por jeta e Kristoforit është e kufizuar rreth një shtylle në rrugë, në ikje dhe fshehje nga qentë, dhe strehim në një kaçube. Ai në të vërtetë me “pavdekësinë” e tij është i dënuar përjetësisht për vazhdimin e nënshtrimit të tij, që e kishte gjatë tërë jetës. Apo thënë më saktë të të qenit i përjashtuar gjatë tërë jetës së tij.

Dhe ky dënim është në nemitjen e tij në koordinim me të qenit i mbetur përjetësisht në vëzhgim të jetës, gjë që ia kujton çdo moment, çdo mungesë, çdo pendesë, dhe çdo mundësi që ka pasur jeta e tij. Në të vërtetë, kjo është shtresë e dyfishtë e papërgjegjësisë së tij ndaj jetës, ndaj të qenit i dyti në çdo gjë (gjë që e bartë tek fëmijët e tij me çdo kusht, qoftë edhe duke i mësuar të mos marrin pjesë në gaz e në shaka), në jetën e vërtetë, dhe në “pavdekësinë” e tij.

Kristofori është shënjim i kompleksit të jetës e cila nuk arrin të shprehet asnjëherë, as në këtë jetë as në të përjetshmen. Në të vërtetë e tërë “linja e identitetit të tij” është një drejtvizore e cila nuk arrin të ngritët asnjëherë nga pesha e gravitetit të mospjesëmarrjes.

Pikërisht kjo drejtvizore është gjurma e shtypjes së njeriut nga Publikja/Bota

“zëri nuk po i dilte, u kruspullo, bëri një gjysmë rrotullimi rreth vetes, në atë lëvizje pa edhe një herë afshen e kinemasë verore, fotot për shfaqjen e filmit të radhës me divën amerikane më të paguar të viteve të fundit, rreth 28 milion dollarë për një ulje brekësh:.. u kruspullo nga dhimbjet, ra pa frymë...”

Dhe kjo shtypje shfaqet në gjurmët e këtij paragrafi. Më tutje, është po e njëjta shtypje që ka shkaktuar dhe krijon edhe çarjen e njeriut. Kjo çarje duke u metaforizuar në jetën para dhe pas vdekjes. E cila në secilin rast, në secilin moment, dhe në secilin fragment është drejtvizore e pa jetë.

Njeriu, vdes për çdo ditë, dhe kurrë nuk e arrin vdekjen (Blanchot). Është pikërisht kjo shënjimi më i saktë brenda kësaj metafore. Aq më shumë që teksti luan me këtë ambiguitet me vdekjen, si muri dhe si ajo që Blanchot e quan – the incessant and interminable (shih më poshtë tekstin), si pafundësi vdekjeje.

II Imagjinaria që përmban marrëdhënien tonë me vdekjen

“Me gjithë nxitimin e tij prej këmbësori, nuk ia doli dot me sukses të mbërrinte gjallë në shtëpi. Hoqi dorë nga përpjekjet për ta sfiduar fatin e zi. Vendi ku mund të kishte njëfarë probabiliteti për të kapërcyer çastin fatal ishte larg, mjaft larg, rreth 800 hapa. U detyrua të dorëzohej me gjakftohtësi, pa u bërë qesharak, pa i hyrë luftës për ta përmbysur rezultatin e paracaktuar të një ndeshjeje. Shenjat, nga toka, deri te qielli, ishin kundër tij, asnjë mundësi reale për të fituar... jo keq, jo keq... u kruspullo nga dhimbjet, ra pa frymë i shtendosur, trupi në pluhur u shtri lirshëm, koka e goditur mbështetur për pllakat e betonit të trotuarit... mesditë e bukur, kaltërsi dhe diell rreth e qark tij, mjegull dhe terr për të, errësirë dhe kaos në sytë dhe përfytyrimin e tij...”

Duke i ndarë tri lloje të gjurmëve nga ky paragraf mbi përshkrimin dhe vëzhgimin e jetës, si shënjim, në rendin e parë shfaqen shënjime të vdekjes si

“fati i zi”, “probabiliteti”, “çasti fatal”, “u detyrua”, “rezultatit e paracaktuar” janë gjurmë brenda paragrafit të përshkrimit të momentit të vdekjes së personazhit kryesor të romanit Kristoforit, të cilat krijojnë kufirin, atë murin e pakthyeshmërisë së vdekjes. Janë gjurmë, po ashtu, të imagjinare sonë mbi vdekjen, janë gjurmë të cilat shpërfaqin vdekjen si e “paracaktuar” dhe e “pa luftueshme”. Gjurmë të cilat krijojnë kufirin e fundmë të jetës.

Pastaj në rendin e dytë janë gjurmët e radhës:

“të dorëzohej me gjakftohtësi”, “pa u bërë qesharak” “jo keq, jo keq”

Gjurmë të cilat krijojnë marrëdhënien e njeriut me vdekjen,

me këtë kufi, me këtë përfundim. “gjakftohtësia”, “qesharakja” që rri si mundësi e tradhtisë së burrërisë dhe në momentin e vdekjes, dhe në fund përfundimi “jo keq, jo keq” sikur e japin të qartë dhe të kapshëm këtë “fatalitet”, këtë “Fat të zi”. Janë sikur njeriu e kapë në fund edhe vdekjen e tij, edhe këtë muri, në të cilin ai ndeshet.

Dhe në rendin e tretë gjurmët e fundit nga ky moment i vdekjes:

“Shenjat, nga toka deri te qielli, ishin kundër tij” “mesditë e bukur, kaltërsi dhe diell rreth e qark tij”, “errësirë dhe kaos në përfytyrimin e tij”.

Këto gjurmë e shfaqin vdekjen si shënjim i kuptimit të vdekjes, dhe e një lidhjeje të vdekjes me çfarëdo përreth, apo me rrethanën, jo si fakt që ndërhyjnë në vdekjen, por si marrëdhënie të njeriut me vdekjen. Vdekja e shënjuar nga “Kaltërsia” dhe “kaosi”, dhe “shenjat nga toka deri tek qielli” si shënjim i cili bartë – sikur – të diturën dhe – përvojën – e njeriut me vdekjen.

Si është vdekja? Si është ajo që kurrë nuk kemi një dëshmi prej matanë? Si është të vdesësh? Ky është muri në të cilin njerëzimi u ndesh që prej zanafilës së mendimit të tij, vetëdijes së tij, qeniesimit të tij. Është muri i cili në të vërtetë lind dhe buron tërë kuptimin e jetës, apo thënë ndryshe: nxitë tërë kuptimin (e paqëndrueshëm) mbi jetën.

Kur flasim për vdekjen, Maurice Blanchot, është filozofi i cili krijoi një mendim tërësisht të ri dhe mbizotërues në filozofinë bashkëkohore. Në të vërtetë ai nisat dhe vë në diskutim dy mendimet më të njohura filozofike mbi vdekjen: atë të Hegelit, se vdekja është muri përballë të cilit lind i tërë kuptimi. Dhe atë të Heidegger që është i ngjashëm me të Hegelit, si mundësi e pamundësisë së vdekjes, në të vërtetë vdekja si muri përballë të cilit arrihet potenciali njerëzor.

Mirëpo vetë Blanchot krijon një kategori tjetër, në të cilën, vdekja, është e pa pronsueshme, e pandjeshme dhe e paarritshme, gjë që do të thotë se e lë njeriun në primordidalen, lindjen e tij pa qëllim dhe vdekjen e tij pa qëllim, gjë që më tutje, krijon atë që Blanchot e quan: e pandërprera dhe e pafundmja (the incessant and interminable). Vetë pamundësia e mundësisë (duke iu kundërvënë mendimit të Heidegger që qeniesimin e shih si mundësi e pamundësisë!).

Në këtë, duke vazhduar parafrazimin e Blanchot, imagjinaria jonë, përmban në vete këtë ambiguitet të njeriut ndaj vdekjes: si mundësi e pamundësisë, dhe si pamundësi e mundësisë.

Në vëzhgimin e imagjinare mbi vdekjen në tekstin e romanit “800 hapa larg Venerës” dalin disa karakteristika të saj:


a. kalimi në shpirt, pa të drejta njerëzore

b. është në pendesë të përhershme për mungesat në jetë

c. është vazhdimësi i përndjekur nga mendimi se vëzhgohet nga shpirta të tjerë, dhe aq më shumë që është duke u gjykuar nga të tjerë. Etj...

të gjitha këto, në të vërtetë janë gjurmë të njerëzores, ndërthurur me sarkazëm në periferi me shënjimin religjioz, të jetës të asaj bote. Në të vërtetë japin vdekjen, imagjinaren e tekstit, si njerëzore, e cila nuk arrin të shpërkujtim nga bota.

Por në kategorinë shënjimit filozofik, “Vdekja” e këtij teksti të romanit është vetë ajo që njihet si Publikja, pra bota përkundër primordiales dhe të përhershmes së tokës, si Publike.



Në të vërtetë këtu lind dhe ideja e romanit, si trajtim i njerëzores, duke krijuar imagjinaren e vdekjes, dhe jetës së përtejme, apo edhe “pavdekësisë”, e cila asnjëherë nuk arrin tutje prej asaj që Publikja, bota, jeta e përditshme, e bën të pa-vërejtshme, vetë vdekjen. Pra brenda idesë së tekstit “800 hapa larg Venerës” përmbahet aporia e Publikes e cila mbizotëron si në jetën reale po ashtu edhe në botën e përtejme, atë si shpirt.

Kjo apori krijohet dhe ndërtohet gjatë tërë romanit në sarkazmin e saj në të dy anët e “kufirit” të vdekjes. Në të vërtetë njeriu, qoftë edhe Kristofori, nuk arrin që në personalen e tij, si shpirt dhe si njeri, të krijoj një raport me vdekjen e tij.

Në të vërtetë, vetë Kristofori, si shpirt, nuk e njeh vdekjen, dhe në këtë, në idenë e tekstit, personazhi i vdekur jeton. Apo thënë ndryshe, vetëm kjo mosnjohje, ky mospranim i vdekjes, është mundësia e “pavdekësisë” së tij, mundësia e jetës si shpirt, mundësia e jetës prapa murit të vdekjes.

Dhe, aq më shumë, tërë karakteristikat e raportit të tij me botën matanë, në të vërtetë karakteristikat e botës matanë, janë karakteristikat e botës në këtë anë – Publikja e cila është krijuar, krijohet dhe jetësohet vetëm si mohim dhe aq më shumë pa – vërejtshmëri e vdekjes.

Kjo pa – vërejtshmëri e vdekjes, në tërë sarkazmin mjeshtëror të tekstit, dhe aq më shumë në tërë paradoksin e saj, është edhe më e theksuar pikërisht në jetën e vdekur të personazhit kryesor Kristofori. Ai do të flasë me shtyllën në afërsi të tij, ai do të mësoj dashurinë e pishave, do të martohet me një pishë, ai ndiqet nga qentë, ai është i kastruar në pandjeshmëri ndaj gjinive, e më tutje është i pazgjdhje.

Pikërisht këto së bashku duke krijuar shënjimin e Publikes së njerëzores, e cila e shtynë njeriun pikërisht në këtë gjendje qeniesimi.

Andaj imagjinaria mbi vdekjen në këtë tekst, del si imagjinare ironizuese, sarkastike, dhe paradoksale e marrëdhënies së njeriut me vdekjen, vdekja si fenomen ndaj të cilit krijohet i tërë mendimi dhe kuptimi njerëzor (Hegel). Dhe jeta nga këtu, del si DËSHIRË, dhe DETYRË (theksuar sikur në tekstin në fjalë) e njeriut. Në këtë botë, dhe si shpirt.

III

Megjithatë në këtë sarkazëm, ironi dhe paradoks mbi pavdekësinë (lexo: vdekjen) shpërfaqet marrëdhënia e tekstit me vdekjen dhe shënjimi i vdekjes. Ajo në të shumtën e tekstit del si ajo që u tha më lartë si “mundësi e pamundësisë” sipas Heidegger, qeniesimi si potencial. Në këtë gjurma e pendesës është në raport direkt me këtë.

Mirëpo, në gjurmët e tekstit, në tërësi, jeta e Kristoforit është një vdekje e përhershme, një vdekje e pa pronësuar, një vdekje e – pandërprerë dhe e pafund – e cila asnjëherë nuk arrin të mishërohet, qoftë në përfundim e as në potencial, arrijte të potencialit.

“Edhe nën tokë, as zgjuar as i fjetur plotësisht Kristofori. Iu bind plotësisht disiplinës që diktonte kutia e mbyllur e errët në të cilin ndodhej. Tha: Do të jem më mirë këtu. Do të jem më mirë këtu... Dhe pati të drejtë. Trupi i Kristoforit, i varrosur buzë rrugës automobilistike, në parcelën e re... gjeti shprehje, u përshat dhe u nënshtrua pa kushte. Ndërsa shpirti i tij, duke u gërvishur nëpër gozhdët e mëdha dhe kokrrizat e dheut, doli si avull prej thellësisë. Shpirti i Kristoforit nuk u nënshtrua... zgjodhi rrugën e vështirë e të rrezikshme të arratisë, të ndarjes nga i zoti...”

Këtu Kristofori shfaq pikërisht – objektin – e vdekjes së imagjinare së tekstit, si ambiguitet, si vdekje dhe si pavdekësi/potencial përballë dhe në ndeshje me vdekjen. Ky ambiguitet është problemi i njeriut me vdekjen, kurrë të pa njohur, kurrë të pa përjetuar, kurrë të pa perceptuar. Dhe me këtë i rikthehet shënjimit religjioz të ndarjes trup - shpirt, duke thelluar po të njëjtin shënjim të ambiguitetit të marrëdhënies së njeriut me vdekjen.

- Objekti – i vdekjes në këtë tekst të imagjinare e fshinë jetën, e kalon atë në vdekje dhe e shuan në nemitin e përjetësisë. Kështu duke krijuar ambiguitetin e marrëdhënies së njeriut me vdekjen në imagjinaren, duke e shënjuar jetën si një vdekje, të përhershme. Jetën si të vdekur, dhe vdekjen si jetë, jetë të vdekur, apo thënë më saktë jetë të kastruar.

Në të vërtetë këtu – objekti – i vdekjes kalon në mungesën në prezencë të jetës, derisa ajo është, Kristofori është i vdekur. Shënjimi i jetës duke kaluar në shënjime të radhës të cilat nuk arrijnë të kapen dhe as të kuptimësohen në tërësi, gjithnjë duke ikur në shënjim të mëturjeshëm.

Në të vërtetë tërë jeta para vdekjes, që nga puna, bashkëshortja, fëmijët, shokët etj, është një Publike e cila e mohon vdekjen. Dhe pikërisht kjo krijon lojën me vdekjen me ambiguitetin e saj dhe me ankthin ndaj saj.

Loja me ambiguitetin e vdekjes në të vërtetë është ekzakt ankthi ndaj vdekjes, që është në çdo skutë të kësaj jete dhe në moment dhe përjetim të kësaj jete në këtë tekst.

Mirëpo, teksti në mjeshtërinë monumentale të letërsisë bashkëkohore shqiptare e rikthen këtë ankth përballë njeriut, dhe aq më shumë e krijon vërtetësinë e vdekjes në përjetimin e jetës.

Në fund, 800 hapat larg Venerës, kalojnë në 800 hapat larg ferrit. Por cili është ferri? Kjo është pyetja, dhe përgjigja ndoshta duhet kërkuar në ankthin tonë ndaj vdekjes e cila është murosor nëpër muret e pa-vërejtshmërisë së saj në çdo përjetim tonin.

(Ese mbi dy shpirta të letërsisë dhe kulturës)

Një letër e panjohur e shkrimtares Musine Kokalari

Nga Uran Butka

Qysh në vitin 1992, si një brengë pamundësie të mëparshme, hulumtova nëpër arkiva veprat e shkrimit e Musine Kokalari, gazetën e saj “Zëri i Lirisë”, dokumentet arkivore mbi fatin e saj tragjik dhe shkrova esenë “Mesazi i Musine Kokalari” si edhe një skenar filmi dokumentar për Të. Meqenëse këto sprova ishin të paplota dhe joshteruese, jam marrë në vazhdimësi, çdo herë duke gjetur diçka të re në jetën dhe veprën e saj, ende te pazbuluar tërësisht.

Në Arkivin e Shtetit zbulova këto ditë një letër të panjohur të Musine Kokalari drejtuar mikut dhe dijetarit Sotir Kolea. Në arkiv ruhen gjithashtu disa letra të shkrimtares Musine Kokalari me personalitetet kulturore të botës shqiptare e të huaj, që hedhin dritë mbi personalitetin e saj intelektual të jashtëzakonshëm për atë kohë, procesin e saj krijues, vetëdijën e shkrimit dhe veprimtarinë e saj jetësore, kulturore e politike. Më i spikatur është letërkëmbimi me Midhat Frashërin, Aleksandër Xhuvanin, Sotir Kolenë, Ernest Koliqin, Eqrem Çabej, Xhuzep Skiro, Angelo Leoti etj, letërkëmbim tashmë i botuar.

Sotir Kolea ishte studiues, leksikograf, autor i një fjalori disagjuhësh me bazë shqipen, autor i “Një tufë proverbash”, publicist dhe botues i gazetës “L’Albanie” në vitin 1914 në Zvicër, si edhe veprimtar i spikatur i çështjes sonë kombëtare, drejtor i Bibliotekës Kombëtare gjatë viteve 1928-1937. Pas kësaj kohe, ai u vendos në Elbasan, qendër e arsimit dhe e studimeve shqiptare. Pikërisht atje ia dërgonte letrat Musineja dhe i kërkonte gjykin kritik për veprat e saj të para, meqenëse mungonte një kritikë e vërtetë, siç shkruante ajo: “Në Shqipëri nuk gjen kënaqësi ose nxitje, se nuk ka një kritikë në kuptimin e vërtetë të fjalës”.


Shkrimtarja e parë shqiptare ishte e ndërgjegjshme për udhën që kish zënë, origjinalitetin, por edhe

vështirësitë në drejtimin letrar të saj dhe botimet, duke u nisur që nga libri i parë (1944) “Siç më thotë nënua plakë”, ku botën ajo e vështron me sytë e mendësinë nënos plakë, ndërsa te libri me përralla “Rreth vatrës” (1944), rrëfimi përrallor vjen nga gjyshja plakë, por bota këqyret dhe jepet me syrin dhe mendësinë e fëmijës edhe për fëmijën. Musineja, siç e pohon edhe vetë, del nga vetja e zbret në moshën e fëmijëve, komunikon e dialogon thjeshtë me ta si një fëmijë, ndryshe nga shumë shkrimtarë të tjerë që flasin e shkruajnë së lartmi nga mosha e përvoja e tyre letrare dhe mbeten të ftohtë e të huaj. Ndonëse disa shkrimtarë të njohur të asaj kohe kishin shkelur në këtë taban, si Mitrush Kuteli me “Tregime të moçme shqiptare”, Ali Asllani me “Hanko Halla”, apo Ernest Koliqi me “Hija e maleve” etj., por ndryshe nga ata, vepra e të cilëve është mirëfilli letrar, apo ndryshe nga “Përrallat” e Sotir Kolesë, që ishin mirëfilli nga goja e popullit, Musineja ndjek udhën e vet origjinale, ndërmjet narativës popullore dhe autorësisë së saj letrare.

“Mendimi im ka qenë që t’u jap të vegjëleve një libër, që të mos i lodhë dhe vechen e tyre të mos e gjejnë në një botë të huaj. Në një botë shqiptare, në një vatrë, ku edhe të mëdhënjtë të thonë se vërtet kështu kemi rrojtur. Kur e kam shkruar, nuk kam qenë unë, po një Musine e vogël dhe si e tillë - me mendime të thjeshta dhe gjuhën pyetje-përgjigje...Më duket që kam mundur të hyj në shpirtin e të vegjëleve” - përsiat Musineja.

“Po ju dërgoj “Dasmën gjirokastrite”, - i shkruante ajo Kolesë në një letër të mëparshme, - por jo të gjithë, mbasi ende nuk ka mbaruar. Puna ecën ngadalë në shtypshkronjë. U rri në kokë punëtorëve, por megjithëkëtë ka disa gabime. Të shohim sesi do ta gjeni ju”...

Letra e sapozbuluar, mban datën 8.02.1945, është e panjohur dhe e papërfshirë në botimet e Musinesë. Ajo



e shkruan këtë letër në çastin më të mjeruar të jetës së saj. Dikush mund të mendojë se koha më e tmershme e jetës së saj ishte ishte ajo e burgut të Burrelit, më pas e internimit të gjatë dhe e sëmundjes së rëndë të kancerit, që i mori përfundimisht jetën. Por jo, këto periudha të vuajtjes së parrëfyer të jetës së saj ajo i kishte përballuar me dinjitet, me forcën e karakterit, të vetmisë dhe të lirisë së brendshme.

“Shpirti ka nevojë për vetminë për të qenë i lirë” shkruan ajo. “Ne e kërkojmë lirinë jashtë vetes, ndërkohë që ajo është brenda nesh”.

Në letrën që po shqyrtojmë, gjejmë momentin më të keq shpirtëror të jetës së saj, “e goditur rëndë, e mbuluar me zinë dhe në dallgën më të madhe të jetës”.

Sapo regjimi komunist i kishte pushkatuar pa gjyq vëllezërit e saj, Muntazin dhe Vesim Kokalari. “Plumbat që shtrinë përdhe Muntazin dhe Vesimin të vdekur, na kanë goditur edhe ne, nuk na lënë kufoma të gjalla për jetë, për të vuajtur gjithnjë sa të jemi në jetë” - shkruan hidhur ajo në këtë letër.

Musineja ishte nga një familje e njohur e Gjirokastrës. Vajzë e vetme e juristit të njohur Reshat Kokalari, motër e vëllezërve Muntaz, Vesim dhe Hamit Kokalari, veprimtarë të shquar të kulturës shqiptare, themelues të librarisë “Venus” dhe të shtëpisë botuese “Mesagjeritë shqiptare”, themeluar më 1942, që botonte dhe përhapte vepra të vyera nga literatura botërore e shqipe, si “Hamleti” e “Makbethi” të Shekspir, “Rubairat” e O. Khajamit, “20 vjet ngatërresa ballkanike” të Durhamit, “Ivanhoe” të Skottit, “Kosova-djepi i Shqiptarizmit”, të Hamit Kokalari, librat e Musinesë e të tjera.

Vetë Musineja ishte një intelektuale, që ishte ushqyer me ideologjinë kombëtare të Rilindësve tanë të mëdhenj, e quante veten nxënëse të Sami Frashërit, kishte idhull Naimin dhe Mid’hat Frashërin, ndërkohë që kishte kulturë perëndimore, ishte demokrate dhe kundërshtarë e çdo ideologjie e praktike totalitare.

“Në odën time të vogël, shkruan ajo në ditarin e saj, përballë kam vënë fotografinë e iluministit të shquar, Samiut, të poetit Naim, të patriotit Sotir Kolea, të punëtorit të gjuhës shqipe e të lëvizjes Kombëtare, Jani Vreto, të arsimtarit Koto Hoxhi, të mendimtarit Naum Veqilharxhi, të të nderuarit De Rada dhe të të urtit Aleksandër Xhuvani. Në vetminë time nuk jam vetëm, jetoj me njerëz të nderuar, të ditur e demokratë, që kanë punuar për vendin, për mëmëdhenë gjersa mbyllën sytë...Unë jam nxënësjë e tyre...”

Kryetari i komunistëve, Enver Hoxha, i cili e kishte kushërirë të dytë Musinenë, nuk e kurseu jo vetëm atë, por tërë fisin e Kokalarëve. Më 12 nëntor 1944 terrori i kuq me urdhër të tij dhe zbatuar nga Kristo Themelko, pushkatoi pa gjyq e pa faj pranë hotel “Bristol”, 11 personalitete të shquara të Tiranës, ndërmjet tyre vëllezërit e saj Muntaz Kokalari dhe Vesim Kokalari. Po ashtu u pushkatuan pa gjyq Syrja dhe Emin Kokalari, Hivziu vdiq në burg dhe Isai në internim. Muniri vrau veten. Musineja u burgos dhe u internua. Bijtë dhe nipërit e tyre u hodhën rrugëve, u internuan dhe u persekutuan pafundësisht.

Arsyen e këtij persekutimi familjar na i rrëfen Muntaz Kokalari, vëllai i Musinesë, tek një letër më 9.11.1944, që e kishte shkruar për znj. Makbule tri ditë para pushkatimit të tij:

“ Po përjetojmë ditë të vështira. Kam vendosur me brengë në zemër, të largohem nga Shqipëria ime e



bukur, nga familja e dashur....Këtë vendim e mora mbasi më njoftuan disa nga miqtë e mi të besuar, se jeta ime dhe e të afërmve të mi është në rrezik nga bashtua, Enver Hoxha. Ai ka urdhëruar djajtë e kuq kundër nesh. Kjo kuptohet: thjesht për motive personale.Kjo është fatkeqësi e kombit tonë dhe e Shqipërisë së gjerë, që ka rënë në duart e një njeriu të përbindshëm, tinzar, hakmarrës, inatçi, dinak, megaloman, egoist, kumarxhi e gënjeshtar, që i do njerëzit nën vete; edhe kur qe jashtë për studime nuk dha asnjë provim, mbeti pas kabareve, kazinove etj. Ne intelektualët gjirokastritë ia dimë të gjitha sa i vlen lëkura, prandaj kërkon të na asgjësojë.”

Dhe i asgjësoi.

Musinenë e vrau shpirtërisht persekutimi absurd e kriminal i familjes së saj. “Ky qe fati im , më i hidhur se vdekja “ –i shkruante ajo S.Kolesë.

Njëherësh, edhe fati hidhur i ndërprerjes së dhimbshme të krijimtarisë së saj. “*Sot mora nga shtypi librin e parë dhe po jua dërgoj. Ta kini për vete si kujtim të punës sime më të mirë, që pandeh se kam bërë, dhe të fundit. E mbani për vete, mbasi nuk e nxjerr në shitje. E para, se është dasmë dhe në zi’ duket qesharake; e dyta, se nuk dua më as të punoj, as të shkruaj*”.

Është fjala për librin “Sa u tund jeta” (Dasma gjirokastrite, ku shkrimtarja paraqet saktësisht antropologjinë, ritet, zakonet, veshjet, dialogët, këngët e vallet, lotët dhe gëzimet e dasmës shqiptare, rezultat i një punë të gjatë, pasionante e të palodhshme ndaj folklorit – por në funksion të tekstit letrar)), libër që M. Kokalari ia dërgonte të porsabotuar Sotir Kolesë si një kujtim të mbramë në një kohë zije, por që e konsideronte edhe si punën e saj më të mirë, që për fat të keq ishte edhe botimi i saj i fundit, sepse nuk mund të shkruante më.

“*Përse të punosh? Përse të shkruash? Përse të jetosh?*” –klithte shkrimtarja Kokalari, në dëshpërimin e saj të pafund.

Ky dëshpërim, por edhe revoltë njerëzore dhe intelektuale e përfshin edhe atin e saj shpirtëror, Sotir Kolenë, të nderuarin atë, -siç i thoshte ajo. Në letrën e përgjigjes së Sotirit (dorëshkrimi gjendet në Arkivin e Ministrisë së brendshme, Fondi 140, dosja 2912,viti 1945, letër e pabotuar më parë), gjejmë dhimbjen e lotët e Kolesë per humbjen vëllezërve të saj Muntaz dhe Vesim Kokalari, për të cilët “*kam qarë së largu dy miqtë e çmuar që hikën’ e na lanë në lulen’ e moshës; kam qarë të dy të rinjtë që nuk qenë vetëm lavdi që për të vehtët, po qenë së bashku dhe shpresa për ne, për të paskëtajmen, se kombi ka nevojë për bij që qenë Mumtazi dhe Vesimi, me zëmër për së mbari, me gjykim të matur dhe mendje të pjekur*”, por gjejmë edhe papajtueshmërinë e tij ndaj persekutimit “*me kaqë egërsim*”.

Ai i shkruan Musinesë: “*Shuplaka e fatit’ që shkrepri mbi ju, zonjëzë dhe mbi der’ të juaj është aq e tmerrshme sa ndofta as emër nuk ka të posaqëm në gjuhën tënë, në gjuhën e një kombi që për të gjat’ shekujve, ka pas’ qënë rrahur dhe pjekur’ e djegur’ ndër cen e rrëbjera. As fjalë ngushëllimi nuk kam ku t’i gjenj se helëm i zi, që ju shtrydhi zemrën juve dhe të juajve, është nga ata që nuk kan të zbutur me fjal as me lotë. Bashkë me ju dhe me miqt të mirë të derës’ së juaj, kam qarë së largu dy miqtë e çmuar që hikën’ e na lanë në lulen’ e moshës; kam qarë të dy të rinjtë që nuk qenë vetëm lavdi që për të vehtët, po qenë së bashku dhe shpresa për ne për të paskëtajmen, se kombi ka nevojë për bij që qenë Mumtazi dhe Vesimi, me zëmër për së mbari, me gjykim të matur dhe mendje të pjekur. Zemërsë së juaja dhe Zotit Hamit ju qoftë ngushëllimi të kryerët të detyrave të ra dhe të rënda që her’ e prap’ e sotëme ju shtroj mbi gjithë të tjerat edhe faqe pindërvet dhe faqe të miturve dhe nënave të tyre, që jeta nëpërkëmbi me kaqë egërsim*”.

Gjithsesi, i urti Kolea, edhe ai në prag të vdekjes, i jep kurajë, forcë dhe uzdajë Musinesë, për ta vazhduar jetën dhe punën e saj, se puna është ilaçi i gjithçkaje, por edhe detyra ndaj vetes, njerëzimit, kombit dhe botës.

“*Një gurrë ngushëllimi gjithë aq të vërtetë do t’ ju falinjt puna, kjo detyra e shenjtë edhe faqe vehtesë edhe faqe botësë, që është prej’ e zemrës, shëndet i trupit dhe pus’ i harrimit për troces të jetës; detyrë faqe vehtes jo vetëm sa rreh zemëra po dhe më pas, se jeta zgjatet pak a shumë edhe përtej varrit, detyra faqe hjerësvet, që ka njeriu te të vetët dhe faqe atyre që kanë qenë më parë, detyra faqe miqve dhe faqe njerëzimit, detyra faqe kombit, atdheut edhe botës*”.



Elona Çuliq Poezi

trupi asht gru
mirazh
që pikon në një grusht ujë
gëluem nga shkretina

trupi mund me u ba turp
gur dhe tul buke
që harron gjuhët e tij
ndal kërko lutu

lufto
bëhu prijëse e luftës tande
e trupit tand

trupi asht shkak dhe fund
një kohë që gjakohet në duart
e njeriut që vret
e shoqnisë që nuk bzan

trupi asht stuhi
yll që vajton
mbi kurrizin e përkulun të ndërgjegjes

trupi asht poezia gjuha dhe shtëpia
mësoje
thuaje
pa drojë
pa bujë

trupi asht kufini jonë
ndan skllavninë nga liria
breg lumi ku prehen shpresat
e shpirtnave të tmerruem

trupi asht amaneti jonë
ndan vdekjen nga jeta
disa kanë kangjella në sy
e të tjerë e shohin diellin prej cohës së tendës
të një kampi
a prej tavanit të shembun të shtëpisë
nga bombat

trupi asht kohë e paditun
kohë e pazotnueme
ku andrrat dëshmojnë tmerrin
dhe mllëfin e duerve të përgjakuna
të atyne që mendojnë se munden
me zotnue gjithçka

trupi jonë asht tokë
një pëllambë ku rranjoset mjerimi jonë
ku hajnë copat e bukës së teprueme prej zogjve
fëmijë
që mund të ishte fëmija jonë

trupi jonë asht kufini jonë
dhe i vetmi zot i tij asht Zoti

Ai sheh

Hapat tuej të përndritun
kanë mbjellë në qiellin tem
një pemë që driton gjithmonë.
Ajo nuk njeh stinë e mot,
të njeh vetëm ty.

Fati jem rrokulliset në pëllambën tande,
aty kujtimet bahen shkëndija malli të përmosthëm,

mall për vete.
Unë, pika e ujit në kërkim të Oqeanit,
e shuej etjen teme për ty
në rranjët e pemës që më driton qiellin.

Në përmallimet e natës për ditën,
e të andrrave për lirinë e zakonshme,
kam përgjue vdekjen teme.
E sakaq drita jote dehte heshtjen e moçme
të rrugës atjeposhtë,
që ndritte,
o sa fort ndritte kur terrina mbështillte krejt botën!

Mungesa e tij banon në mua
ndërton kala të ranta
ku flen e kuqja e muzgjeve.
Ai flet me mue me fjalë ngjyem në qiell
dhe në thellësitë e syve të mi
ai asht dritë që pikon.
Tek ai mbështetet faqe e zjarmtë e mallit
dhe gjejnë qeti pasigurtë e kësaj zemre të brishtë
ku nuk ka ma dimën
dhe lulet çelin si pranverë e parathanun.
Mungesa e tij shkoqë lumenjtë e bamun nyj në mue
rrjedhë uji
rrjedhë ai
rrjedhin jetët që kemi gjallue.
Sa i ndryshëm
sa i njajtë
ky mall që i bën ballë zotave të detit
e flen përfund këmbëve të mia
si valë e ngrohtë që vjen nga përtejkohta.
Mungesa e tij banon në mua
e unë shndërrohem në kangë.

a me na vra mendjemadhësia dhe arroganca
ndaj së bukurës, sublimes
mendimi që munden me pasë gjithçka e dona
prejse e meritojmë
padurimi me pasë shumë e tash
mosfalenderimi për çka na jepet dhe çka na merret
mospatja e një lutjeje kujt me ia drejtue
për ata që nuk njohin Zot tjetër veç vetes

ka me na vra alibia
me të cilën qendisim jetët tona për publikun
ajo jetë që jena e nuk munden me e tregue
me e jetue lirshëm
jeta ka me marrë hakun e vet ndër ne
për mohimin e ekzistencës
për prangosjen e shpërfaqjes
dhe ka me kenë vonë për me u pendue

ka me na vra poezia
ajo që e kena vjedhë në kopshtije të hueja
ajo që e kenai stisë për me fry egon
ajo që nuk asht por zoritena me kenë
ajo që ia mbyttë zjerminë e shkëndijes metafora

ka me na vra fjala
që nuk e thona e nuk e shkruejmë
sepse kena frikë nga e vërteta
ka me na vra liria
iluzioni i njeriut të madh
atij që asht ma shumë se mishi e gjaku
atij që asht ma shumë se gjurma
dhe hijja e vet

ka me na vra lutja që nuk e thona
SOT

Akuarumi i profesorit

Tregim nga Resul SHABANI

Në vjeshtën e 1947- tën, njeri s'di ta thotë me siguri në ishte vjeshta e parë apo e dytë se, për të tretën s'bëhet fjalë të kishte hyrë, sëmundja e mbërtheu siç di ajo, kur e ka me gjithë mend të të shtrojë në shtrat. Po asaj vjeshte Profesori mori pensionin e pleqërisë, natyrisht sipas ligjit. U struk në dhomën e vogël të banesës, diku në periferi të Nju Orleansit, e nuk e pa njeri me sy që të kishte dalë më prej aty, deri në ditën kur e nxorën ata të shërbimeve mortore, bashkë me arkivolin e zbukuruar. Vdiq më 1963, po në një vjeshtë të vonuar. Vërtet asaj vjeshte kishte të reshura të imëta shiu dhe era frynte e lehtë nga veriperëndimi, por që vështirë shkëputi gjethet nga majat e plepave të bardhë mbi kodrinën e rrëpirë, që zgjatej kah malet e varguara me kurriz të dhëmbëzuar.

Gazetari, ç'është e drejta, disa vite më parë, qe interesuar të bënte një intervistë me Profesorin plak. Ky i fundit nuk e pranoi asnjëherë, ndonëse Gazetari, siç e pohoi më vonë Gruaja e Përhimët, bëri shumë përpjekje. Kjo grua, e cila ua bënte me sy të pesëdhjetave, e që kujdesej për Profesorin plak, duke i ndihmuar atij në ditët e pleqërisë së ngrysur, gjithnjë e priste Gazetarin te dera dhe, duke mos e lënë të hynte brenda, ia bënte me dije se Profesori kishte vite që s'fliste me njeri. Bile, shtonte kjo, se nuk ishte çudi që ta ketë humbur edhe vetëdijen. Sipas rrëfimeve të saj, ai më shumë i ngjasonte një mumieje të gjallë, se sa njeriut që frymon me mendime.

- Nuk e di se ç'nevojë e çuditshme ju shtynë të bisedoni me të? - i thoshte kjo Gazetarit. - Ju me siguri nuk e dini se ai ka më shumë se dhjetë vjet që as ka parë, dhe as e ka parë njeri me sy.

- Për akuariumin erdha, - i thoshte Gazetari. - I tërë qyteti e di se Profesori ka një akuarium të mrekullueshëm, në të cilin ruan llojet më interesante të peshqve.

- S'është e vërtetë! - i përgjigjej kjo. - Profesori nuk ka diçka të tillë. Në këtë shtëpi nuk ka kurrfarë peshqish... e aq më pak disa lloje më interesante syresh.

Përveç Gazetarit dhe ca shkencëtarëve zoologë, të cilët jetonin në këtë qytet të madh, për akuariumin ishin interesuar edhe njerëz të tjerë. Por, ama, me Profesorin njeri s'kishte kontaktuar, përveç Gruas së Përhimët. Për Profesorin ishin thurur tregime të ndryshme, bile disa ishin fare fantastike. Sit Lëvdaçi, ishte i pari që kishte dyshuar në përmbajtjen e tregimeve të çuditshme mbi akuariumin e Profesorit. Por, meqë ky ishte një bjerrakohës, i cili jetonte mjaft mirë, pa ditur kush burimin e të hyrave të tij që i prishte kafeneve të qytetit të madh, askush nuk denjonte t'i besojë, se Profesori nuk ka kurrfarë akuariumi. Kërshëria e njerëzve nuk shuhej, sidomos e zoologëve.

- Po mirë, - thoshte Sit Lëvdaçi në kafenenë "Delfini", - ... po mirë! Ta zëmë se Profesori ka një akuarium të tillë: po me se i ushqen ato peshq? Dhe kush ia sjell nga ujërat e gjithë dynjasë? Pastaj si është e mundur që në shtëpinë e tij s'ka shkelur këmbë njeriu, e të na e thotë me gojën e vet. Lini muhabetet!

- Gruaja e Përhimët, - thoshin ata me një zë, por jo aq të sigurt.

- As ajo nuk del nga shtëpia, veç kur shkon në pazar për furnizime. Më së largu shkon deri te kasapi, por atje peshq nuk ka.

- Natën. Natën mund t'ia sjellin. He, s'i dihet kësaj pune! Ka, ka vend për dyshime, po të duash të dyshosh!

- Natën? Natën thoni ju. Po pse unë vetëm ditën kam survejuar, hë? Vetëm ditën? Natë e ditë, ditë e natë, kam qenë këtu përreth. Njeri të gjallë s'kam parë të futet në shtëpi. Pastaj njeriu në xhep do t'i sjellë ata alamet peshq!? - Po mos kishte gjë të vërtetë për akuariumin e tij, s'do të fliste tërë qyteti. - ia prisnin të tjerët nga tavolina përbri.

- Ku ka zë, s'është pa gjë, shtonte dikush si nëpër dhëmbë! Duhet të ketë diçka të vërtetë. Po si.

- Të gjitha këto thashetheme, - vazhdonte Sit Lëvdaçi, - s'janë asgjë tjetër, veç trillime të pakripa të atij Gazetarit të marrë që kërkon sensacione, për ta shitur gazetën e tij të pshurtë. Dëgjoni Sitin ju! S'ka kurrfarë akuariumi Profesori i paralizuar. Kjo është e vërteta, tjetër s'ka.

- I paralizuar!? Jo, more! S' e paskemi ditur. Ne na kanë

thënë se është i sëmurë. Kaq, Por, që të jetë i paralizuar, jo se jo. Po qe kështu ndryshon puna, se i paralizuari s'mund të kujdesej për akuariumin. Kërkonte lëvizje ajo punë. - tha më i vjetri.

Njerëzit kthyen shikimin kah Sit Lëvdaçin dhe, duke u hamendur heshtnin të thelluar në mendime. Opsesioni akuarium u qe bërë tapë në mendje, madje edhe atyre që s'kishin lidhje me shkencën në përgjithësi dhe me peshqit në veçanti. "Mund të na bëjë të njohur në tërë botën, mund të jetë ndonjë shkencëtar i madh, i cili s'dëshiron të bëhet me nam derisa është gjallë dhe të cilit i pëlqen përmendorja pas vdekjes. Shumica syresh, të tillë janë. Njerëz me ideale...", flisnin njerëzit nëpër qytet.

- Po kur ju them unë! - ngulte këmbë Sit Lëvdaçi, - Këto të gjitha janë trillime dhe gjepura të atij dreq Gazetari. Me sa di unë, e unë di shumë, në qytetin tonë s'ka folur njeri për atë farë akuariumi të Profesorit. Punët morën dheun prej ditës kur ky i shpifuri gazetar botoi atë shkrimin e mallkuar në atë gazetën edhe më të mallkuar. Po na e nxu jetën, more! Supozimet e tij se Profesori, pensionist i paralizuar dhe me sëmundjen e mushkërive, paska një akuarium, në të cilin kultivoka disa lloje peshqish shumë interesante, duke i studiuar fije për pe disa ligjshmëri prej të cilave nxjerr disa përfundime, që për shkencën zoologjike do të jenë me interes epokal, janë fare pa bazë. Fjala epokal gjithsesi që i ka trazuar, jo vetëm njerëzit e rëndomtë, që, ç'është e drejta, edhe nuk e dinë aq mirë kuptimin e fjalës e p o k a l, por sidomos të shkencëtarëve. E, po, tani flasin njerëzit e s'ka kush i ndal, edhe pse flasin kot fare. - përpigjej t'i bindë Siti.

- Vitet kalonin me përtesë, kurse enigma vinte e ngulitej në kokat e njerëzve të qytetit të madh. Dhe, si për habi, sa më shumë që Sit Lëvdaçi mohonte faktin se ekziston ndonjë akuarium me aq interes, në mendjen e qytetarëve kërshëria sa vinte e rritej, duke marrë përmasa shumë të mëdha. Ç'është e drejta, njëherë u botua një artikull mjaft interesant, por kësaj radhe jo në gazetën lokale, por në një qendrore. Ky shkrim, natyrisht, nuk e hidhte poshtë mundësinë e ekzistimit të akuariumit. Tani s'kishte mbetur tjetër, veç vdekja e Profesorit dhe të zbulohet tërë ky mister. Kjo ishte arsyeja që vdekja e tij pritej me padurim, që për raste të tjera do të ishte një marrëzi. E, nga ana tjetër, si për inat, vitet rrëshqisnin aq ngadalë.

- Do të shohim, - qeshte me ironi Sit Lëvdaçi. - Sa të vdesë plaku i marrë, e do të bindeni se ka për të dalë fjala ime. Unë do t'ju lutesha të mos e lodhni më mendjen me atë farë akuariumi, pasi atë s'do ta shihni kurrë. Ai nuk ekziston. Punë e madhe se ka shkruar gazeta qendrore!



Bash punë e madhe!

Dhe, më në fund, ia behu edhe viti 1963, viti që pruri me vete edhe vdekjen e Profesorit aq të pritur dhe aq të dëshiruar prej disave. Ishte vdekje që pritej me shumë kureshtje, prandaj edhe u përhap me shpejtësi rrufeje. Bile, shumë më shpejt se sa mund të merrej me mend. Menjëherë, një grup gazetarësh vrapuan në shtëpinë e, tanimë, të ndjerit Profesor. Në mesin e tyre, natyrisht, nuk mund të mos ishte Sit Lëvdaçi dhe Gazetari që shkaktoi kureshtjen. Herët në mëngjes, grupi i të shtatëve (aq veta numëronte Këshilli i Varrimit, formuar nga Shërbimi Mortot), ia behën te dera e banesës së Profesorit. Derën ua hapi Gruaja e Përhimët, pak e bezdisur, pak e frikësuar dhe pak e përlotur.

- Ne jemi caktuar të përkujdesemi për varrimin e Profesorit, - i tha asaj Gazetari.

- Përsëri ti! - u habit Gruaja.

- Si të them, qe... - u hutua Gazetari.

- I pashpirt! - bëri Gruaja, - Gënjeshtar. Vagabond...

- E, po, ... e dini, s'kam kurrfarë faji... - belbëzoi ai.

- Dhe, jo vetëm ti, por këtu na qenka edhe ky tjetri! - bërtiti Gruaja, duke treguar me gisht kah Sit Lëvdaçi.

- Unë!? - u habit Siti.

- Po, po, ti, që tërë natën vareshe tek dritarja e plakut të lodhur, duke e përgjuar të shkretin se ç'punonte në dhomë.

- E kisha për ... - bëri Siti, por ajo e ndërpreu me një shikim të ashpër, e Siti lëshoi sytë përdhe.

- Urdhëroni!... - tha më në fund Gruaja. - Zotërinj, - vazhdoi ajo, - t'ju tregoj që në fillim: prej ditës së djeshme, pronare e ligjshme dhe e vetme e kësaj banese dhe e kësaj pasurie, jam unë. Mos dëshiron dikush ta shohë testamentin?

- Të besojmë, të besojmë - thanë me një zë, por të lodhur nga kërshëria për të parë ç'djallë fshehtësie ishte mbuluar mbi atë kulm decenie me radhë.

Kur u futën në dhomën e parë, duke kaluar mesores së ngushtë, Gruaja e Përhimët u tregoi karriget ku do të uleshin.

- Uluni, - u tha. - Tani kini durim sa t'ua pjek nga një kafe. - dhe hyri në njërin nga dhomat e shtëpisë. Për çudinë e të gjithëve, asnjëri nuk u ul. Nuk i zinte vendi. I pari që provoi të çelë ndonjë dhomë tjetër, përveç asaj ku hyri Gruaja, ishte përsëri Gazetari. Dyert ishin të kyçura. Kur u afrua Gruaja me kafetë që avullonin, Siti tha: Dëshirojmë ta shohim Profesorin e ndërjer.

- Gjithsesi, - tha ajo. Vajti dhe e hapi njërin nga dy dyert karshi, me një çelës të madh e të nxirë. - Urdhëroni, - tha, edhe njëherë, duke bërë me dorë kah dera e posa hapur.

Asnjëri nga të shtatë nuk e mori guximin të futet i pari. Së pari, sytë u ndeshën me një terr të plotë, pastaj hunda me një kutërbim të çuditshëm, që mbase vjen nga sendet e mykura dhe të prishura. Kur u fut aty Sit Lëvdaçi, e pastaj edhe Gazetari, kishin ç'të shohin: një odë e zbrazët me një krevat të madh e të vjetër hekuri në mes. Asnjë orendi tjetër. Asnjë. Mbi atë krevat qëndronte i shtrirë trupi i pajetë i Profesorit. Ishte mbuluar me një mbulesë të gjelbër.

Posa u kthyen në dhomën e pritjes, Gazetari e pyeti Gruan e Përhimët, nëse kishte mundësi të shikonin se ç'ka në dhomën tjetër, dera e së cilës rrinte e kyçur.

- Asgjë. - tha Gruaja, - Ca plaçkurina të vjetra. Dy-tre kolltukë, vitrina dhe një komodinë.

- Dhe asgjë tjetër?

- Edhe akuariumi, - shtoi ajo. - por tani është prona ime. A dëshironi ta shihni ... testamentin?

- Të besojmë, zonjë e nderuar, të besojmë. - tha Gazetari.

- Do të ishte mirë ta shikonim atë akuarium, - tha Sit Lëvdaçi, që ishte zbehur fare, dhe në fytyrë nuk i kishte mbetur pikë gjaku.

- Si urdhëroni! - tha Gruaja.

Kur u futën në dhomë të shtatë anëtarët e Këshillit të Varrimit, panë një epruvetë të pambuluar, fundi i së cilës nuk dukej, por pjesa e epërme ishte mbushur me një ujë të kthjellët si loti. Me kutia dhe fije shkrepëse, në mënyrë miniaturale, mjeshtri i kësaj çudie kishte bërë reliefsin e njëfarë liqeni...

- Qe, këto shtëpi të bukura janë të qytetit të Ohrit. Në të majtë është Struga, e në të djathtë është Shën Naumi. Ky përballë Ohrit, është Poradeci. Këto maja të imëta shkrepëse, tregojnë Kalishtin, i cili, në ujin e kthjellët të liqenit, lanë këmbë e faqe. Profesori tërë kohën rrinte duke punuar mbi këtë gjësend. Pranë kësaj kutie e hante bukën, e pinte ujin, e bënte gjumin. - përfundoi Gruaja e Përhimët. - A mund ta shes?

- Të pranishmit kishin mbetur pa frymë.

Të nesërmen, të gjitha gazetat e Nju Orleansit kishin botuar lajme dhe materiale interesante për enigmën e zbuluar.

Qytetarët kureshtarë të qytetit të madhe, morën frymë lirisht.

Vullnetarët

Tregim nga Bruce Chatwin

Më pas erdhi lufta.

Për vite të tërë, tregtarët në Rhulen flisnin se do të bëhej luftë me Gjermaninë, ndonëse askush nuk e dinte se cili do të ishte qëllimi i vetë luftës. Që nga beteja e Vaterlosë, luftë të vërtetë nuk kishte pasur, dhe të gjithë binin dakord se me hekurudhat dhe armët moderne kjo luftë, o do të ishte shumë e tmerrshme, o do të mbaronte shumë shpejt.

Më shtatë gusht 1914, Amos Jones dhe djemtë e tij ishin duke kositur carangth, kur papritur dikush, përtej gardhit, tha me zë të lartë se gjermanët nuk e kishin pranuar ultimatumin e Anglisë, dhe ishin futur në Belgjikë. Një zyrë rekrutimi, tha ai, ishte hapur në bashki. Rreth njëzetë djem të zonës i ishin përgjigjur thirrjes për të shkuar ushtar.

‘Marrëzi,’ Amos ngriti supet, duke hedhur vështrimin poshtë kodrës në drejtim të Hertfordshire.

Të tre vazhduan kositjen, por në momentin që u futën në shtëpi për të ngrënë darkë, djemtë dukeshin të nervozuar.

Mary ishte marrë me përgatitjen e turshisë së panxharit, ndaj dhe përparësja e saj ishte bërë vija-vija dhe me njolla në ngjyrë të purpurt.

‘Mos u shqetësoni,’ tha ajo. ‘Jeni tepër të rinj për të shkuar në luftë. Veç kësaj, ka të ngjarë që deri për Krishtlindje lufta të ketë marrë fund.’

Dimri erdhi, por fundi i luftës nuk po dukej gjëkund. Zoti Gomer Davies filloi predikimet patriotike, dhe një të premte, i dërgoi fjalë të gjithë banorëve të zonës se duhej të merrnin pjesë në një seancë predikimi që do të zhvillohej nën dritën e një feneri në Sallën e Grigjës.

Ngjyra e qiellit po shndërrohej nga një e kuqe e errët në një gri të zymtë. Dy limuzina sapo kishin parkuar në anë të rrugës; një turmë e përbërë nga punonjës të fermës, të veshur me rrobat e tyre më të mira, po bisedonte miqësisht me drejtuesit e mjeteve, dhe përmes dritareve, shikonte ngultas sixhadet e gëzofta dhe tapicerinë e lëkurtë. Djemtë nuk kishin parë kurrë nga afër makina të këtilla. Diku nga një plevicë dëgjohej gërhimja e një gjeneratori elektrik.

Zoti Gomer Davies po qëndronte në verandë nga ku mirëpriste të sapoardhurit me një shtrëngim të dorës dhe një buzëqeshje të irët. Lufta, tha ai, ishte një kryqëzatë për Krishtin.

Brenda në sallën e madhe një sobë qymyri qëndronte ndezur, ndërkohë, dritaret ishin veshur me avull. Një varg llambash elektrike lëshonte një perde ndriçimi të verdhë mbi muret e veshura me dru, dhe të lustruar me vernik. Shumë flamuj të Britanisë së Madhe ishin renditur njëri pas tjetrit pranë fotografisë së Lordit Kitchener.

Feneri magjik ishte vendosur në mes të korridorit. Një çarçaf i bardhë ishte mbërthyer në një farë lartësie në funksion të një ekrani; Një oficer që mbante veshur uniformën e majorit, me njërin krah të lidhur me fashë, po i besonte kutinë me diapozitivë operatores së filmit.

I mbuluar nga një perde tymi folësi kryesor, koloneli Bickerton, kishte zënë vend në podium dhe bisedonte me një veteran të Luftës Boere. Ai shtriu këmbën e tij problematike në drejtim të të pranishmëve. Një kapelë mëndafshi pushonte mbi mbulesën e blertë të tavolinës pranë një kane dhe një gote uji.

Meshtarë të ndryshëm të Zotit – të cilët i kishin lënë mënjatë mosmarrëveshjet mes tyre në një rrezm patriotizmi – u ngritën në këmbë në shenjë respekti ndaj çifligarit, por edhe për të treguar shqetësimin e tyre në lidhje me rehatinë e tij.

‘Jo, jam shumë mirë, ju faleminderit,’ Koloneli shqiptoi çdo rrokje në një mënyrë të përsosur. ‘Ju falënderoj për kujdesin e madh që tregoni për mua. E shoh se jemi mbledhur goxha sot. Kjo është shumë inkurajuese, apo jo?’

Salla ishte mbushur plot e përplot. Djem të rinj, me fytyra që tradhtonin ekspozimin ndaj elementeve të natyrës, kishin mbushur stolat e gjatë; disa prej tyre, me

ndihmën e bërlylave, kërkonin të dilnin përpara për ta shikuar më mirë vajzën e Bickerton-it, zonjushën Isobel – një brune me flokë të zinj, me buzë të kuqe qumështore dhe sy të njomë kafe në të kuqërremë, e cila, e veshur me një gunë të gëzoftë prej lëkure dhelpre, qëndronte poshtë platformës e qetë, duke buzëqeshur. Nga kapela e saj delikate ngrihej lart një pupël struci në ngjyrë gri me nuanca rozë. Përbri saj, i mbledhur krspull, qëndronte një djalë i ri me flokë kuqalashë dhe gojëhapur.

Ishte Jim Shkëmbi.

Anëtarët e familje Jones zunë vend në një stol të gjatë diku nga fundi i sallës. Mary e ndjeu se i shoqi, i cili qëndronte ulur pranë saj, ishte i zemëruar dhe me nerva të tendosur. Ajo druhej nga një skenë e mundshme që ai mund të bënte.


Famullitari i Rhulen-it e hapi sesionin duke propozuar një fjalë falënderimi për zotin Gomer Davies, i cili kishte bërë të mundur përdorimin e sallës dhe të rrymës elektrike.

Thirrjet ‘Dëgjoni! Dëgjoni!’ ushtuan në të gjithë sallën. Më tej ai vijoi me një përshkrim të shkurtër të origjinës së luftës. Të paktë ishin ata punonjës të fermave kodrinore që e kuptuan përse vrasja e një arkiduke në Ballkan duhej të bëhej shkak për pushtimin e Belgjikës; sidoqoftë, kur famullitari foli për ‘rrezikun ndaj Perandorisë sonë të dashur’, të pranishmit u ulën sërish në vendet e tyre.

‘Nuk mund të ketë paqe,’ tha ai duke ngritur volumnin e zërit të tij, ‘përderisa shoqëria jonë evropiane të pastrohet nga ky kancer. Gjermanët do të lëshojnë piskama çjerrëse si çdo mujshar që vihet me shpatulla për muri. Kompromis, ama, nuk duhet bërë, siç dhe nuk duhet të ketë shtrëngime duarsh me djallin. Nuk ka kuptim t’i bësh moral një krokodili. Atë duhet ta vrasësh!’

Të pranishmit në sallë duartrokitën, ndërsa kleriku u ul në vendin e tij.

Pak më pas i erdhi radha majorit, i cili tha se ishte plagosur në Mons. Bisedën e filloi me një shpoti, ‘me detyrim, zona Rhin, na angullin’ (1) – dhe menjëherë pas kësaj ai shtoi me gjallëri, ‘Asnjëherë nuk e kam vrarë mendjen për verërat e Rhin-it. Ato mbajnë një erë shumë të fortë frutash; çfarë thatë?’



Pa kurrfarë vonese majori ngriti lart shtagën e oficerit. ‘Dritat!’ thirri ai, dhe menjëherë ato u fikën.

‘Një sërë imazhesh të mjegullta u projektuan njëra pas tjetrës në ekran – ushtarë anglezë në kampe ushtarake, në paradë, në anije transportuese që përshkonin la Manshin; ushtarë anglezë në një kafene franceze, në llogore, tek hapnin bajonetat, si edhe të tjerë që ‘e tepronin’. Disa prej diapozitivave ishin aq të paqarta, saqë ishte e vështirë ta dalloje se cila ishte hija që lëshonte pupla e kapelës së zonjës Isobel, dhe cilat ishin shpërthimet e predhave.

Në diapozitivin e fundit u shfaq një fytyrë absurde me sy të zgurdulluar, dy krahë korbi në buzën e sipërme, si edhe një goxha shqiponjë e artë mbi helmetë.

‘Ky,’ tha majori, ‘është armiku juaj – Kaizeri Wilhelm II i Gjermanisë.’

Menjëherë u dëgjuan britma të fuqishme, ‘në litar’ dhe ‘të përgjaket e të bëhet shoshë nga plumbat!’ – pas britmave, majori, si dhe gjithë të tjerët, u ul.

Koloneli Bickerton u ngrit me lehtësi në këmbë dhe kërkoi të falur për pamundësinë e së shoqes për të qenë e pranishme në sallë.

Djali i tij i vetëm, u shpreh ai, ishte duke luftuar në Flanders. Ai tha se shpresonte që pas skenave tronditëse që sapo kishin parë, numri i të rinjve në rajon, të cilët do t’i bënin bisht luftës, kishte për të qenë fare i vogël.

‘Kur kjo luftë të ketë marrë fund,’ tha ai, ‘në vendin tonë do të ketë dy grupe njerëzish. Nga njëra anë do të jenë ata që u bashkuan me forcat e armatosura, dhe nga ana tjetër, ata që nuk guxuan të vepronin kështu...’

‘Turp,’ klithi një grua me kapelë blu.

‘Unë jam Numri Një!’ këlthiti një i ri tek ngriti dorën.

Por koloneli bëri shenjë me dorë në drejtim të turmës, dhe të gjithë të pranishmit ranë në qetësi:

‘...dhe do të ketë nga ata që u treguan aq të aftë saqë, me gjoksin përpara, dolën për të bërë detyrën e tyre ndaj Mbretit, atdheut, si edhe nënave, grave e vajzave tona...’

‘Po! Po! Përsëri duart u ngritën lart me një hijeshi të veçantë, ndërsa turma heshti sërish:

Klasa e fundit, nuk dua të flas më shumë, do të jetë aristokracia e këtij vendi – e cila, në ngryse të jetës së saj do të marrë zemër, sepse, atë çka Anglia pret nga çdo njeri, ajo e ka bërë, pra, detyrën e vet...’

‘Po Uells?’ Një zë monoton tingëlloi në të djathtë të zonjushës Bickerton; por, zëri i Jim-it u mbyt në krahurën amorfe.

Vullnetarë të shumtë vërshuan drejt majorit me synimin që gjithsecili prej tyre t’ia raportonte emrin e vet me gjithë fuqinë që kishte.

Në sallë buçitën thirrjet ‘Hip! Hip! Hurrah!’ Zëra të tjerë shpërthyen në këngë, ‘Se ata janë djem të mirë...’

Gruaja me kapelë blu i hoqi një shuplakë në fytyrë të birit në krah, duke u çjerrë, ‘Oh, po, ke për të shkuar!’ – ndërkohë, një qetësi e brendshme gati fëmijërore kishte zbritur në fytyrën e kolonelit.

Ai vazhdoi, me tone ngjethëse: ‘Dëgjoni këtu, kur Lordi Kitchener thotë se ka nevojë për ju, ai e ka fjalën pikërisht për ju. Për arsye se gjithsecili prej jush, djem trima, është i domosdoshëm. Disa çaste më parë, dëgjova një zë në krahun e majtë që thërriste. “Po Uells?”’

Papritur, përreth s’pipëtinte asgjë.

‘Të më besoni të gjithë sa jeni këtu, ajo thirrje, “Po Uells?” është një thirrje që më shkon drejt e në zemër. Sepse në damarët e mi, gjaku uellsian dhe gjaku anglez rrjedhin në sasi të barabartë. Kurse ajo...ajo është vajza ime, ndaj këtë mbrëmje kam sjellë me vete dy makina këtu. Ata të rinj, të cilët dëshirojnë të regjistrohen në Regjimentin tonë të dashur Herefordshire, mund të vijnë me mua...Të tjerët, uellsianët besnikë, që do të preferonin të regjistroheshin në Regjimentin tjetër, më trimin, atë të Banorëve Kufitarë të Uellsit Jugor, mund të udhëtojnë me vajzën time dhe majorin Llewellyn-Smythe për Brecon...’

Ja, kështu, Jim Shkëmbi shkoi në luftë – për hir të largimit nga shtëpia, si edhe për hir të një zonjë me buzë të kuqe qumështore dhe sy të njomë kafe në të kuqërremë.

Përktheu nga origjinali **ARISTIDH SHQVI**

Shën. i përkth. (1) ‘*Making the Rhine whine*’ – bëhet fjalë për një lojë fjalësh. Konkretisht, fjalët *whine* (‘uain) *angullin* dhe *wine* (‘uain) verë, shqiptohen me të njëjtën mënyrë. Kjo është arsyeja që pas fjalës *whine* në tekst, autori i referohet *verës* për efekt humori.

DANTJA DHE “KOMEDIA HYJNORE”

Nga Natalino Sapegno



Autori i epistolës aq të diskutuar drejtuar Cangrande della Scala-s e shpjegon objektin e *Komedisë* si synim për “t'i larguar nga gjendja e mjerimit ata që rrojnë në këtë botë dhe për t'i shoqëruar në një gjendje lumturie” (*removere viventes in hac vita de statu miserie et perducere ad statum felicitatis*); dhe shton se lënda filozofike ku inkudrohet ky qëllim është etika, e nënkuptuar si reflektim për themelet e të vepruarit dhe si mjet aktiv i vetë veprimi; aq sa e gjithë poema, në strukturën e saj të ndërlukuar e të shumëllojshme, si dhe në harmonizimin e alternuar të pjesëve arsyetuese, shpjeguese dhe argumentuese, – me përmbajtjen e saj doktrinale dhe shumësinë e domethënieve të drejtpërdrejta e të atyre alegorike, si dhe me atë “modus tractandi”, që është specifiktisht poetike, pasi shpërfaqet në një trillim të pasur e të ndjeshëm narrativ dhe dramatik, – mund të thuhet se është “e konceptuar jo për abstragime teorike, por me synim veprimin” (*non ad speculandum, sed ad opus inventum*). Nuk ka rëndësi këtu të zgjidhet çështja e autenticitetit të epistolës, ndaj së cilës edhe në kohët tona janë ngritur mjaft dyshime, megjithëse shumica të imëta e të ndërlukura më shumë se të mbështetura në argumentime të shëndosha e të sakta filologjike; ka interes, në të kundërt, të njihet dhe të shpërfaqet përcaktimi i thukët i propozuar për thelbin e veprës, si ai që më mirë se të tjerët, edhe sot, përvijon, në kuadër të një rrethane kulturore dhe historike të dhënë, qëllimin e parë dhe formën e saj, impulsin e fuqishëm njerëzor e moral dhe orkestrimin e larmishëm të elementeve abstrakte dhe fantastike, që synojnë në tërësinë e tyre të njëjtin objektiv ndriçimi dhe ndërtimi: atë të programit të reformimit dhe të profecisë, të paraqitjes apokaliptike të shprishjes mondane dhe kumtit të zjarrtë të ringjalljes, të akuzës dhe nxitjes: atë të një sistemimi të mrekullueshëm skemash doktrinale që, duke iu përshtatur të gjitha të dhënave, edhe më të imëtave, të realitetit rrethues, synon në çdo çast, në mënyrë të ndërgjegjshme, të transformohet në një teh të mprehtë veprimi dhe çlirimi vetjak e shoqëror, moral e politik.

Gjetja e formës së “lumturisë” njerëzore, në rrafsh të realitetit rrethues dhe atij të përjetshëm, do të thotë, në fakt, për Danten, në çastin kur nisi të krijojë poemën, të qartësojë dhe të kapërcejë brenda ndërgjegjes së tij, në mënyrë subjektive dhe objektive, duke u përpjekur të shëlbojë “botën që n'teposhtë është varë” (*mondo che malvive*), arsyet “e gjendjes së mjerimit” (*status miserie*); nënkupton, pra, një interpretim me hov polemik të situatës historike dhe një vullnet veprues për të ndërhyrë në atë situatë, për ta modifikuar dhe për ta sjellë në “rrugën e vërtetë” (*diritta via*): nevojën për ta rivendosur atë qëndrueshmëri, që ai e percepton si të rrezikuar rëndshëm e thujasë të shkatërruar, në ekuilibrin intelektual dhe

normativ, konsakruar nga tradita shekullore e kulturës; për ta risjellë qytetin e njeriut, që është larguar në mënyrë të rrezikshme dhe ka mbërritur në zgrip të shkatërrimit, e ta pajtojë çdo moment dhe rrethanë me modelin hyjnor të qytetit të Zotit.

Kjo nevojë, duke u inkuduar në shkallën më të lartë të zhvillimit dhe përdimit të kulturës mesjetare e skolastike dhe në sferën e një përvoje vetjake shumë të vuajtur, kërkon një zgjidhje jo teorike dhe abstrakte, por konkrete dhe aktive në rrafsh të dhimbjes e të bindjes, me qëllimin për të trandur dhe për të nxitur ndjesitë, fantazinë dhe vullnetin e lexuesit: jo një traktat, një “majë e sintezës” (*summa*) filozofike, por një përrallë simbolike, e aftë të shkrijë në strukturën e saj të pandashme një tërësi të gjerë dhe imtësisht të përcaktuar elementesh përgjithësuese dhe fantastike, të përkthejë idetë në mite dhe imazhe që i përshtaten pasurisë dramatike të një përvoje të tanishme. Nga ky thelb përvojash biografike dhe arsyes morale, ku pendimi dhe synimi i konvertimit e i përtëritjes së njeriut si individ lartësohet dhe zgjerohet derisa të shpërfaqet në vetvete ankhin dhe nevojën për përtëritje të njerëzimit mbarë, buron poema me natyrën e saj të dyfishtë, vetjake dhe universale, lirike dhe etike; pasqyrim poetik, ndonëse i mbështetur në një skelet shumë të qëndrueshëm arsyesh doktrinale të një procesi të dyfishtë shpërlimi (*redenzione*): të njeriut Dante, prej gabimeve të tij, nëpërmjet qasjes dhe vëzhgimit të kthjellët të pasojave të mëkatit, si dhe shpresa e vizioni i “lumnisë së amshueme” (*eterna beatitudine*); si dhe të gjithë njerëzve, nga gjendja e pështjellimit dhe bjerres ku kanë rënë nga padija dhe nga faji, falë ndërgjegjësimit për synimet tokësore dhe qiellore që atyre u janë dhënë nga “provanija” (*Providenza*), dhe përcaktimit të duhur të dy pushteteve, atij kohor dhe atij shpirtëror, që kanë detyrën për t'i shoqëruar në kryerjen e atyre qëllimeve.

Kultura e kohës dhe sugjestionet letrare të mesjetës i hapnin udhë si të natyrshëm dhe të domosdoshëm trillimit të një udhëtimi në botën tjetër, si ai që, më mirë se çdo tjetër, do t'i jepte shkrimtarit mundësinë për të projektuar dhe për të sistemuar elementet e shpërndara të një kronike të lëvizshme, të çrregullt dhe kontradiktore, në sfondin e palëvizshëm dhe harmonik të një rendi qiellor të drejtësisë së përsosur, ndërkohë nga ana tjetër do t'i lejonte të kryente paralelisht dhe të ngjizte në një të vetëm dy çastet e përbashkëta të frymëzimit të tij: atë të paraqitjes ideale të përvojes së tij autobiografike dhe synimit objektiv të ndreqjes fetare dhe politike të shoqërisë që ka humbur rrugën dhe është prishur.

Në ç'mënyrë e kur lindi paraprakisht dhe mori formë dalëngadalë në shpirtin e Dantes një përgjithësim i tillë dhe trillimi strukturor në të cilin ai do të shpërfaqej, si dhe përvijimi

i detajuar i gjithë trajtesës, nuk mund të thuhet thjesht, ndërsa vazhdon ende dhe nuk duket se do të marrë zgjidhje në një ide që të dakordësojë shumicën, debati i studiuesve për gjenezën dhe kronologjinë e poemës, e ndërkaq ngelet, e me gjasa do të ngelet përgjithmonë, po aq e pasigurt dhe e mangët dhe problematike, njohja nga ana jonë e jetës së poetit.


Për sa i përket kohës së shkrimit, ndër vlerësimet divergjente midis atyre që ua atribuojnë krijimin e plotë të veprës viteve të fundit të jetës së Dantes, pas humbjes së ndërmarrjes së Arrigo-s VII, dhe tyre që e mendojnë të filluar rreth vitit 1307, kjo e dyta, pavarësisht argumentimeve të brendshme dhe të jashtme me të cilat e mbrojnë mbështetësit e saj, duket më e arsyeshme, veç të tjerash për faktin se kjo hapësirë e gjerë kohore jep mundësinë e ndërtimit të një konstrukti aq të gjerë dhe të ndërlukuar. Por ajo që na shtyn të parapëlqejmë këtë tezë është përqasja e kujdesshme e pjesëve të ndryshme të librit dhe bindja që rrjedh në lidhje me modifikimin dhe pasurimin e pjesshëm të konceptit moral, politik dhe fetar të shkrimtarit, me zhvillimin shkallëzor të kushteve psikologjike dhe sentimentale; nga ku rrjedh një proces i dyfishtë saktësimi i skemave doktrinale dhe një konfigurim më i saktë i idealit etiko-politik, nga njëra anë, si dhe i dobësimit progresiv dhe rafinimit të impulsit fillestar satirik dhe polemik.

La vlen, në fakt, të konsiderohet *Komedia* si një vepër “në krijim e sipër” (*in fieri*) dhe jo një bllok i parafabrikuar konceptesh dhe formash: do të kuptohet më mirë mënyra se si impianti strukturor dhe vetë mjetet artistike të cilat përdoren prej poetit piquen njëkohësisht me premisat e tij teorike, me qartësimin paraprak dhe më pas me zbutjen dhe distancimin nga arsyet e tij polemike. Nga ana tjetër, kjo bindje, kur merret e mirëqenë, nuk ndikon aspak në dëmtimin e bindjes për natyrën unitare të poemës, e cila bazohet në qëndrueshmërinë e një koncepti kryesor dhe të një intuete fillestare që i përputhet atij koncepti dhe e transformon atë, duke e fekonduar në një varg të ndërlukuar dhe koherent figurash; aq sa nga një rrënjë e thellë mbin dhe rritet në rrjedhë të kohës një pemë e jashtëzakonshme, me trunگون dhe degët e saj të shumëllojshme, dhe me gjethet, lulët, frutat, pa hije shartësash, shtresëzimesh dhe mbishtresimesh arbitrare dhe mekanike, përkundrazi, sipas një ecurie zhvillimi tërësisht të natyrshëm dhe organik. Dhe është e vërtetë, më pas, që kjo rrënjë parësore, bërthama themelore e frymëzimit, thellohet në kohë, duke tejkaluar tërësisht çastin fillestar të shkrimit; lind dhe rritet, mund të themi, me përpunimin e të gjithë përvojës biografike të Dantes, me pjekjen e personalitetit të tij intelektual dhe moral, aq sa shenjat e tij të para mund të dallohen qysh në shkrimet e para rinore të poetit, dhe, nga ana tjetër, në fazën më të lartë të zhvillimit të tij, ai tregohet i aftë të rokë dhe të përmbledhë, të ndryshuara dhe të pasuruara, por jo të mohuara në thelbin e tyre jetësor, edhe çastet më të largëta të kohës së shkruar, mbetjet më të zbehta dhe më të brishta të asaj përvoje.

Për sa i përket mënyrës se si lindi *Komedia*, çështja bëhet më e ndërlukuar dhe e vështirë; përderisa, për të rrokur në tërësi domethënien e veprës, që nuk është vetëm poema më e madhe e letërsisë sonë, por me falë të tjera përmbledhja dhe maja më e lartë e gjithë qytetërimit evropian mesjetar, analiza duhet shtrirë shumë më larg se të dhënat e zhveshura biografike, dhe përtej vetë personalitetit individual të shkrimtarit, në kuptimin e rindërtimit tërësor të një pasurie doktrinale filozofike dhe teologjike, juridike dhe politike, përvojash letrare dhe kanonesh retorike, traditash historike dhe kronikash të jetuara, në kuadër të një horizonti që tejkalon gjerësisht kufijtë e një bashkësie të caktuar kombëtare dhe gjuhësore dhe synon të përhapet deri në kufijtë e skajshëm të kristianizmit. Dhe do të duket e natyrshme, sidomos, të vërehet se vepra lindi në një moment fermentimi të skajshëm dhe mrekullie po aq sa dhe ekuilibri të paqëndrueshëm, në prag të një krize që po merrte përpara dhe shumë shpejt do të trandë sistemin e Europës kristiane, duke hedhur poshtë bazat e saj ideale e duke shkatërruar njërin pas tjetër skemat e organizimit të saj politik.

Përgjatë shekullit XIII erudicioni historik e shkencor i mesjetës dhe prodhimitaria e pafund e abstragimit skolastik gjetën shkallën e duhur dhe relativisht të pandryshueshme të përpunimit në një tërësi repertorësh të fryrë, në enciklopedi dhe maja teorike (*summae*), që paraqiten si sistemimet më të mëdha dhe më organike të dijes njerëzore të konceptuara ndonjëherë qysh nga Aristoteli e këndej; por ja, në kufijtë e këtij sistemi dhe nga vetë gjiri i tij lind një problematikë krejt e re, e trazuar dhe fragmentare, që megjithëse respekton drejtimet themelore të konstruktit dhe kriteret metodologjike të kërkimit, madje duke e sforcuar herë-herë qëndrimin e skajshëm racional, ka tendencën, ndonëse në mënyrë të pandërgjegjshme, të gërryjejë harmoninë e strukturës dhe të zhvendosë në mënyrë të rrezikshme rrafshin e analizës.

“Komedia Hyjnore”, kopja e parë e shtypur, 11 prill 1472





Pashko Gjeçi Përkthyesi i "Komedisë Hyjnore"

Filozofia, pa e mohuar haptazi parakushtin teologjik, fillon të pranojë në mënyrë të druajtur autonominë e saj dhe të pranojë në masë gjithnjë e më të gjerë elementet mondane dhe heretike. Koncepti i provanisë (*providenziale*), agostinian, i historisë nuk përputhet plotësisht me llojshmërinë dhe shumësinë e reales, ndërsa historiografia e së zakonshmes u jep hapësirë gjithnjë e më të madhe ngjarjeve, pasioneve, kontrasteve të jetës së përditshme.

Doktrinat politike nuk heqin dorë prej skemës së dy autoriteteve universale dhe debatojnë problemin e raporteve mes Kishës dhe Perandorisë, pikërisht në ato vite merr nga të dyja kahet dhe formulimet e tij më të rrepta dhe sistematike, ndërkaq ajo skemë bëhet gjithnjë e më e përdorshme, më e pasur në përmbajtje të posaçme dhe konkrete; por ndërkaq, krah institucioneve universale në fazë dekadence gjithnjë e në rritje, lindin dhe lulëzojnë format e reja shtetërore, konsolidohen monarkitë kombëtare, komunat e përcara nga luftëra të ashpra të brendshme evoluojnë dalëngadalë në zotërime; dhe ndërkaq, në mosmarëveshjet e përvojës së dhimbshme të përditshme, i hapet shtegu brenda ndërgjegjes kundërvënies mes atyre idealeve të përjetshme të drejtësisë dhe rregullit me realitetin e prishur, të dhimbshëm, kaotik dhe të rrëmuishëm të konflikteve për shkak të interesave dhe pushtetit.

Në organizimin social mbijetojnë ende, dhe do të zgjasin për një kohë të gjatë, strukturat e ngurta ekonomike dhe juridike të sistemit feudal, me idealet karakteristike të jetës fisnike dhe kavalereske si dhe raportet e ngurta të dallimeve dhe varësive mes shtresave të ndryshme, përvëç dy klasave të mëdha të klerit dhe laikëve; por tashmë në këtë kuadër vërehen krisje dhe kontradikta të thella, përvijohen shenjat e një realiteti të ri, me ngjitjen e shpejtë të përfaqësuesve qytetarë dhe borgjezë, ndërsa koncepti i fisnikërisë së trashëguar zhvillohet në atë, shumë më të paqëndrueshëm dhe të hapur, të sjelljes së mirë dhe virtutit individual, dhe marrin vlerë, duke u ndërgjegjësuar për forcën e tyre, vlerat reale të cilat, në brendi të bashkësive të veçanta, krijojnë, jashtë dhe shpesh në konflikt me hierarkitë e njohura teorikisht, modifikimin e paprerë dhe gjithnjë e më të thellë të raporteve të hegjemonisë: inteligjenca, shkathtësia, aftësia ndërmarrëse, fuqia e fitimeve të menjëhershme e të mëdha.

Mbizotëron ende në letërsi prirja doktrinare dhe qëllimi moralist, me një dallim të prerë dhe thujse në kontrast mes elementeve përmbajtjesore dhe atyre formale, të lëndës djesore dhe disiplinave teknike dhe retorike, që asaj lënde i përshtatet nga jashtë nëpërmjet një procesi përputhjeje ilustruese, dekorative dhe ornamentale, shpjeguar nga skema të sakta intelektualiste; por në ato skema vërehet tashmë tharmi i një ndjeshmërie të re, më të zhdërvjellët dhe të shumëllojshme, ndërfuten një shumësi qëndrimesh dhe reagimesh individuale; në sfondin anonim e të palëvizshëm të ideve, të ndjenjave dhe elementeve shprehëse bazë, lulëzojnë situata të caktuara dramatike dhe lirike, lindin figurat e para tërësisht karakterizuese të poetëve të rinj dhe, ndërsa lind një shije më e mprehtë, një mënyrë e re më e ngjeshur e leximit dhe asimilimit të shembujve të poezisë klasike, përpunohet tashmë për përdorim të përditshëm një letërsi gjithnjë e më e pasur dhe e shumëllojshme me natyrë rrëfimtare dhe argëtuese, me një autonomi gjithnjë e në rritje synimesh dhe funksionesh posaçërisht estetike, jo në shërbim të qëllimit thjesht pedagogjik, madje herë-herë diktuar nga një impuls i pastër afektiv dhe nga një synim gati hedonistik.

Dhe ndërkaq, krahas dhe thujse në kontrast me gjuhën e lartë dhe universale të kulturës skolastike, që priret të fiksohet në skema

të ngrira leksikore dhe gramatikore, ngrihet mjeti i ri i idiomave vulgare që dalëngadalë ndërgjegjësohet për dinjitetin dhe forcën e tij shprehëse. Dante merr pjesë, madje është ndër përfaqësuesit dhe krijuesit më të shënuar të këtij çasti të qytetërimit që mbyll mesjetën dhe përgatit Rilindjen: tek ai, asketizmi fetar dhe dija teologjike jetojnë përkrah kuriozitetit të kontrasteve njerëzore dhe të shfaqjeve natyrore; fryma e fundit e së përjetshmes as nuk e shkatërron as nuk e mbyt përballjen e ankthshme me ngjarjet politike; studimi i gjatë i filozofëve skolastikë nuk bie në konflikt me dashurinë e madhe për letërsinë dhe gjuhën e re dhe bashkë me to, me kërkimin e apasionuar dhe imitimin e poetëve klasikë; synimi didaktik dhe koncepti alegorik i poezisë ndërlidhen me besimin e palëkundur dhe të shpallur haptazi tek arti, jo vetëm si mjet dhe disiplinë retorike, por edhe si vlerë e pavarur e së bukurës.

Në mënyrë më të saktë mund të thuhet se në personalitetin e Alighieri-t derdhet, dhe me fjalë të tjera ilustrrohet, me një vetëdije që tek askush nuk gjendet aq e kthjellët dhe dramatike, kriza e hierarkive dhe formave të qytetërimit mesjetar; ndërsa vepra e tij përfaqëson përpjekjen më të madhe dhe më të lartë për ta tejkaluar atë krizë dhe për të ndrequr ekuilibrin tanimë të prishur. Qartësia e palëkundshme mendore dhe etike dhe për pasojë, nevoja e krijimit harmonik dhe koherent, e sistematizimit të qëndrueshëm teorik të të dhënave të përvojës, në vend që ta çojë, siç do të ndodhë për pasuesit e tij më të afërt, në qetësim poetin pas copëtimit dhe prishjes së atyre skemave intelektuale, e shtyn atë të pohojë me besim të vrrullshëm vlerën e tyre të pazëvendësueshme dhe të përhershme. Pa hedhur poshtë dhe pa mohuar asnjë nga elementet e gjalla që po lulëzonin në realitetin e ri intelektual dhe moral, social dhe politik të kohës së tij, ai e përqendron vëmendjen në synimin për t'i rikrijuar ato dhe për t'i futur sërish në unitetin kompleks të sistemit; ai përballet me atë realitet me të gjitha armët e arsytimit dhe të elokuencës, të polemikës, të predikimit dhe satirës, me një besim gjithnjë në shënjestër, por që çdo herë rilind në krenar dhe luftarak, si mundësi dhe nevojë e një sintheze intelektuale, që të propozohet si mjet i pagabueshëm gjykimi dhe udhërrëfyes i sigurt i veprimit njerëzor.

Në këtë kontrast, jo të fjetur, por të mbizotëruar nga një vullnet për siguri, qëndron çasti dramatik gjithnjë i pranishëm në poezinë e Dantes: arsyeja e përhapjes së tij dhe e kërkimit në pafundësinë e ndjenjave tokësore dhe njëkohësisht, arsyeja e strukturës së rreptë që i mbishtresohet asaj lënde të paformë dhe shumëformëshe dhe e përthith dhe e inkadron në fluksin e duhur të një koncepti unitar, ku të gjitha kontradiktat dhe plagët shërohen, justifikohen, sqarohen. Po kështu edhe arti, ndonëse i ndier si asnjëherë më parë në vlerën specifike dhe potencialitetin e tij të pamatë, nuk burgoset në kafazet e lirizmit apo nuk humbet në labirintet e një fantazie argëtuese; nuk e mohon, madje e thekson, cilësinë e tij ngushtësisht funksionale dhe detyrën e tij në kuptimin e gjerë edukativ; derisa të propozohet, në fazën e fundit të kulturës skolastike, kur skemat e përpunuara nga mendimtarët duken tashmë të paafta për natyrën abstraguese të tyre t'i përshtaten shumësisë dhe shqetësimit të përvojës së gjallë, si një mjet i ri më i gjallë dhe më i përshtatshëm për ta paraqitur atë realitet abstrakt, me një aftësi, krahasuar me traktatet e majave teorike (*summae*), shumë më të fuqishme dhe gjerësisht më bindëse, evokuese dhe stimuluese, më drejtpërdrejt efikase dhe të shtrirë pa kufij në hapësirë dhe kohë.

Për ta kuptuar më mirë dhe më thellë gjenezën e një qëndrimi të tillë mendor, që duket se përputhet me nevojën themelore të një situatë të caktuar historike, ka rëndësi, sidomos, nga tërësia e të dhënave të pasigurta dhe të copëzuara të biografisë së poetit dhe të dhënave të tjera të sigurta që mblidhen nga aktiviteti i tij letrar minor, të ruhen dy lloje kryesore faktesh: nga njëra anë, përpjekja vitale, gjithnjë në përputhje me nevojën intime dhe asnjëherë diletanteske, që ai bën për asimilimin e lëndës intelektuale dhe praktike që i ofron realiteti rrethues dhe ku formohet e piqet personaliteti i tij prej njeriu dhe shkrimtari; nga ana tjetër, ekzili që shënon një kthesë vendimtare të ekzistencës së tij dhe përshpejton ritmin e asaj pjekjeje të brendshme, duke përqendruar dhe duke orientuar të gjitha elementet e shpërndara të doktrinës dhe pasionit, të kulturës dhe shijes, në një qëllim të vetëm, koherent dhe të ndërgjegjshëm.

Dhe kjo përpjekje shihet sidomos në përvojën më ngushtësisht të quajtur "letrare", që shkon nga *Vita Nuova*, në ushtrimin e gjatë, të shumëllojshëm dhe në dukje kontradiktor të veprës *Rime*, ku



disiplina formale dhe retorika (që përpunohet në kontakt me frytet më të gjalla dhe normat më të rafinuara të shijes bashkëkohore, nga ajo provensale e guitonianëve që pak shpërfaqet së jashtmi te pasuria krijuese e "trobar clus" e Arnaldo-s, nga psikologjizmi i lartë i "stil novo-s" te saktësia e lirikës alegorike dhe doktrinare, nga gjallëria qytetare e shkëmbimit polemik të soneteve (*tenzone*) me Forese-n tek elokuenca e këngës morale dhe politike) dhe zhvillimi paralel i një çështjeje vetjake (dashuri, meditime, vuajtje, inate) i përshtaten plotësisht zgjerimit të vazhdueshëm të ndjeshmërisë e të mjeteve artistike të përdorura për t'i shprehur; kështu që në asnjë çast ushtrimi formal nuk bëhet qëllim në vetvete dhe kudo shndërrohet në humanizëm shtesë, në të kundërt, çdo modifikim dhe fitim i përvojës intelektuale dhe praktike përvijohet nga një potencialitet në rritje i burimeve instrumentale, të destinuara të gjitha për t'u shfrytëzuar në orkestrimin madhështor e shumë të artikuluar stilistik të poemës madhore.

Nëpërmjet këtij shtegu, historia e dashurisë së Betariçes dhe temat e prishjes morale dhe të ndregjes të trajtuara në "letërsinë" rinore me synim paraqitjen e parabolës së një ngjarjeje ekzemplare, qysh atëherë "tregues" të mënyrës se si shkrimtari përfaqon me seriozitet jo të zakonshëm format e një stili dhe shkolle, do të arrijnë të ngrihen te *Komedia* në një domethënie shumë të lartë simbolike; dhe në gjuhën e poemës mund t'i gjejmë njëherë krah tjetër, çdo herë të orientuara në kapacitetin e tyre të saktë funksional, lirizmin e himneve dhe ethet pasionale të këngës së tri grave, rimat e ashpra të poezive për gruan-gur, strukturën e ngjeshur të silogjizmit në vargjet doktrinare dhe dhunën kolerike të këngës kundër koprracisë, realizmin e theksuar satirik të shkëmbimit polemik të soneteve (*tenzone*) me Forese-n dhe madje, deri disa lloje tonesh bisedimore e gati me shaka të disa soneteve dhe baladave minore.

Akoma, në mënyrë tjetër dhe ndoshta më të qenësishme, përpjekja e Dantes duhet theksuar, në fazën e pjekurisë së përvojës së tij, në qëndrimin ndaj asimilimit dhe përpunimit të rezultateve më të mëdha të mendimit dhe erudicionit skolastik, asnjëherë me frymën e atij që kënaqet të spekulojë në mënyrë abstrakte, por gjithnjë me qëndrimin e atij që dëshiron ta zbatojë dijen e marrë në një përvojë konkrete jete dhe që ofrohet të penetrojë thellë në gjykimin e një situatë historike, të një tërësie të caktuar problemesh, duke i inkadruar dhe duke i vënë në skema që përfshijnë vizionin e përgjithshëm të realitetit. Nëse në *Convivio* shkenca, megjithëse e zhytur në kostumin pompoz mesjetar dhe e rënduar nga metoda ngushtësisht deduktive e të argumentuarit, duket, të paktën për sa i përket qëllimit, se mirëpret me padurim konkretësinë dhe se përfshihet nga pasioni; dhe se toni i ligjërimit merr domethënie prej publikut të cilit i drejtohet (që nuk është më ai i klerikëve dhe dijetarëve, por i atyre që grindjet politike dhe jeta publike i kanë lënë larg shkollave) si dhe prej cilësisë së autorit (i cili nuk është, ai vetë, një profesionist i ditur, por, siç e shpall edhe vetë me krenari, një autodidakt); nga ku rrjedhin mënyrat e hapura dhe të rrëmbyeshme të parashtrimit, që kapërcejnë rreptësinë e ligjërimit ngushtësisht skolastik; në traktatet në latinisht, pastaj, shkenca, konkluzionet themelore dhe metodën e së cilës shkrimtari i ka përfutur tashmë në mënyrë të plotë dhe të rrjedhshme, duket se vihet e gjitha në zbatim të zgjidhjes së problemeve që kanë shije të fortë aktualiteti: në *De vulgari eloquentia*, traktati i përvojës lirike në një gjuhë vulgare, formulim teorik që vetëzhvillohet vazhdimisht në një gjykim historik dhe në një kritikë militante; në *Monarchia*, doktrina e dy pushteteve dhe pohimi i autonomisë tokësore të Perandorisë, kërkoi të zgjidhë konfliktet dhe të shërojë silitjet e një kronike vuajtjesh dhe turbullire, duke shpaguar kështu ankthin e përhapur për drejtësi, rregull dhe paqe.

Pikërisht këtu, ku herë-herë pasioni i njeriut gris nëpërmjet vajesh tronditëse strofën përbërëse të shkrimeve skolastike ("O

qenie njerëzore, sa stuhi e fatkeqësi, sa dështime duhet të të kenë marrë përpara, kur i shndërruar në bishë me shumë krena, ke qenë i shtrënguar të ndjekësh shumë synime”//*O genius humanum, quantis procellis atque iacturis quantisque naufragiis agitari te necesse est, dum, belua multorum capitum factum, in diversa conaris!*), mund të perceptohet si momenti virtual i kalimit nga arsyetimi në mit, baza primare e një mesazhi poetik, ku motivi bazë i thurjes abstraguese del në pah si mjet dhe guidë e gjykimit praktik dhe të vepruarit konkret.

Se sa ka ndikuar ekzili për ta përvijuar në përmasën e vërtetë dhe për të orientuar në zgjedhje të caktuara veprimin e Dantes si dhe prirjen e tij të përgjithshme për gjykim të pasionuar ndaj fakteve etiko-politike, ekzil që e goditi papritmas në muajt e parë të vitit 1302 dhe e rëndoi me ankth të gjithë periudhën e fundit të jetës së tij, duke e zvarritur drejt një jetese endacake e të poshtëruar, në një alternativë torturuese ankthesh, shpresash, entuziazmesh, zhgënjimesh, është gjë që dihet dhe nuk ka nevojë të theksohet.

Ekzili i dha personalitetit të tij vulën e zemërimit dhe melankolisë, pezmatimit dhe ashpërsisë, me rrahje të lehta dhe të zjarrra për mallimi nostalgjik, që e karakterizon ende në mendjen e shumicës; ekzili e thelloi në një bindje të patundur konceptin e tij të historisë dhe gjykimin e tij për ngjarjet e bashkëkohësisë. Prej meditim për shkaqet e shkatërrimit të tij personal, pasi u rrënuar besimi fillestar në aftësitë e institucioneve vendore për të siguruar një ritëm të qetë dhe të rregullt jete, pasi evidentoi në ambicien e shfrenuar të shtresave në konflikt, në zilinë e ndërsjellë dhe në pangopshmërinë për pushtet dhe pasuri, arsyet e luftërave civile dhe të paqëndrueshmërisë së ligjeve, morën shkas bindjet pesimiste për situatën historike, që nga anarkia e bashkësisë qytetare “civitas” zgjerohet pak nga pak derisa përfshin tragjedinë e Italisë dhe më pas atë të kristianizmit mbarë: një kuadër i pafund, dëshpërues, grabitjesh, pasionesh të shfrenuara, padrejtësish, degradimesh, dhune të shëmtuar, nga i cili duket se është fshirë tanimë çdo shenjë e vazhdimësisë hyjnore dhe duket se janë larguar të fyer “sytë e drejtë” të Zotit. Vetëm se, nga përmasa e një konsiderate të tillë pesimiste, duhet medoemos të buronte, në vetëdijen kristiane të shkrimtarit, besimi në një zgjidhje të plotë dhe afatgjatë të kontradiktave historike. Por vetëm kush e ka rrokur përmasën dhe thellësinë e asaj gjendjeje shpirtërore mund të vlerësojë plotësisht intensitetin e ndjenjës që aty kapet fort, kundër anarkisë dhe kontradiktave të realitetit, për të ruajtur të paprekura konceptet ideale të drejtësisë dhe paqes kristiane; madhështinë e mendjes, që përpiqet të kuptojë atë përshtjellim, t’ia zbulojë arsyet dhe t’ia përshtatë zgjidhjet, duke e krahasuar me modelin hyjnor, me vendosmërinë e përkryer të një sistemi ideologjik madhështor.

Komedia lind nga ky takim mes një përvoje të dhimbshme dhe një bindjeje të fuqishme, nga kjo fitore dramatike e një besimi që evidentohet dhe lartësohet në përplasjen e përditshme me realitetin që e kundërshton dhe duket se e hedh poshtë; dhe ajo shpreh njëkohësisht dhe në mënyrë alternative atë ankth dhe atë besim, zemërimin e madh dhe agoninë morale të poetit.

Atyre që e kanë kuptuar mirë gjenezën e krijimit të poemës, që u përpoqëm të përshkruajmë, u del si e pavend dhe në përgjithësi arbitrare çështja aq shumë e përhapur në kritikën danteske të shekullit tonë, e unitetit poetik të librit dhe e marrëdhënieve dalluese apo mospërputhjes mes strukturës dhe poezisë, skemës doktrinare dhe lulëzimit shpërthyes të intervaleve fantastike. Struktura, përmbajtja poetike, teknika narrative dhe dramatike e trajtesave lindin, në fakt, nga e njëjta pikë dhe kushtëzojnë njëra-tjetrën. Por nevoja për të individualizuar elementin specifikisht më



poetik të veprës mund të kishte arsyen e saj të ekzistencës diktuar nga nevoja për të sqaruar gjykimin e turbullt të lexuesve të parë, të cilët e vinin theksin në vlerat morale dhe në gjerësinë e objektit abstrakt, dhe kohë më vonë për të reaguar ndaj kufizimeve dhe zhvlerësimeve të letrarëve, të prirë për t’ia mohuar një ngrehinë dijeje si jashtë kohe dhe pa shije një vlerë fantastike autonome dhe cilësimin si poezi e vërtetë.

Në këtë kuptim ajo është e gjallë tashmë qysh në kritikën e fundshekullit XVI: te Salviati, që nënvizon “veçantinë” dhe “energjinë” e gjuhës së Dantes; te Borghini, që dëshiron që të vlerësohet në fund të fundit “si poet, dhe jo si filozof apo si teolog”; rikthehet në fillim të shekullit XVII në faqet e Alessandro Guarini-t, që ngulmon në tonet e ashpra, por heroike, në mënyrën kundërthënëse gjithnjë në lëvizje dhe që u përshtatet në një mijë mënyra nevojave gjithnjë në ndryshim të situatës dramatike dhe epike të poemës, ku zhvillohet një melodi me hope, por e fuqishme; vërehet deri dhe në përpjekjet e letrarëve të shekullit XVIII, për të nxjerrë nga ajo përzjerje “suxhuku” (*salmigondis*), nga ai “mishmash grotesk” (*guazzabuglio grottesco*), një antologji, megjithëse të dobët, të fragmenteve që nuk ofendojnë krejt ashpër shijen e tyre të përcaktuar racionaliste; por sidomos shpërfaqet, qysh nga Vico te De Sanctis, në parabolën e flaktë të kritikës romantike, si reaksion nga njëra anë ndaj interpretimit intelektualist të *Komedisë* dhe nga ana tjetër, në caqet e një edukimi humanist, si një ngadhënjim i gjenit poetik dhe i sublimes, që thyen rregullat e pedantëve.

Edhe në monografinë e Croce-s një nevojë e tillë ruante deri diku një vlerë aktualiteti, si reagim ndaj admirimit konfuz të

dantizmit zyrtar dhe ndaj kërkimeve të mërzitshme të alegoristëve ekstremë; veçse te Croce, pikërisht kjo rrymë kritike, në çastin kur shfaqej me koherencë absolute dhe ndërgjegje totale, përfundonte duke u ngurtësuar në një gjetje skematike dhe tërësisht të huaj kundrejt kontekstit specifik të veprës që jepej për t’u ilustruar, duke vendosur atë distancë të rreptë mes elementeve abstrakte dhe atyre fantastike, ku këto të fundit, të izoluar në cilësinë e tyre si fragmente të këndshme, shfuqizojnë apo dobësojnë substancën e tyre konkrete prej poezie. Në të vërtetë, Croce rrezonte, si të panevojshëm dhe të papërshtatshëm për konceptin e tij të artit, pikërisht momentin më domethënës të asaj kritike danteske romantike nga e cila merrte shkas polemika e tij: ajo kritikë nuk kishte hequr kurrë dorë nga interpretimi i pandarë i *Komedisë*, kishte kërkuar gjithnjë t’i vlerësonte jo në rrafsh kundërvënies, por lidhjeje të ndërsjellë dialektike, raportet midis strukturës dhe poezisë, dhe kishte ngulmuar mbi nevojën për ta lexuar “në mënyrë historike” poemën, në kuadër të një kulture dhe ndjeshmërie qartësisht të përcaktuar: nga Vico, që e lidhte “gjeninë e zemëruar” të Dantes me “historinë e kohëve barbare të Italisë”, te Foscolo, që përpiqej të rindëronte dhe të dokumentonte sfondin historik të librit për të përfutur një gjykim të saktë estetik; nga Hegel-i, i cili e gjente cilësinë e veçantë të poezisë së Dantes pikërisht në aftësinë e tij për ta “zhytur botën e gjallë të veprimeve dhe pësimeve, të veprave dhe fateve individuale, në sfondin e një realiteti të pandryshueshëm”, te De Sanctis, i cili e quante *Komedinë* “poemën e universit, gjeometrinë e përvetshme logjike të krijimit të mishëruar në tri botët kristiane, qyteti i Zotit, brenda të cilit pasqyrohet qyteti i njeriut në të gjithë realitetin e tij të aksh vendi dhe aksh kohe, njëra trajtë shembullore dhe gjykatëse e tjetrës”.

Sa e dëmshme qe humbja e vëmendjes ndaj asaj çka është përjetësisht e vlefshme në këto pohime të kritikëve romantikë për perceptimin e drejtë të veprës danteske mund të shihet lehtë sot në shkrimet e atyre pasuesve të mbijetuar të Croce-s, që përgjigjet librit dhe në çdo faqe të tij janë në kërkim, prej magjistari të shëmtuar, të një poezie të pastër që nuk gjendet dhe në mënyrë të bezdisshme dallojnë pjesët poetike dhe jopoetike, duke izoluar episode dhe grupe tercijnash dhe ka gjasë hemistikësh të veçantë. Gjë për të cilën do të ishte e tepërt të harxhohej këtu tepër fjalë. Por mund të thuhet se, duke pasur parasysh ato formula, ne, përkundrazi, duam të reagojmë edhe kundër qëndrimit të përhapur sot ndër dantistë që e vënë theksin në unitetin abstrakt të veprës, në trillimin strukturor, në elementet simbolike dhe alegorike, duke mbyllur sytë para asaj që është poezia e *Komedisë*, lëndës energjike, të ndryshueshme, të shqetësuar dhe dramatike njerëzore, që jeton dhe pulson në skemat e një skeleti të qëndrueshëm religjioz.

Sipas nesh, duhen mbajtur të palëvizshme të dyja ekstremet e marrëdhënies dialektike; nuk duhet harruar kurrë se figurat që krijon Dante janë gjithnjë në funksion të një koncepti moral, se theksimi i personazheve dhe fuqia e situatave dalin në pah gjithmonë nga projektimi i tyre në një sfond realiteti të pandryshueshëm, që i përshkon dhe i përplotëson; por duhet edhe të mos mbyllen sytë paralëndës së fuqishme njerëzore që derdhet në ato krijime, dhe se si fantazia godet kudo me të njëjtën fuqi realiste, me të njëjtën siguri vërtetësie dy rrafshet paralele të simbolit dhe kronikës, të së tashmes dhe së përjetshmes. Pa dyshim se ai që izolol personazhet e veçanta të poemës, Francesca apo Farinata, Ulisse apo Pier della Vigna, Ugolino apo Cacciaguida, Brunetto apo Forese, e kështu me radhë, për të nxjerrë në pah veçanërisht motivet lirike o patetike, elegjiake apo dramatike të situatave të ndryshme, duke abstraguar nga struktura ku gjenden, jo vetëm u qaset interpretimeve arbitrare dhe në kundërshti me kushtet historike të kësaj poezie, por edhe gjymton dhe varfëron cilësinë, dhe bëhet i paaftë të kuptojë natyrën e frymëzimit dantesk, që nuk është kurrë transkriptim i një gjendjeje shpirtërore, por gjithnjë gjedhe dramatike dhe dinamike e një problematike të ndërlikuar dhe një gjendjeje morale. Por është e vërtetë se i largohet po aq plotësisë kuptimore të këtij frymëzimi edhe ai që e shpjegon të gjithën sipas simbolesh të thata dhe lejon t’i rrëshqasë lëvizja dramatike falë së cilës poeti mbërrin plotësinë e domethënies etike të pasqyrimin, lëndën e dendur dhe të ngjeshur psikologjike që i nxit gjithnjë e më tepër “shembujt” e ringjallur, në dakordësi të qëndrueshme mes bazës strukturore dhe fantazisë së frytshme.

Detyrë e një kritike danteske moderne dhe të mprehtë duket të jetë pikërisht ajo e dallimit rast pas rasti se si buron çasti më i lartë poetik dhe si përthith prej arsyeve të strukturës dhe transmeton prej saj pikë për pikë ngacmimet dhe sugjerimet morale në figura e situata të ndjeshme dhe të artikuluar nga ana njerëzore. Kjo sjell, natyrisht, një përcaktim më të saktë të mënyrave artistike nëpërmjet të cilave frymëzimi dantesk përvijohet, një studim të imët të njësive dhe konstanteve shprehëse nëpërmjet të cilave përmbushet ajo që Auerbach, me formulë të thukët, e quan “konceptim i figurshëm” i mesjetës, d.m.th realizmi i përveçëm poetik i Aligieri-t. Në veçanti, do të ngelet për t’u parë se si, me modifikimin në kohë të qëndrimeve sentimentale të shkrimtarit (në një hark që vetëm pjesërisht identifikohet me zhvendosjen e situatave strukturore), ndryshon edhe cilësia e artit, që bëhet hap mbas hapi më i guximshëm dhe i hollë, duke përbrendësuar, me procedime akoma më të holla dhe me cilësinë e një dijeje teknike që duket se përsos, me të njëjtin ritëm të vështirësive dhe paqartësive, ndonjëherë dhe të lëndës, mënyrat fuqimisht dramatike, por edhe më periferike dhe të thjeshta, të kantikës së parë. Synimi ideal i një kritike të tillë do të jetë të zvogëlojë në maksimum hendekun, që në vitet e fundit është ngushtuar ndjeshëm, mes cilësisë së veçantë të një poezie lindur në kushte historike të shkuara dhe aftësisë së asimilimit të ndjeshmërisë estetike të sotme.

Përktheu nga italishtja **BLERINA SUTA**



Përkthimi i “Komedisë Hyjnore” të Dantes midis Luigi Lorecchios dhe Meritan Spahisë

Nga Stefan Çapaliku

Që nga shekulli i 15-të, Komedia Hyjnore, e shkruar nga Dante Alighieri midis 1304-7 dhe 1321, është përkthyer në një numër të madh gjuhësh të gjalla si dhe në disa gjuhë të vdekura. Përkthimi i parë u realizua më 1417 në gjuhën latine dhe që prej asaj dite përkthyesit nuk kanë reshtur duke u marrë dhe duke përballuar atë sfidë. Sipas përmbledhjes “Dante nel mondo”, kryer nga Komuna e Ravenës më 2016, ka 58 përkthime të plota të Komedisë në gjuhët Evropiane, Aziatike, Afrikane dhe të Amerikës së Jugut

Në shqip ekzistojnë dy përkthime të plota, të dyja të gjysmës së dytë të shekullit XX dhe të dyja në gegnisht. Vetëm dy përkthime të pjesshme ekzistojnë deri tani në shqipen standarte.

Por gjithsesi duhet thënë që në krye të herës se shqiptarët janë takuar vonë me Danten. Përkthimi i parë nga Komedia Hyjnore duket se është bërë në arbërisht nga Luigi Lorecchio, një pasues i denjë i Jeronim de Radës, në vitin 1895.

Në gegnisht për herë të parë Dante shfaqet në vitin 1900. Por edhe ky përkthim do botohet aso kohe jashtë

Shqipërie. Është fjala për përkthimin e një pjese të Këngës V, të Paolos dhe Françeskës, që do botohet në revistën e arbëreshëve të Italisë, “La Nazione Albanese”, me autor një farë Sokol Baazi (Baci), për të cilin Ernest Koliqi thotë se duhet të jetë i biri i bajraktarit të Grudës, shkolluar në Romë.

Ndërkaq në territorin shqiptar botimi i parë i vargjeve të Dantes u bë nga i lumi Vinçens Prennushi, i cili botoi më 1924 këngën XI të Parajsës, pikërisht atë ku poeti takon Shën Françeskun.

Këngë të veçanta të Komedisë Hyjnore janë sjellë gjithashtu në shqip përgjatë viteve nga Ernest Koliqi, në antologjinë e tij, “Poetët e mdhej t’Italis”, botuar në vitin 1933, si dhe nga Nikollë Dakaj, i cili pjesë të Ferrit i botoi nën pseudonimin Basho Jona.

Në toskërisht Dante u shfaq për herë të parë në vitin 1937 nëpërmjet përkthimit të Kristo Floqit, i cili botoi në Shkodër, te revista e jezuitëve “Leka”, këngën XXXIII, atë të kont Ugolinit.

Dhe më në fund u desh të vinte viti 1960 që shqiptarët të kishin në dorë Danten e plotë, përkthyer në mënyrë integrale nga Pashko Gjeçi. Po ky variant,

me redaktimin e poetit Ali Podrimja u botua edhe në Prishtinë, më 1981 nga “Rilindja”.

Përkthimi i dytë integral i Dantes u bë nga Mark Ndoja. Marku kishte botuar për herë të parë në vitin 1937 dy këngë të Purgatorit, por më vonë fati i jetës së tij kishte qenë po kaq dantesk sa edhe i Pashkut. Kësisoj janë gjasat që Pashku dhe Marku të mos kenë qenë në dijeni të kësaj pune paralele që kishin ndërmarrë. Gjithsesi, Marku e përfundoi punën e vet më 1967, por për herë të parë ai përkthim u botua pas vdekjes, më 1998.

I këtyre kohëve duhet të ketë qenë edhe përkthimi ad literam që Hektor Shënepremte (1921-1997) i kishte bërë “Ferrit”. Ky përkthim pa dritën e botimit shumë kohë më vonë vdekjes së përkthyesit, më 2018.

Në shekullin tonë pra gjithashtu u shfaq ndër librari edhe përkthimi i Çezar Kurtit, i cili e botoi “Ferrin” e vet në vitin 2000.

Kjo qe pak a shumë panorama digresive para së cilës u shfaq një poet shkodran, Meritan Spahija, i cili, i pakënaqur nga ç’kishte lexuar nëpër përkthimet shqiptare të Dantes, i hyri punës për përkthimin e “Ferrit”, që do ta përfundojë më 2016.

Meritan Spahija, i lindur më 1967, ia nisi kësaj pune mbasiqë kishte mprehur shprehitë e tij si artist pamor, si filolog, si njohës i Biblës dhe sidomos si shkrimtar, me botimet e librave me tregime “Luleshtrydhet” 2002; Vegimet e fundit, tregime, 2010; Monolog me vetveten, 2016; Enea iku i fundit, 2017; si dhe romanet: “Vegimet e një dite me shi” 2004, “Alegoria e një historie të vërtetë” 2007.

Puna e tij krahas me përkthimet vazhdon në mënyrë intensive edhe me komentet, duke lavruar kësaj edhe gegnishten e kohës sonë, krahas asaj klasikigjante. Ai gjendet për momentin në mes të “Purgatorit” të vet, i vendosur si kurrë më parë për ta shijuar edhe “Parajsën” eternale.

Aksioni njerëzor i këtyre njerëzve, shumica e të cilëve me jetë të vështira, të marginalizuara dhe të rrethuara prej mosmijnjohjes, na bën që t’i çmojmë edhe më shumë se kurrë në këtë shtatëqind vjetor të vdekjes së Dante Aligierit.

FRAGMENTE NGA PËRKTHIMI I MERITAN SPAHISË

Takimi me Virgjilin Kanga I

66 Mejherë sa e pashë në atë zallishte t’shkretë,
«Ki mshirë për mue», - kam thirrë, tue e përbë, -
«në qofsh ti shpirt apo njeri i vërtetë!»

81

69 M’u gjegj: «Nuk jam njeri, njeri kam lé,
e prindëve të mi lombardë u thonë,
Mantovën patën që të dy atdhë.

84

72 Nën Julin kam pas lindë, edhe se vonë,
në Romë, në kohë t’Augustit kam jetue,
kur n’zota t’rremë ish vù besimi jonë.

87

75 Poet kam qenë dhe atij i kam këndue,
t’Ankizit bir, ardhë Troje e t’gjatë lundrimi,
si Ilioni madhështor qe krejt shkumbue.

78 Po ti, përse po kthen n’këtë vend trishtimi?
Përse s’i ngjitesh t’naltit rrugëtim,
që asht arsye për çfarëdolloj gëzimi?»

45

81 «A thue je ti Virgjili, ai burim,
që fjalët të vërshojnë si lum n’pranverë?»
- i thashë e kryet kam ulë me përnderim.

48

84 «O ti, i mbarë poetve dritë dhe nder,
shpërblema gjithë atë dashuni t’pamatë,
që të studioj krejt veprën tande t’vlerë.

51

87 Je mjeshtri, shembull n’timen jetë përgjatë,
ti je i vetmi t’cilit e kam nuanë
të bukrin stil, që m’solli aq lëvdatë.

54

Takimi me Brunet Latinin Kanga XV

57

24 Kështu të ngranë me sy ksaj grumbullí,
qeshë njoftë nga një që kindit më ka ngrehë,
e krejt habitë më tha: «Oh, ç’mrekullí!».

60

27 E unë, n’sa krahun meje sapo ndehë,
i ngula sytë n’fityrën përvëlue,
që djegia mundësi t’mos kish me fshehë,
ato tipare në kujtesë fikse;

63

30 e lehtë me dorë tu’ u ba përkëdhelim,
«Oh, sër Bruneti», - i thashë, - «dhe ju këtu?!»

66

...

«Po t’bahej çfarë do kisha me dëshruë»,
- përmallë jam gjegjë, - «endë s’do ishit shqitë
nga bota e t’gjallve dhe asaj mërgue.

Se n’mendje ngulë më asht, e kjo m’sfilitë,
i shtrejti dhe atnori shembëllim,
kur s’gjalli n’botë, çdo çast, orë e përditë,

më msonit si njeriu t’gjejë përjetsim:
e për sa t’mundem, sa të jem i gjallë,
do gjejë kjo n’fjalë e mia pasqyrim.

Vdekja e kontit Ugolin e bij nga uria Kanga XXXII

Të tanë qemë zgjue dhe koha po kalonte
kur na ofronin vaktin zakonisht,
prandaj secili andrrën po frigonte;

kur ndjeva të gozhdonin mizorisht,
atë derë të kullës s’mbrapshtë, dy sytë at’herë,
i shtangun n’bijtë fiksova ngultësisht.

Nuk qava, por ba gur e n’fityrë i terë;
të përvajue kam ndie t’Anselmit zâ:
‘O atë, çfarë ke, që sytë s’na i heq një herë?’

Prandaj i mbajta lotët, s’tashë kurrëgjâ,
gjithë ditës s’gjatë e natës në vazhdim,
dersa të dalë një tjetër diell kam pa.

Por fill sa rrezja bani aty përshkim,
nqelinë e kobshme, e qartazi dallova
në katër ftyrat përngjasimin tim,

nga dhimbshunia duert me dhambë kafshova;
dhe tue mendue se uria po më pret,
u çuen e m’tanë, n’sa ballas u qëndrova:
‘O atë, shumë herë ma pak trishtim na qet
nëse me ne ushqehesh: me këtë mish
ti na ke veshë e i gjithi ty t’përket’.

Kam heshtë që pezmin mos t’ua baj dyfish;
s’u ndjemë atë ditë, as n’tjetrën, për kohë t’gjatë;
oh, hapu tokë!, kush vallë duron kësish?



In memoriam

ADAM ZAGAJEWSKI

Poeti polak Adam Zagajewski, i ardhur në gjuhën shqipe me vëllimin “Qyteti ku dua të jetoj” përkthyer nga Bardhyl Londo (Botimet *Aleph*), ditën e diel me datë 21 mars ndërroi jetë në moshën 75 vjeçare në Krakov, Poloni. I njohur më së shumti për poezitë e tij, ai ishte edhe një eseist me sens të hollë e të rrallë humori.


Shkruante në disa gjuhë si anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe sigurisht, në gjuhën e tij amtare, polonisht.

Para disa kohësh Henryk Wzniakowski, drejtues i shtëpisë botuese *Zank* në Poloni e përshkroi Zagajewskin si një njeri me inteligjencë, humor i cili ishte “gjithashtu i turpshëm, njëlloj si e ndjera Wislawa Szymborska, poete nga Krakova që më 1996 fitoi çmimin *Nobel* në letërsi.

Zagajewski e ndante kohën mes Polonisë dhe ShBA ku ligjëronte letërsinë në Universitetin e Çikagos. Ai qe gjithashtu i njohur si “poeti i 9/11”, data kur ndodhi sulmi terrorist në New York. Kjo, pasi *The New York Times* përzgjedhi poezinë e tij *Provo ta himnizosh botën e gjymtuar* në faqen e fundit të numrit special kushtuar sulmit.

Në essenë “Elegjiaku – Për poezinë e Adam Zagajewski” përkthyer nga Gentian Çoçoli, Derec Walcot mes të tjerash shkruan: *Adam Zagajewski nuk është thjesht një poet, ai është metri i padëgjueshëm i frymëmarrjes tonë dhe të botës natyrore.*

Në vijim mund të lexoni disa nga poezië e tij, marrë nga vëllimi i cituar qysh në krye, përkthyer nga Bardhyl Londo.



ADAM ZAGAJEWSKI

Provo ta himnizosh botën e gjymtuar

Provo të himnizosh botën e gjymtuar.
Kujto ditët e gjata të qershorit,
luleshtrydhet e egra, piklat e verës roze.
Hithrat që vazhdimisht mbulojnë
shtëpitë-ferma të të mërguarve.
Ti duhet ta himnizosh botën e gjymtuar.
Ti shikoje jahtet dhe anijet luksoze;
një udhëtim të gjatë do të bënte njëri prej tyre,
harresa e kripur i priste të tjerët.
Ti ke parë refugjatët që nuk mbërrijnë askund,
këngën e gëzuar të xhelatëve e ke dëgjuar.
Ti duhet ta himnizosh botën e gjymtuar.
Kujto çastet kur ishim bashkë
në një dhomë të bardhë me një perde që
valëvitej.
Kthehu me mend në koncertin ku jehonte muz-
ika.
Ti mblidhje lende në parkun vjeshtor
dhe gjethet mbulonin plasaritjet e tokës.
Himnizoje botën e gjymtuar
dhe puplën ngjyrë gri që humbi një cërre,
dhe dritën fisnike që arratiset, zhduket
dhe kthehet prapë.

Unë shëtisja në qytetin mesjetar

Unë shëtisja në qytetin mesjetar
në mbrëmje ose në agim.
Isha shumë i ri ose tepër i vjetër.
Nuk kisha orë
apo kalendar, vetëm gjaku im kryeneç
maste hapësirën e pafund.
Unë mund ta filloja jetën, timen
apo jo timen, gjithsesi,
gjithçka dukej e lehtë,
dritaret e apartamenteve ishin pjesërisht hapur,
fate të tjerë ishin krejtësisht hapur.
Ishte pranverë apo verë e hershme,
mure të ngrohta,
ajër i butë si një lëkurë portokalli;
isha shumë i ri ose shumë i vjetër,
unë mund të zgjidhja, unë mund të jetoja.

Në maj

Ndërsa shëtisja në agim pyllit
në maj, unë vazhdoja të pyesja ku jeni ju shpirta
të të vdekurve. Ku jeni ju rioshë

që keni humbur, ku jeni ju
të shndërruar me gjithsej?
Qetësia solemne mbretëronte në pyll,
dhe unë dëgjoja ëndrrat e gjelbra të gjetheve,
dëgjoja ëndrrën e lëvores prej së cilës
lundra, anije dhe vela do të ngrihen.
Pastaj, ngadalë, u bashkuan zogjtë,
gardalinat, mullibardhat, mëllenjat,
në ballkonet e degëve, secili prej tyre fliste
ndryshe, me zërin e tij, pa pyetur për asgjë,
pa fije hidhërimi apo pendimi.
Dhe unë e kuptova: ju jeni tek kënga,
të pakapshëm si muzika, indiferentë si
notat muzikore, larg prej nesh
sa ç’jemi ne nga vetja.

Shpirti

Ne e dimë nuk na lejohet të përdorim emrin
tënd.

Ne e dimë ti je i padeshifrueshëm,
pa gjak, i brishtë dhe i dyshuar
për shkelje misterioze si një fëmijë.
Ne e dimë ti tani nuk lejohesh të jetosh
në muzikë ose tek pemët në perëndim të diellit.
Ne e dimë ose të paktën na kanë thënë
se ti nuk ekziston fare, askund.
Po ne ende dëgjojmë zërin tënd të këputur
në një jehonë, në një ankesë, në letrat që marrim
nga Antigona në shkretëtirën greke.

Guackë

Natën murgjit këndonin butë
dhe shkulmet e erës ngrinin
degët e bredhit si krahë.
Nuk i kam vizituar kurrë qytetet antike,
asnjëherë nuk kam qenë në Tebë
ose në Delfi, dhe unë nuk e di
çfarë iu kanë thënë orakujt udhëtarëve.
Bora mbushte rrugët dhe kanionet,
dhe sorrat robëzeza në heshtje
ndiqnin gjurmët e dhelprës.
Unë besoja në shenjat e pakapshme,
në rrënojat hijembushur, gjarpërinjtë e ujit,
burimet malorë, zogjtë profetikë.
Blinjtë lulëzonin si nuse,
por fruti i tyre ishte i vogël dhe i hidhur.
Mençuria nuk mund të gjendet
në muzikë ose pikturat e bukura,
në bëmat e mëdha, në guximin,
madje dhe në dashuri,
por veç në gjithë këto gjëra,
në tokë dhe ajër, në dhembje dhe heshtje.
Një vjershë mund të mbajë jehonën e rrufesë,
si guacka e prekur nga Orfeu
para se të zhdukej. Koha na rrëmben jetën
dhe lë për ne kujtesën, arin flakërues,
blozën me thëngjij.

Blinjtë

Kaq shumë ëmbëlsi
sa qyteti është nën anestezi;
një djalosh i dobët, aq sa
mezi lëshon pak hije mbi tokë,
dhe një qen,
edhe unë, ushtar i një lufte të padukshme,
dhe një lumë që dua.
Blinjtë lulëzojnë.

Vajza e vogël e Vermerit

Vajza e vogël e Vermerit, tashmë e famshme,
m’i ka ngulur sytë. Një perlë po më vështron.
Buzët e vajzës së vogël të Vermerit
janë të kuqe, të lagështa dhe të shndëritshme.

Oh, vajzë e vogël e Vermerit, oh perlë,
me turbanin blu: ti je e gjitha prej drite
dhe unë jam endur prej hijes.
Drita e shikon nga sipër hijen
me vetpërmbajtje, ndoshta me mëshirë.

Haruki Murakami

“Realiteti A” dhe “Realiteti B”!

Cilat ishin ngjarjet që ndryshuan shpirtin e shekullit të 20-të nga ai i 21? Në perspektivën globale, ato ishin para së gjithash, shkatërrimi i Murit të Berlinit dhe së dyti, shkatërrimi i kullave të Qendrës Botërore të Tregtisë, më 11 shtator 2001. Akti i parë ishte i mbushur me shpresa të ndritshme, ndërsa ai që e pasoi, ishte një tragjedi e madhe. Bindja, se “bota do të jetë më e mirë”, u vra plotësisht, nga fatkeqësia e 11 shtatorit. Këto akte shkatërruese, që vepruan mes dy skajesh kohore, në secilin rast, duket se kanë kombinuar një goditje të vetme, transformimin rrënjësor të mentalitetit njerëzor.

Gjatë tri dekadave të fundit, unë kam shkruar letërsi artistike, që varion nga tregimet, deri te romanet. Historia ka qenë gjithmonë koncepteti themelor i njeriut. Edhe pse çdo histori është unike, ajo kryesisht funksionon si diçka që ndahet me të tjerët. Kjo, saktësisht, i jep një historie kuptim. Tregimet ndryshojnë formë lirisht, duke thithur ajrin e moshës. Historitë janë të ndryshme, kur bëhet fjalë për mënyrën e prezantimit që mbartin në vetvete. Ashtu si stilistët e modës, ne shkrimtarët, i veshim historitë me fjalë të përshtatshme dhe ato ndryshojnë formë nga dita në ditë. Parë nga një perspektivë profesionale, duket se ndërfaqja midis nesh e tregimeve që hasim, ka pësuar një ndryshim të madh, pikërisht, në çastin kur bota filloi të kalonte pragun e mijëvjeçarit. Në ishte ky një ndryshim i mirë apo jo, unë nuk jam në gjendje ta gjykoj, por mund të them që është ndryshim, sepse ne kurrë s’mund të kthehemi aty ku e nisëm.

Duke folur për veten, mendoj se letërsia që shkruaj është duke kaluar në një transformim të dukshëm. Tregimet brenda meje vazhdimisht ndryshojnë formë, ndërsa thithin ajrin e erës së re. Unë e ndjej qartësisht lëvizjen që ndodh brenda trupit tim. Gjithashtu, në të

njëjtën kohë, ajo që unë shoh është thelbi në mënyrën sesi lexuesit e marrin atë që unë shkruaj. Ka një ndryshim të rëndësishëm në sjelljet e lexuesve europianë dhe atyre amerikanë. Deri më tani, romanet e mia gëlojnë në shekullin e 20-të përmes hapësirash si “Post-modernizmi”, “Realizmit magjik” apo “Orientalizmi”, por gjatë kohës që njerëzit përshëndetën ardhjen e shekullit të ri, ata gradualisht i ikën së shkuarës dhe nisën ta pranojnë botën e rrëfimeve të mia, më pranë së tashmes. Unë e kam prekur një ndjenjë të fortë të këtij ndryshimi, sa herë vizitoja Europën dhe Amerikën. Më dukej se njerëzit po i pranojnë të plota tregimet e mia, tregime, që shpesh herë janë kaotike, me mungesë logjike, ku kompozimi i realitetit rindreqet. Në vend të analizojnë kaosin brenda tyre, ata, duket se filluan të konceptojnë një interes të ri, si e si për të marrë më të mirën e tregimeve. Komplet ndryshe, lexuesit masivë në vendet aziatike kur lexonin romanin tim, kurrë nuk e patën të nevojshme hapësirën e teorisë letrare. Me sa duket, shumica që morën përsipër t’i shijonin veprat e mia, i pranuan relativisht që nga fillimi historitë “bio”. Së pari erdhi pëlqimi dhe pastaj, së dyti (nëse ishte e nevojshme), erdhi analiza. Në Perëndim, në shumicën e rasteve, analiza logjike vjen para pëlqimit. Gjithsesi, dallime të tilla mes Lindjes dhe Perëndimit, duket sikur janë zbehur me kalimin e viteve, pasi njëra e ndikon tjetrën.

Nëse do ndalesha në proceset mes të cilëve bota kaloi vitet e fundit, do të ishin “ripozicionimi” i madh politik dhe ekonomik, që filluan pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. S’ka nevojë të flitet shumë për teknologjinë e informacionit... Mes këtyre ngjarjesh, do të ishte e pamundur për letërsinë, të merrte e vetme hapin e ripozicionimit, për të shmangur ndryshimin e sistemit. Një vështirësi e tillë nga ky proces gjithëpërfshirës është


humbja e përkohëshme, ndoshta me akse të koordinuara, që formojnë standardet e vlerësimit. Këto akse kanë qenë aty deri tani, duke funksionuar si baza të besueshme për të matur vlerën e gjërave e qëndruar në krye të tryezës, si baballarët që zgjedhin çfarë duhet dhe çfarë jo. Tani, që ne po zgjohemi, kuptojmë se jo vetëm babai, por e gjithë tryeza është shkatërruar. Gjithçka rreth nesh, me sa duket ka qenë ose është përpirë nga kaosi. Kur dëgjoj fjalën “kaos”, unë automatikisht kujtoj skenat e 11 shtatorit, kujtoj ato imazhe tronditëse, që shfaqën mijëra herë në televizione dy avionët viganë, të cilët u zhytën në muret xham të Kullave Binjake. Ato më pas u rrafshuan, pa lënë gjurmë. Komploti u realizua me përsosmëri të mrekullueshme, që arriti gati një nivel surreal. Mund ta them pa frikë, se skena duket si e bërë me grafikë kompjuteri, fiks si në një film hollivudian për fundin e botës.

Shpesh pyes veten si do ishte bota pa 11 shtatorin? Në qoftë se nuk do kishte ndodhur kurrë ose të paktën nëse ai plan nuk do ndodhte në mënyrë aq të përkryer...? Atëherë bota do të kishte qenë shumë ndryshe nga kjo e tanishmja. Amerika do të kishte patur një tjetër president (një mundësi e madhe kjo) dhe luftërat në Irak e Afganistan nuk do të ndodhnin (kjo një mundësi edhe më e madhe)... Le ta quajmë botën që kemi tani, “Realiteti A” dhe bota që mund të kishim pasur, në qoftë se 11 shtatori s’do të ndodhte, “Realiteti B”. Atëherë do të dallonim, se bota e realitetit B është më reale dhe më racionale se bota e realitetit A. Jemi duke jetuar në një hapësirë, që ka një nivel realiteti akoma më të ulët, sesa bota joreale. Mund ta quajmë këtë “kaos”? Ç’lloj kuptimi mund të ketë trillimi, në një epokë si kjo? Cilat qëllim mund t’i shërbejë...? Në një periudhë kur realiteti është mjaftueshëm i vërtetë, sa realite mund të ketë një histori e trilluar? Sigurisht ky është problemi me të cilin, ne shkrimtarët po përballemi së fundmi! Në momentin kur mendjet tona kaluan pragun e shekullit të ri, ne, gjithashtu, kaluam një herë e mirë pragun e realitetit. S’kishte zgjidhje tjetër! ...dhe në fund, si bëmë kapërcimin, historitë tona u detyruan të ndryshojë strukturë. Proza që kemi shkruar do të bëhet gjithnjë e më e ndryshme në karakter, ashtu sikundër ajo e shekullit të 20-të, që është dukshëm e diferencuar nga tregimet dhe romanet e shekullit të 19-të. Qëllimi i një tregimi nuk është të gjykojë çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar! Ç’është e mirë dhe ç’është e keqe! E rëndësishme është të vendosim brenda nesh, që elementët e ndryshueshëm dhe ata tradicionalë të ecin përpara, në harmoni me njëri-tjetrin. Madje, duhet të vendosim brenda nesh, që historitë individuale e shoqërore, t’i bashkojë zanafilla e tyre. Me një fjalë, roli i historisë është të ruajë qëndrueshmërinë e urës shpirtërore, ndërtuar mes të shkuarës e së ardhmes. Rregullat e reja dhe morali dalin natyrshëm nga një analizë e tillë. Që të ndodhë kjo, së pari duhet të thithim fort ajrin e realitetit, ajrin e gjërave mu siç janë, e t’i hedhim sytë pa paragjykime, te mënyra si tregimet transformohen në brendësinë tonë. Ne duhet të shpikim forma të reja, në të njëjtën linjë me frymën e këtij ndryshimi. Në këtë kuptim, në kohën që rrëfimi është duke kaluar sprova të vështira, historia mbart një mundësi të paparë krijuese.

Sigurisht, tregimi ka patur gjithmonë përgjegjësinë dhe peshën për t’u marrë me çdo moshë, por ato janë veçanërisht më të mëdha tani. Tregimi ka një funksion që vetëm ai mund ta kryejë, “ta kthejë gjithçka në rrëfim.” Transformimi i ngjarjeve rreth nesh, në metafora të trillimit dhe natyra e vërtetë e situatës dinamike të tyre, janë funksionet më të rëndësishme të shkrimësisë. Hendeku mes Realitetit A dhe Realitetit B apo përmbysja e realiteteve për sa mund t’i ruajmë ne vlerat tona, e në të njëjtën kohë të vazhdojmë të rilindim moralisht, janë këto temat e punës sime. Kam kaluar tre vjet duke e shkruar këtë histori, gjatë së cilës preka botën hipotetike brenda vetes, si simulim. Kaosi është ende aty, i plotë, por, pas një marrëveshje mes gjykimeve dhe gabimeve, unë jam më i fortë dhe ec në rrugën e duhur! Zgjidhja fillon duke pranuar ngadalë kaosin jo si diçka që “s’është atje”, por si një gjë “që ekziston prej vërteti.” Në jetë kam optimizëm dhe si tregimtar jam një pilot plot me shpresa, i përlulur ndaj mendjes dhe shpirtit. Unë e ndjej që bota, pas një marrëveshje të mirë gjykimesh dhe gabimesh, me siguri po krijon rrugën e re, drejt së cilës është nisur. Bota, pa dyshim ofron të dhëna që japin një zgjidhje, sepse, në fund të fundit, bota dhe tregimi na kanë sprovuar ndër shekuj, duke na bërë më të mençur!

Përktheu **POL MILO**



A portrait of Dante Alighieri, the Italian poet, wearing a laurel wreath and a red garment. The background is dark and textured. The text "ALDİGERİV" is visible in the upper right corner.

ALDİGERİV

DANTE
KOMEDIA
HYJNORE

*Përktheu nga origjinali Pashko Gjeçi
Parathënie nga Ismail Kadare*

Onufri